





# EURO DYSHIMI

## PËRMBAJTJA

- 7-13 Integrimi si Pengesë për Demokratizimin  
**BLENDI KAJSIU**
- 15-19 "Provincializimi i Evropës" dhe Debati Publik Mbi Integrimin Evropian  
**ENIS SULSTAROVA**
- 21-23 Euroskepticizmi - Një vështrim nga e majta  
**FATOS LUBONJA**
- 25-29 Norma Evropiane dhe Opinioni Lokal: Mangësitë e Përqasjes  
Institucionaliste.  
**PROF. DR ARTAN FUGA**
- 31-36 Ndërkombëtarët dhe Lokalët: Hibridizimi i Hapësirës Politike në Shqipëri  
**HENRICILI**
- 37-45 **MONITORIM**  
\*Integrimi, i (pa) kuptuari i medias shqiptare\*
- 47-52 Analiza e Analistëve: Shënime për një Sociologji Kritike të Rolit të Analistit  
**BESNIK PULA**
- DEBATINDËRKOMBËTAR MBI BASHKIMIN EUROPIAN (BE)  
DHE DEMOKRACINË**
- 53-56 Pritshmëri të mëdha: BE dhe Rivaliteti i Brendshëm Politik në Europën  
Lindore dhe Qëndrore  
**ANNA GRZYMALA-BUSSE DHE ABBYINNES**
- 57-59 Demokracia nga Populli dhe Zgjerimi i BE-së  
**PETER MAIR**
- 61-65 **RECENCATË LIBRIT "ARRATISJE NGALINDJA"**  
**TË ENIS SULSTAROVËS**
- BESNIK PULA**  
**BLENDI KAJSIU**



## INTEGRIMI SI PENGESË PËR DEMOKRACINË

M.A Blendi KAJSIU\*

Tashmë integrimi në Bashkimin Evropian është bërë prioritet i padiskutueshëm për çdo qeveri shqiptare. Aq sa ai është kthyer në një simbol të identitetit tonë kombëtar, në një tabu të paprekshme politikisht dhe në një ëndërr pothuajse të përgjithshme popullore. Sot flitet me shumë patos, dedikim dhe dashuri për Bashkimin Evropian, me shumë respekt për Brukselin, ashtu si dikur, madje ndonjëherë edhe nga persona të njëjtë, flitej për Bashkimin Sovjetik dhe Moskën. Ndonëse këto dy bashkime mund të përngjasin vetëm nga emri, mënyra se si trajtohet sot procesi i integrimit në BE është shqetësuese, pasi ai është shenjtëruar në atë pikë sa që është pothuajse blasfemi ta kritikosh. Sa më shumë rritet dëshpërimi me situatën politike dhe ekonomike në vend aq më shumë integrimi shikohet si e vetmja rrugë shpëtimi, duke e dogmatizuar kështu procesin deri në atë pikë sa që ai bëhet krejtësisht i pakontestueshëm, mbi dhe jashtë debatit publik.

Kaq i rëndësishëm është ky proces sa që ai tashmë përcakton edhe vetë sistemin tonë demokratik. Demokratizimi si proces është njehsuar tashmë me integrimin në Bashkimin Evropian, sikurse edhe zhvillimi, modernizimi apo progresi i shoqërisë shqiptare në përgjithësi. Kështu, në programin e qeverisë shqiptare 2005 - 2009 theksohet qartë se "Zhvillimi dhe integrimi janë dy anë të së njëjtës medalje, dy drejtime plotësisht të lidhura e kushtëzues të njëri - tjetrit. Zhvillimi kalon nëpërmjet integritit dhe integrimi nëpërmjet zhvillimit të vendit." Në mënyrë identike perceptohet edhe marrëdhënia midis integritit evropian dhe demokratizimit. Premisa bazë mbi të cilën zhvillohet sot procesi i demokratizimit në Shqipëri është: demokratizim do të thotë integrim dhe anasjelltas. Integrimi është bërë tashmë njësi matëse e konsolidimit demokratik. Sa më afër BE-së të ndodhet Shqipëria aq më demokratike është ajo dhe anasjelltas. Kjo premisë është e gjithë pranuar, si nga faktorët lokal edhe nga ata ndërkombëtarë. Aq sa tashmë ajo tashmë nuk ka më nevojë të vërtetohet empirikisht, sepse përbën një aksiomë që është self-evident, një nga ato të vërteta bazë, mbi të cilat ngrihen sisteme të tëra arsyetimi.

Ndonëse një vështrim empirik tregon të kundërtën; në momentet kur Shqipëria ka qenë shumë larg anëtarësimit në Bashkimin Evropian, procesi i saj politik ka qenë tejet demokratik. Kështu si zgjedhjet e vitit 1991, si ato të viti 1992 ende mbeten proceset zgjedhore më të gjithëpranuara politikisht, dhe më pak të kontestuara, pavarësisht nga arsyet konkrete përse ka ndodhur diçka e tillë. Ashtu sikurse edhe transferimi i pushtetit në këtë periudhë mbetet nga më të papërsëritshmit, me dorëheqjen e presidentit Alia dhe me zgjedhjen e presidentit Berisha. Sot, kur jemi më pranë se kurrë me Bashkimin Evropian, duket se kemi edhe disa nga problemet më themelore me sistemin demokratik, një përplasje të ashpër mes pushteteve, një proces zgjedhor ende të bllokuar dhe pak premtues. Natyrisht, kjo nuk do të thotë që afrimi me BE-në automatikisht ka prodhuar më pak demokraci. Ashtu sikurse nuk mund të konkludohet, të paktën empirikisht, se procesi i integritit automatikisht prodhon demokraci, apo mund të njehsohet me demokratizimin. Kjo ese është një përpjekje për të kritikuar paradigmen ekzistuese dhe të gjithëpranuar, si nga aktorët lokalë ashtu edhe nga ata ndërkombëtarë, se në rastin e Shqipërisë procesi i integritit nënkupton njëkohësisht edhe procesin e demokratizimit. Paradigmë, që ka prodhuar edhe qasjen sipas së cilës Shqipëria do të demokratizohet nëpërmjet karrotave dhe shkopinjve të procesit të integritit në Bashkimin Evropian. Në këtë ese kjo qasje kritikohet jo thjesht për faktin se ajo nuk ka prodhuar më shumë demokraci, por kryesisht sepse në thelb një qasje e tillë ngrihet mbi premise që bien ndesh me parimet më elementare të një sistemi demokratik. Një kritikë e tillë nuk ka të bëjë me anëtarësimin e Shqipërisë në BE për se. E thënë ndryshe, në këtë ese nuk diskutohet nëse Shqipëria duhet apo jo të jetë anëtare e BE-së. Kjo është një çështje që duhet debatuar më vete. Në këtë ese do të argumentojmë se shpesh mënyra se si është konceptuar procesi i integritit, dhe se si ai përdoret nga aktorët lokalë, jo vetëm që nuk e ndihmon por e pengon demokratizimin.

### PËRTEJ PARADIGMËS SË TRANZICIONIT OSE POLITIZIMI I DEMOKRACISË

Demokratizimi si koncept buron nga paradigma e tranzicionit, në vetvete ai nënkupton një proces nëpërmjet të cilit demokracia përmirësohet, konsolidohet dhe funksionon më mirë. Pra, ky koncept mbart në vetvete edhe paradigmen e konsolidimit të demokracisë dhe institucioneve, të cilat, sipas kësaj qasjeje, janë të brishta dhe duhet të forcohen. Një konceptim i tillë ishte mëse i natyrshëm për vendet që erdhën nga "jo-demokracia" ose nga sistemet e ashtuquajtura totalitare komuniste, ndonëse këto të fundit e quanin veten demokraci.

Është pikërisht kjo paradigmë që duhet tejkaluar për të kuptuar marrëdhënien komplekse midis demokracisë dhe integritit. Pra, duhet ta shkëpusim konceptin e demokratizimit

\*Blendi Kajsio është pedagog i shkencave politike në Universitetin Evropian të Tiranës (UET). Gjithashtu ai shkruan si analist politik në median shqiptare, punon si konsulent për çështjet e politikës dhe të demokratizimit për disa nga organizatat e ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri dhe si hërtaes shkencor për një sërë institucione shqiptare dhe ndërkombëtare. Ai ka bërë një sërë studimesh në aspekte të ndryshme demokratizimit shqiptar, si pushteti vendor, partitë politike dhe llogaritja politike që janë botuar si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Blendi Kajsio është diplomuar në dy degë, Ekonomi dhe Shkenca Politike, në Universitetin Amerikan të Bullgarisë (AUBG), në pas kaluar një Master në Studimet e Paqes dhe Konfliktit, në Universitetin "Notre Dame", në Indiana, SHBA.

nga paradigma e tranzicionit, sipas së cilës, demokratizimi është një proces linear që prodhon gradualisht konsolidimin e institucioneve demokratike. Kjo paradigmë tashmë është kritikuar gjerësisht nga autorë të ndryshëm si e papërshtatshme për të shpjeguar stadin aktual të demokracive në vende si Shqipëria. Ajo është jo vetëm simpliste, por anashkalon kompleksitetin e procesit politik që prodhon funksionimin ose jo të sistemit demokratik. Frymëzohet nga një qasje teleologjike që nuk mund të shpjegojë qerthullet vicioze nëpër të cilat ka kaluar dhe po kalon demokracia shqiptare, as faktin që shumë nga fenomenet me të cilat përballlet sot demokracia shqiptare, si zgjedhje jo të lira dhe të ndershme, janë produktet dhe jo simptomat e tranzicionit. Duke u përqendruar pothuajse ekskluzivisht në konsolidimin e institucioneve demokratike kjo paradigmë anashkalon disa nga krizat themelore me të cilat përballlet demokracia shqiptare sot, si mungesa e legjitimitetit të elitës apo apatia politike. Sipas qasjes tranzitologjike (si dhe një sërë qasjesh të tjera të ngjashme me të, mbi të cilat bazohet edhe paradigma e demokratizimit nëpërmjet integritetit), demokratizimi vlerësohet duke u përqendruar tek ndërtimi, konsolidimi dhe sjellja e institucioneve. Ndërsa politika konsiderohet si një proces që zhvillohet ose brenda ose midis institucioneve, dhe jo si procesi nëpërmjet të cilit institucionet sendërzohen. Pra, në terma analitike i jepet prioritet institucioneve dhe jo procesit politik, që në fakt i paraprin institucionet dhe është çelësi për të kuptuar suksesin apo dështimin e demokracisë. Politika në përkufizimin e saj më të thjeshtë si procesi nëpërmjet të cilit vendoset "kush merr çfarë dhe ku" është pikënisja dhe jo mbarimi i formësimit të institucioneve. Ajo i paraprin dhe formëson institucionet, të cilat më pas e formësojnë atë. Natyrisht është e vështirë, për të mos thënë e pamundur, që të ndash institucionet dhe procesin politik nëpërmjet të cilit ato formësohen dhe formësojnë. Në të vërtetë këto janë fenomene që ndodhin në mënyrë të njëkohshme, simultane. Në këtë esë ne i ndajmë ato më shumë për arsye analitike, si dhe për të theksuar rëndësinë e procesit politik, pasi në paradigmen ekzistuese institucionet shihen jo vetëm si të shkëputura, por edhe sikur i paraprijnë procesit politik.

Për pasojë, dështimi i procesit të konsolidimit të institucioneve demokratike duhet parë mbi të gjitha si një dështim politik dhe jo thjesht institucional. Ai nuk mund të kuptohet duke u njafuar me konstatimin e dështimit të institucioneve, që në vetvete përbën produktin dhe jo pasojën e dështimit të procesit politik. Edhe pse dështimi i institucioneve demokratike, qoftë procesi elektoral apo procesi kushtetues, e riprodhojnë dështimin e procesit politik. Dinamika, që sikurse u theksua, janë të njëkohshme. Kjo është edhe një nga arsyet se përse gabimisht përpjekjet për demokratizim përqendrohen kryesisht tek dimensionin e dështimit institucional. Një tjetër arsye e këtij keqkuptimi është fakti se

procesit politik është vështirësisht, për të mos thënë pamundësisht, i përkthyeshem në të dhëna sasiore, që mund të interpretohen në mënyrë "shkencore" nga politologët apo burokratët. Politika është një hapësirë që vështirë se mund të kufizohet brenda kufijve të "objektivitetit shkencor". Kjo e bën shumë të vështirë hartimin e raporteve apo politikave mbi të cilat mund të bazohen ndërhyrjet demokratizuese. Për të gjitha këto arsye nuk përbën aspak çudi fakti që paradigma e tranzicionit ka rezistuar përballë shumë kritikave nga rrethet e ndryshme akademike dhe vazhdon të përdoret nga shumë donatorë dhe institucione që merren me demokratizimin në terren. Pavarësisht nga mangësitë apo kritikave e shumta përsëri raporte sasiore të tipit Nations in Transit nga Freedom House, mbeten ndër më të cituarat dhe më të përdorurit, ndonëse në to shtjellohet pak ose aspak dinamika politike e demokracive që monitorohen.

Si pasojë e qasjes së mësipërme, përpjekjet për demokratizim përqendrohen pothuajse tërësisht tek "teknologjia e demokracisë" dhe forcimi i institucioneve, duke anashkaluar dhe madje duke bllokuar dinamikën politike që i prodhon këto institucione. Kjo prodhon institucione të dobëta si dhe domosdoshmërinë për të ndërhyrë për forcimin e institucioneve. Shembulli më i mirë në rastin konkret është procesi zgjedhor. Pas më shumë se 15 vitesh në Shqipëri institucioni i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme ende nuk është konsoliduar. Zgjedhjet e fundit parlamentare, 3 korrik 2005, ndonëse u pranuan nga palët, treguan se ende duhen arritur disa standarde bazë. Qasja e deritanishme në raport me procesin elektoral, sikurse tregohet qartë edhe në raportet e OSBE-së ka qenë ajo e konsolidimit gradual dhe teknik të këtij procesi. Në pamundësi për të përballuar kompleksitetet e dinamikës politike që prodhojnë zgjedhje të kompromentuara, raporte të tilla janë përqendruar tek teknologjia e procesit elektoral, që është pasoja dhe jo shkak i deformimit politik. Kështu, për çdo palë zgjedhje raportet e OSBE-së kanë shprehur "përmirësim në raport me zgjedhjet e kaluara", ndonëse gjithmonë mbetet shumë për të bërë. Kështu, demokracia shqiptare duket se është përherë në një proces të pandërprerë konsolidimi, por që nuk përfundon kurrë. Në fakt, shpesh përpjekjet për konsolidim prodhojnë veçse institucione mjaft të brishta, që vështirë se mund të ekzistojnë pa mbështetjen ndërkombëtare. Institucione, që mbi të gjitha janë produkt i nevojës për stabilitet apo për të eliminuar konfliktin, sesa i një procesi politik mes palëve, çka do të garantonte edhe jetëgjatësinë e tyre.

Për të tejkaluar një handikap të tillë duhet të rikonceptualizojmë qasjen tonë ndaj demokracisë. Së pari, duhet hedhur poshtë vetë koncepti i konsolidimit demokratik. Një demokraci funksionale pothuajse nuk konsolidohet kurrë pasi është në proces të vazhdueshëm evolucioni. Një sistem i shëndetshëm demokratik nënkupton antagonizëm të vazhdueshëm, përplasje

midis identiteteve të forta politike dhe një konflikte të hapura interesash. "Nëse këto mungojnë, ato mund të zëvendësohen lehtë nga përplasja midis vlerave morale të panegociueshme apo identiteteve esencialiste." Prandaj vetë ideja e një zgjidhjeje finale të konfliktit, implicite në konceptin e konsolidimit demokratik, e rrezikon projektin demokratik. Konflikti dhe antagonizmi përbëjnë fushën e ekzistencës për demokracinë, nuk mund të ketë demokraci pa konflikt dhe antagonizëm. Për këtë arsye demokracia duhet konceptuar si një e mirë që ekziston për sa kohë është e paarritshme. "Kjo demokraci do të jetë një demokraci gjithmonë 'në bërje e sipër', pasi konflikti dhe antagonizmi përbëjnë njëkohësisht kushtin mbi të cilin projekti demokratik ngrihet, dhe prej të cilit ai nuk mund të realizohet kurrë plotësisht." Për këtë arsye insistimi për politika konsensuale dhe jo konfliktuale, që dëgjohet shpesh në kuadrin e procesit të integritimit, mund të prodhojë më shumë dhe jo më pak demokraci, për sa kohë konflikte të tilla sheshohen duke e mënjeluar procesin politik. Për këtë arsye tejkalimi i paradigmes së tranzicionit dhe konceptit të saj të konsolidimit të institucioneve demokratike do të na ndihmonte të kuptonim se si procesi i integritimit e pengon dinamikën politike të demokracisë, çka përbën dhe bazën e një sistemi funksional demokratik.

Në këtë kontekst premisa bazë mbi të cilën mund të kuptohet më mirë problematika e demokracisë shqiptare është konstatimi se dështimi themelor i demokracisë shqiptare është në thelb një dështim politik dhe jo institucional. Kjo për faktin e thjeshtë, që u theksua edhe më sipër, se institucionet janë produkt i procesit politik dhe jo anasjelltas. Ajo që e kërcënon më së shumti demokracinë shqiptare sot është eliminimi i debatit politik dhe jo institucionet e dobëta. Përqendrimi i tepruar tek retorika luftarake anti-korrupsion, që mjegullon debatin mbi politikat reformuese, është veçse njëri nga shembujt e këtij kërcënimi. Një demokraci e shëndetshme dhe funksionale kërkon një debat të ndezur politik mbi alternativa të ndryshme programore, që formëson dhe formësohet nëpërmjet institucioneve dhe procedura politike që shprehin dhe përfaqësojnë interesa të ndryshme politike dhe ekonomike. Kjo është një sine qua non për një demokraci që i përgjigjet nevojave të qytetarit dhe që nuk prodhon thjesht zhgënjim dhe apati politike. është mungesa e një debati të tillë që e redukton politikën në retorika dhe aksione politike populiste, që janë një kërcënim immanent për institucionet politike që "pengojnë" realizimin e aksioneve të tilla. Për këtë arsye, sfida më e madhe e demokracisë shqiptare sot nuk është konsolidimi i institucioneve, por realizimi i një procesi politik gjithëpërfshirës dhe përfaqësues për interesa dhe grupime të ndryshme shoqërore.

Kjo sfidë nuk është unike për demokracinë shqiptare, por për demokracitë liberale në përgjithësi. Pjesëmarrja e ulët dhe apatia politike, pakënaqësia e elektoratit me partitë politike dhe politikanët në përgjithësi, kriza e përfaqësimit, janë fenomene

që hasen edhe në demokracitë më të konsoliduara. Kështu, edhe në të ashtuquajturat demokraci të konsoliduara ekziston një pakënaqësi apo hendek në mitje me procesin politik. Shiko Tabelën 1.1.

**Tabela 1.1. Besimi tek institucionet në BE, Britaninë e Madhe dhe Shqipëri<sup>1</sup>**

Vendet	Institucioni	Kam besim %	Nuk kam besim %	Nuk e di %
Britania e Madhe <sup>1</sup>	Partitë Politike	18	75	7
Mesatarja e BE-së	Partitë Politike	22	72	6
Shqipëria <sup>2</sup>	Partitë Politike	16	84	0
Vendet	Institucioni	Kam besim %	Nuk kam besim %	Nuk e di %
Britania e Madhe	Qeveria	30	64	6
Mesatarja e BE-së	Qeveria	35	59	7
Shqipëria <sup>3</sup>	Qeveria	52	48	0
Vendet	Institucioni	Kam besim %	Nuk kam besim %	Nuk e di %
Britania e Madhe	Parlamenti	36	54	10
Mesatarja e BE-së	Parlamenti	38	54	8
Shqipëria	Parlamenti	44	56	0

Kjo nuk do të thotë që problemet e demokracisë shqiptare janë identike me ato Evropiane. Natyrisht konsekuencat e fenomeneve të mësipërme mund të jenë shumë më serioze në rastin e Shqipërisë sesa në të ashtuquajturat demokraci të konsoliduara. Megjithatë, kjo nuk duhet të na pengojë të shikojmë se, ndonëse pasojat mund të jenë të ndryshme shkaqet janë të njëjta. Janë pikërisht këto fenomene që janë shkak dhe pasoja e krizave të njëpasnjëshme që ka kaluar dhe po kalon demokracia shqiptare. Kështu që sfidat me të cilat përballlet demokracia shqiptare nuk duhen parë si simptoma të mungesës së konsolidimit demokratik, por si shfaqje të një krize të demokracisë. Institucionet e dobëta janë para së gjithash pasoja e një procesi politik jopërfaqësues, aspak transparent, kompetitiv apo gjithëpërfshirës.

## INTEGRIMI DHE DEMOKRACIA

Jo rastësisht në këtë seksion do të shqyrtojmë marrëdhënien midis procesit të integritimit dhe demokracisë, dhe jo demokratizimit. Sikurse u tregua më sipër, koncepti i demokratizimit, që nënkupton konsolidimin demokratik, nuk është aspak i dobishëm për të shqyrtuar dështimet e demokracisë shqiptare. Më shumë se kudo tjetër kriza e demokracisë shqiptare pasqyrohet jo tek institucionet e dobëta, por tek kriza e përfaqësimit, çka nuk është tipike vetëm për demokracinë tonë. Pothuajse të gjitha sondazhet tregojnë se elektorati ka pak besim tek institucionet demokratike dhe fare

<sup>1</sup>Statistikat në këtë tabelë vijnë nga disa sondazhet të bëra me metodologji të ndryshme, për pasojë krahasimi mbart një nivel të konsiderueshëm pasaktësie. Megjithatë, përqindjet janë të tilla sa pavarësisht nga niveli i pasaktësisë ato tregojnë qartë prirjet e elektoratit për institucionet në fjalë.

pak tek partitë politike. Qytetari ndihet pak i përfaqësuar në procesin politik, çka reflektohet edhe tek pakënaqësia me partitë apo politikanët në përgjithësi. Debatet politike dhe polarizimi i skenës politike gjithnjë e më pak reflektojnë prioritetet e elektoratit. Kjo përbën thelbin e asaj që mund të përkufizohet si kriza e përfaqësimit. Procesi i integritimit në BE jo vetëm që nuk e lehtëson por e thellon këtë krizë. Duke u kthyer në një prioritet absolut integrimi përbën de facto programin qeverisës të çdo force politike, të paktën në letër. Kjo më pas reflektohet në faktin që prioritetet e përcaktuara në raportet e BE-së përbëjnë pak a shumë edhe programin qeverisës të forcës politike në pushtet. Nuk është rastësi që prioritetet e përcaktuara në raportet e stabilizimit asociimit, si korrupsioni, lufta ndaj trafikut të qenieve njerëzore apo forcimi i kufijve, përbëjnë bazat e programit të qeverisë. Pa i gjykuar këto prioritetet, mjafton të theksojmë se ato nuk përputhen me atë që e shqetëson më shumë elektoratin. Kjo nuk do të thotë aspak se elektorati shqiptar është kundër integritimit të Shqipërisë në BE apo kundër luftës ndaj krimit të organizuar ose korrupsionit. Çështje të tilla gëzojnë mbështetjen e elektoratit, por sipas sondazheve, çështjet më themelore elektoratin kanë të bëjnë me papunësinë apo zhvillimin ekonomik në përgjithësi. Çështje që nuk janë të një rëndësie primare në kudrin e procesit të integritimit. Shiko Tabela 2.

**Tabela 2. Cila është çështja më e rëndësishme që duhet të zgjidhet nga qeveria?<sup>13</sup>**

Çështja	Më e Rëndësishme	E Dytë më e Rëndësishme
Papunësia	46.0%	24.3%
Lufta ndaj Korrupsionit	10.0	9.8
Electriciteti & Ujë	7.0	12.0
Rritje Paguesh & Pensionesh	6.8	8.5
Rrugët	5.6	12.1
Rëndi Publik	4.7	12.2
Legalizimi i Shtëpive	4.5	4.4
Kthimi i Pronës Private	4.5	2.2
Ujja e Varfërisë	3.3	3.4
Problemet sociale	2.7	4.0
Arsimi	2.2	4.0
Integrimi në BE	2.0	3.0
Ruajtja e Stabilitetit Politik	0.8	1.8
TOTAL	100.0%	100.0%

Shënime: Numri i përgjigjeve në këmbëz të dytë = 1154, Numri i përgjigjeve në këmbëz të tretë = 1120.


Sikurse e tregon edhe tabela e mësipërme prioriteti kryesor për elektoratin është papunësia, më pas korrupsioni dhe një sërë çështjesh të tjera si infrastruktura apo rrogat dhe pensionet. Të gjitha këto çështje që ende zënë një rol dytësor në debatin politik. Kjo nuk do të thotë që elektorati nuk e mbështet luftën e ekezekutivit kundër korrupsionit, por që shqetësimet e tij janë më pranë zhvillimit ekonomik sesa atij institucional, ku duket se është edhe theksi i qasjes së BE-së. Natyrisht BE-ja ka prioritet dhe standardet e saj si

organizatë, që nuk janë aspak të dëmshme për Shqipërinë, por që jo domosdoshmërisht dhe automatikisht reflektojnë prioritetet e kësaj të fundit. Mjafton të përmendim që kontrolli i kufijve, ndonëse është një standard që duhet arritur, është shumë më pak prioritar për shtetasit shqiptarë sesa për burokratët e BE-së. Natyrisht nuk është detyrë e zyrtarëve të BE-së që të vijjnë në Shqipëri dhe në fjalimet e tyre të theksojnë se shteti shqiptar duhet të luftojë papunësinë. Kjo është detyrë e ekezekutivit shqiptar, i zgjedhur nga elektorati vendas për të pasqyruar prioritetet e këtij të fundit. Për sa kohë këto shqetësime nuk do të reflektohen në politikëbërje, për sa kohë debati politik nuk do të jetë programatik dhe pasqyruar i shqetësimeve elektorale, kriza e përfaqësimit do të thellohet.

Sa më shumë që kjo krizë thellohet aq më shumë elita politike humbet legjitimitetin e saj dhe demokracia futet në krizë. Ky delegitimim shpjegon deri diku edhe euroentuziazmin shqiptar. Shumica dërmuese e qytetarëve shqiptarë e mbështesin fuqimisht anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Përtej faktorëve subjektiv kjo mbështetje nuk rrjedh thjesht nga përfitimet që do të ketë Shqipëria si anëtare e BE-së, përfitime që për shumicën e qytetarëve reduktohen tek lëvizja e lirë. Një arsye për euroentuziazmin është mosbesimi tek elita lokale politike. Jo rastësisht në një sondazh të bërë nga Instituti i Studimeve Ndërkombëtare (ISN) me grupe elitare shoqërore, shumica e të intervistuarve (44%) mendonin se Bashkimi Evropian duhet ta anëtarësojë Shqipërinë edhe përpara se ajo të jetë e përgatitur për diçka të tillë. Anëtarësia në BE shikohet si një garanci më shumë për të kontrolluar dhe kufizuar papërgjegjshmërinë e elitës lokale, e cila pa mbikëqyrjen e Evropës nuk i respekton normat demokratike. Për këtë arsye "nuk duhet të lihet në dorë të shqiptarëve për t'i respektuar këto norma, por është vetë detyrë e Evropës për të na detyruar për t'i respektuar ato."

Sa më shumë që elektorati vendas dëshpërohet me politikën lokale aq më shumë ata e kërkojnë shpëtimin tek Bashkimi Evropian. Frazat popullore të tipit "nuk bëhet Shqipëria me shqiptarët" nuk janë të rastësishme, por pasqyrojnë këtë pesimizëm të thellë politik. Kështu që nuk është aspak çudi që elektorati shqiptar midis vendimmarrjes së Tiranës dhe asaj të Brukselit të zgjedhë këtë të fundit. Ndonëse nuk ekzistojnë sondazhe apo burime të tjera informacioni për ta vërtetuar diçka të tillë në mënyrë të drejtpërdrejtë, ky konkluzion mund të deduktohet nga fakti se Bashkimi Evropian perceptohet si një organizatë mjaft demokratike nga grupe të ndryshme shoqërore në Shqipëri. Ndërkohë që, sikurse e treguam më sipër, besimi tek institucionet demokratike lokale është mjaft i pakët. Shiko Tabelën 3.



Tabela 3. Vlerësime për Bashkimin Evropian (BE)<sup>17</sup>

Për këtë arsye një pjesë e mirë e legjitimitetit të elitës lokale vjen nga jashtë në përgjithësi dhe nga BE-ja në veçanti. Aq më tepër që proceset elektorale tepër problematike dhe të kontestuara e kanë reduktuar legjitimitetin e forcës politike në pushtet. Për pasojë sa më shumë delegjtimohet përballë elektoratit lokal, aq më shumë elita politike vendase kërkon miratimin, mbështetjen dhe legjitimimin nga institucionet ndërkombëtare në përgjithësi dhe ato evropiane në veçanti. Për pasojë ajo adopton, të paktën nominalisht, ligjërimin dhe prioritetet që vijnë nga këto organizma që jo domosdoshmërisht pasqyrojnë shqetësimet kryesore të elektoratit. Pranë një përpjekje për të legjitimuar vetveten elita lokale e thellon edhe më tej hendekun mes saj dhe qytetarëve, duke arritur kështu efektin e kundërt. Kjo prodhon një rreth vicioz që thellon deficitin demokratik; sa më pak legjitime elitat bëhen në raport me elektoratin, aq më shumë legjitimiteti i tyre buron nga faktori ndërkombëtar dhe procese si ai i integritimit, çka i delegjtimion ato edhe më tej, pasi prioritetet që ato artikulojnë janë gjithnjë e më larg qytetarit dhe gjithnjë e më pranë burimit të legjitimitetit.

Kjo krizë thellohet edhe më tej si pasojë e dimensionit apolitik që mbart vetë procesi i integritimit dhe nga mënyra se si ky proces manipulohet nga elitat lokale. Më sipër theksuam se kriza e përfaqësimit vjen edhe si pasojë e depolitizimit të procesit politik, e mungesës së debatit programatik që reflekton shqetësimet e qytetarit. Debatit është gjithnjë e më pak politik dhe gjithnjë e më shumë personal, moral apo në ekstremin tjetër thellësisht teknik, çka e bën të pamundur sendërzimin e reformave apo programeve që mund të transformojnë sektorë të rëndësishëm të shoqërisë, si arsimit publik apo shëndetësia. Lufta antikorrupsion apo akuzat mbi hajdutërinë e politikanëve të veçantë, anashkalojnë debatet mbi politika apo programe konkrete që pasqyrojnë shqetësimet kryesore të qytetarit. Qasje të tilla justifikohen në kuadrin e prioritetëve të integritimit, çka shërben edhe si mburojë justifikuese për manipulimin që qeveria i bën këtyre prioritetëve për t'i përdorur kundër kundërshtarëve të saj politikë. Në këtë mënyrë procesi i integritimit e ul intensitetin e debatit politik në raport me zgjedhjet që vendi duhet të bëjë për të ardhmen, pasi kjo zgjedhje tashmë është bërë njëherë e mirë, ajo është integritimi. Të gjitha forcat politike bien dakord për diçka të tillë, dhe debati thjeshtëzohet te

ritmi dhe mënyra më e shpejtë për ta arritur diçka të tillë. Partitë politike e akuzojnë njëra - tjetrën se janë të paafta për ta anëtarësuar Shqipërinë në BE. Madje, edhe në fushata elektorale, si pasojë e euroentuziazmit lokal, politikanët premtojnë një futje të shpejtë të Shqipërisë në Evropë. Kështu eliminohen pothuajse tërësisht debatet mbi modelin apo rolin e shtetit që po ndërtohet në Shqipëri. Në kuadrin e integritimit theksohet thjesht se shteti duhet të jetë efikas në mënyrë që të futemi në BE. Efikasiteti shikohet si një atribut thjesht teknik dhe aspak politik, për pasojë theksohet domosdoshmëria e reformave thjesht administrativo - burokratike. Aq më pak flitet për rolin e shtetit në shoqëri apo në raport me shtresat apo grupet e ndryshme shoqërore. Shteti shikohet më shumë si një makineri asnjansë, jo politike, që duhet të jetë efikas në realizimin e procesit të integritimit, më shumë sesa një instrument për të zbatuar reforma apo programe politike në funksion të grupeve të ndryshme shoqërore. Madje, shpesh, sa më pak një qeveri ofron në nivelin programatik dhe zhvillimor, aq më shumë ajo thekson integritimin si prioritet. Ky mund të quhet depolitizimi në nivelin makro.

Ekziston edhe një tjetër depolitizim në nivelin mikro. Procesi i integritimit ka një theks thellësisht administrativ dhe jo politik. Në fund të fundit integritimi është një proces i dizenuar dhe i implementuar nga eurokratë, më shumë sesa europolitikane. Ai është një proces që bazohet në reforma administrative, procedura dhe përfrim legjislativ dhe që e anashkalon maksimalisht procesin politik. Në fakt vetë procesi i ndërtimit të institucioneve shihet si një proces tërësisht teknik. Pra, institucionet nuk shihen si produkte të një procesi politik, por përkundrazi procesi politik duhet të jetë prodhim i institucioneve. Si rrjedhojë, në vend që të kërkohen mënyrat se si procesi politik, qoftë nëpërmjet balancimit, përfaqësimit apo kompromisit, mund të prodhohet institucione sa më solide, synohet që procesi i ndërtimit të institucioneve të divorcohet tërësisht nga procesi politik. Kjo prodhon institucione me legjitimitet të cunuar politik, jo përfaqësuese dhe rrjedhimisht të brishta. Në këtë mënyrë procesi i integritimit fokusohet thellësisht në dimensionin teknik të demokracisë, në teknologjinë administrativo-legjislativ të saj, më shumë sesa në dimensionin përfaqësues apo pjesëmarrës në politikëbërje. Kjo në fakt reflekton edhe vetë deficitin demokratik që mbart Bashkimi Evropian. Përfrimi i legjislativit është shembulli më i mirë në këtë aspekt. Nga njëra anë, në mënyrë që ligjet të jenë të mira dhe efikase është i domosdoshëm një proces i hapur legjislativ, ku ligji është produkt i përfaqësimit, diskutimit, sugjerimeve apo debatit midis grupeve të ndryshme të interesit. Nga ana tjetër, Shqipërisë i duhet të adoptojë mijëra faqe legjislativ, i cili është produkt i një procesi intensiv përktimi, më shumë sesa produkt i një procesi intensiv përfaqësimi. Kështu prodhohet të ashtuquajturat "ligje të mira", por që nuk zbatohen.

Fakti që një ligj mund të jetë përkthyer, përshtatur apo fotokopjuar nga BE-ja, nuk e bën atë ligj të mirë. Në një sistem demokratik një ligj i mirë është ai ligj që gjen zbatim edhe në terren, pasi reflekton maksimalisht interesat e grupeve të ndryshme shoqërore sjelljen e të cilave normon. Pra, një ligj i mirë është gjithashtu edhe një ligj që është i zbatueshëm. Është një ligj që prodhohet nëpërmjet një procesi legjislativ të hapur, pjesëmarrës dhe përfaqësues. Fatkeqësisht ekzistencat e integritimit nuk e mundësojnë diçka të tillë.

Për pasojë prodhohet një inflacion legjislativ, që është vështirësisht i zbatueshëm nga administrata shqiptare me kapacitetet e saj të kufizuara. Prodhohen shumë ligje, por zbatohen pak prej tyre. Një pjesë e mirë e këtyre ligjeve kanë një sërë kontradiktash në vetvete dhe me legjislacionin ekzistues, nuk pasqyrojnë dinamikën lokale dhe aq më pak janë produkt i kësaj dinamike, më shumë sesa i ekzistencave legjislative të procesit të integritimit. Për rrjedhojë kjo shumësi ligjesh është vështirësisht e zbatueshme. Çka bën që inflacioni legjislativ të kontribuojë në moszbatimin e ligjit. Krijohen kështu dy sfera gjithnjë e më të shkëputura nga njëra-tjetra, ligji në letër dhe praktika në terren. Kjo prodhon dhe konsolidon një kulturë dhe mjedis joligjor dhe informal, ku lulëzon arbitrariteti, abuzivizmi apo klientelizmi. Pra, kemi efektin e kundërt të shtetit ligjor.

## KONKLUZION

Për të gjitha arsyt e para, htruar më sipër, sa më shumë që rendim drejt Evropës dhe sa më gjatë flasim për të, aq më shumë duket se ajo largohet. Çështja nuk është thjesht nëse është mirë apo jo për Shqipërinë që të jetë anëtare e Bashkimit Evropian. Më i rëndësishëm për momentin është procesi nëpërmjet të cilit do të ndodhë diçka e tillë, pra integrimi. Integrimi nuk është një proces i mirë apo i keq në vetvete. Mënyra se si është konceptuar ky proces nga BE-ja, mënyra se si ky proces përdoret, manipulohet apo abuzohet nga elitat lokale, ka bërë që ai jo vetëm të mos i shërbejë forcimit të demokracisë, por të prodhojë një sistem hibrido-demokratik, që nuk mund të mbijetojë pa ndihmën e ndërkombëtarëve. Demokracia shqiptare tashmë duket sikur është prej kohësh në një sallë reaminacioni, që e ka emrin "Integrim". Ose po të përdorim një metaforë më të zbutur, duket se demokracia shqiptare nuk po arrin të maturohet, çka pasqyrohet edhe në sjelljen e politikanëve shqiptarë, që duken gjithnjë e më femënorë në aktet e tyre. Integrimi përbën femëjërinë e demokracisë shqiptare, ndërsa anëtarësimi në BE, maturimin e saj. Në këtë marrëdhënie komplekse BE-ja është në rolin e prindit, që po e ndihmon Shqipërinë të rritet. Problemi është se në vend që kjo marrëdhënie gradualisht të eliminohet, ajo po riprodhohet në vazhdimësi. Sa më shumë BE-ja pëmbush rolin e saj të prindit, aq më shumë Shqipëria pëmbush rolin e saj të femijës, në një proces që quhet integrim. Mënyra se si është

konceptuar procesi i integritimit, si një tërësi detyrash që i jepen femijës nga prindi/mësuesi, dhe jo si një proces politik përfaqësues vetëreflektimi dhe vetëmësimi, bën që marrëdhënia prind-fëmijë midis Shqipërisë dhe BE-së të riprodhohet vazhdimisht. Në këtë mënyrë, sa më shumë kalon koha aq më shumë femija (Shqipëria) duket se ka nevojë për prindin (BE-në). Pra, afrimi me BE-në riprodhon femëjërinë e demokracisë shqiptare ose brishtësinë e saj. Si pasojë procesi i integritimit nuk prodhon domosdoshmërisht më shumë demokraci, ndonëse rrit nevojën për demokratizim. Kjo, pasi premisa se integrimi është njëkohësisht edhe demokratizim, ngrihet mbi presupozimin se demokracia është një sistem tërësisht i importueshëm. Në rastin konkret modeli që po importohet është ai i demokracisë evropiane me ligjet, teknikalitetet dhe procedurat që listohen në raportet e Stabilizim Asociimit. Prandaj pikërisht në këtë nivel duhet shtruar pyetja: Në ç'masë, nëse po, mund të importohet demokracia si sistemë Shqipëria ka një traditë të pasur në importimin e sistemeve të ndryshme politike. Kështu, Zogu importoi monarkinë si model, më pas u importua sistemi komunist, ndërsa sot duket se po importohet demokracia. Mirëpo ndryshe nga pothuajse të gjitha sistemet e mëparshme demokracia është vështirësisht e importueshme, pasi përtej emrit ajo si sistem varion në mënyrë të ndjeshme nga njëri vend në tjetrin. Në fakt, karakteristika kryesore e demokracisë, dhe ndoshta edhe pika e saj e fortë, është se për të qenë e suksesshme ajo duhet të prodhohet, sendërzohet dhe rritet në mënyrë lokale, nga një komunitet i lirë dhe i pavarur qytetarësh, vullnetin e të cilëve ajo shërben për ta sendërzuar, pasqyruar dhe zbatuar. Këtu qëndron edhe "natyrshmëria" e sistemit demokratik, ndryshe nga shumë sisteme të tjera moderne, qoftë fashist apo komunist, të cilat janë qartësisht të përcaktueshëm si në ideologjinë ashtu edhe në funksionimin e tyre, dhe për pasojë edhe lehtësisht të importueshëm. Përkundër sistemeve të tilla, përtej disa parimeve themelore si zgjedhjet e lira dhe të ndershme, është e vështirë të ndërtohet një model universal të demokracisë, pasi ajo është zhvilluar në mënyra të ndryshme, në vende të ndryshme, në periudha të ndryshme. Në thelb demokracia e përjashton importimin ideologjik, pasi nëse ajo nuk prodhohet dhe rritet lokalisht atëherë ajo nuk mund të quhet demokraci, apo qeverisje nga populli. Në dimensionin e saj më themelor demokracia duhet të burojë nga brenda dhe jo të importohet nga jashtë. Jo rastësisht përpjekjet demokratizuese të ardhura nga jashtë, me gjithë qëllimin e mirë, kanë qenë shumë pak rezultative, institucionet më të qëndrueshme dhe më efikase kanë qenë ato të ngritura nga "brenda", siç janë partitë politike.

Për këtë arsye, qasja aktuale që e njehson demokratizimin me integrimin bie ndesh me vetë "esencën" e një sistemi demokratik. Për sa kohë BE-ja pozicionohet në rolin e prindit është e vështirë të flasësh për përfaqësimin apo sendërzimin e një vullneti popullor apo interesave lokale në qeverisje. Si sistem

demokracia presupozon një komunitet sovran, që është në gjendje të identifikojë interesat nëpërmjet një procesi të hapur politik përfaqësimi. Pra, presupozohet një komunitet individësh të rritur dhe jo fëmijë. Kjo është e pamundur për sa kohë si tek elita lokale, ashtu edhe tek elektorati në përgjithësi artikulumit i interesave të përbashkëta i delegohet Evropës. Elita në këtë mënyrë eviton përgjegjësinë qeverisëse dhe fiton legjitimitet, ndërsa elektorati e bën këtë si pasojë e humbjes së besimit tek elita lokale. Produkti i kësaj dinamike është moto "Evropa e di më mirë se çfarë është e mirë për ne". Pra, Evropa në këtë rast pozicionohet në mënyrë tipike në rolin e prindit që merr vendimet për fëmijën, një subjekt ende i paafër për të përcaktuar të mirën e vet. Ky nuk është një pozicion i ri në hapësirën politike shqiptare, dikur ai është zënë nga Partia Komuniste në harmoni me Republikën Federale Jugosllave, më pas me Bashkimin Sovjetik, pastaj me Kinën dhe në fund vetëm nga Partia e Punës. Fatkeqësisht një pozicionim i tillë e riprodhon fëmijërinë e komunitetit politik mbi të cilin aplikohet. Kështu, komuniteti ynë politik ende nuk gëzon një sovranitet konceptual, nëpërmjet të cilit përcaktohen dhe përfaqësohen interesat e grupeve të ndryshme. Pa të, është vështirë të flitet për një sovranitet politik, çka është edhe baza e një demokracie funksionale.

Prandaj mbase duhet riparë në mënyrë kritike procesi i integritimit në BE, pasi në fund të fundit ai nuk është një qëllim në vetvete, mbarimi është treguesi kryesor i suksesit të tij. Zhvillimi, funksionimi i demokracisë, janë objektivat që synohen në vetvete, me apo pa integritimin. Çdo proces që anashkalon apo vendos në plan të dytë synime të tilla, duhet parë me skepticizëm. Në "vrapin" tonë të zellshëm drejt Evropës duket se kemi harruar të merremi me vetveten. Aq sa më shumë sesa

për të arritur Evropën duket se vrapojmë për t'u larguar nga vetvetja. Duhet të ndalojmë, të marrim frymë thellë në mënyrë që Evropa të vij tek ne, pra të arrijmë ato standarde që na bëjnë një shtet "evropian". Në këtë proces integrimi evropian duhet parë si një faktor ndihmës, por kurrsesi zëvendësues, pasi integrimi në BE nuk mund të zëvendësojë sistemin demokratik. Ai duhet të jetë në funksion dhe jo në zëvendësim të këtij sistemi. Përndryshe, veçse do të konsolidohet një demokraci fasadë që i ngjason demokracisë evropiane veçse në letër. Ashtu siç ligjet tona në letër janë tejet "evropiane", por në zbatim janë tejet "shqiptare". Edhe për sistemin politik që po sendërzojmë ekziston një rrezik real, që nëpërmjet procesit të integritimit sistemi politik që synojmë të ndërtojmë, të jetë gjithnjë e më larg sistemit politik në të cilin jetojmë. Nuk do të ishte hera e parë që shoqëria shqiptare do jetonte në një dyzim të tillë midis asaj që deklarohet dhe asaj që jetohej. Diktatura komuniste që kaluam ishte një sistem dyzimi apo hipokrizie par excellence. Nga njëra anë glorifikohet sistemi socialist si arritja më e lartë e demokracisë popullore dhe e zhvillimit ekonomik, nga ana tjetër, jetohej çdo ditë në një sistem politik diktatorial dhe në deprivim të thellë ekonomik. Në këtë dyzim apo hipokrizi shoqërore Shqipëria përjetoi një tranzicion pothuajse 50-vjeçar nga socializmi drejt komunizmit, që në fakt nuk u arrit kurrë. Prandaj mbase duhet bërë kujdes që tranzicioni drejt BE-së ose procesi i integritimit, mos të riprodhojë të njëjtin efekt, ku ne i afrohem pafundësisht një objektivi që më pas edhe mund të zhduket. Pasi rrezikojmë që në fund të një rrugëtimi të gjatë tranzicional të kuptojmë se nuk kemi ndërtuar asgjë, dhe se duhet t'ia nisim punën përsëri, duke u gjendur sërish në fillim të një tranzicioni të ri, drejt një objektivi të ri.

## BURIMET

- 1-Programi i Qeverisë. "Integrimi Evropian dhe Euroatlantik". Tiranë 2005.
- 2-Shiko Tomas Carothers: "The End of the Transition Paradigm," *Journal of Democracy*, Volume 17, Number 1, National Endowment for Democracy and the John Hopkins University Press.
- 3-Albanian Democracy - In Search of Accountability. Albanian Institute for International Studies. Tirana 2006. p 20.
- 4-In Search of Accountability, Albanian Institute for International Studies (AIIS), Tirana 2006.
- 5-Shiko raportet e OSBE-së për zgjedhjet parlamentare të 2001 dhe zgjedhjet lokale të 2003, në
- 6-Mouffe, Chantal. "The Return of the Political". Verso, London/New York. 1993. p 6.
- 7-Ibid. p 8.
- 8-Shiko, Chantal Mouffe "The Return of the Political." Verso, London/New York.
- 9-TNS Opinion and Social, Eurobarometer 65.2, Spring 2006, p 19, 20, 21, [http://ec.europa.eu/public\\_opinion/archives/eb/eb65/eb65\\_ruk\\_nat.pdf](http://ec.europa.eu/public_opinion/archives/eb/eb65/eb65_ruk_nat.pdf). Aksesuar Gusht 30, 2006.
- 10-"Albanian Youth National Survey". Carried out by Public Opinion Strategies (POS) in March 2004, on behalf of the International Republican Institute (IRI) in Albania. The survey focused only on Albanian urban youth.
- 11-Globic Opinion Poll 2, Chapel Hill, NC, USA, June 2006, e disponueshme tek [www.walpsa.org](http://www.walpsa.org). Aksesuar Gusht 30, 2006.
- 12-Krastev, Ivan. "The Inflexibility Trap - Frustrated Societies and Weak States". Center for Liberal Strategies (CLS), Sofia 2002. P 23.
- 13-Globic Opinion Poll #1. Albanian Public Opinion. Chapel Hill, North Carolina, USA. December 2005.
- 14-"Rethinking European Integration - Perceptions and Realities 2005". Albanian Institute for International Studies (AIIS), Tirana 2005. p 9. Available at [http://www.aiis-albania.org/Perceptions\\_2005\\_engl.pdf](http://www.aiis-albania.org/Perceptions_2005_engl.pdf)
- 15-Ibid. p 40.
- 16-"Zgjedhjet e fundit të zgjedhjes, ato të vitit 1992." Aleksandër-Meksi. Gazeta Shqiptare, E Premte 8 Shtator 2006. f7.



## "PROVINCIALIZIMI I EVROPËS" DHE DEBATI PUBLIK MBI INTEGRIMIN EVROPIAN

M.A Enis SULSTAROVA\*

Universiteti Evropian i Tiranës (UET)

### DEBATI PROVINCIAL MBI EVROPËN

Në prag të nënshkrimit të Asociim Stabilizimit me Bashkimin Evropian, në shtypin shqiptar nisën replikat e ashpra midis Ismail Kadaresë dhe Rexhep Qoses, jehona e të cilit vazhdon edhe sot. Prej këtij debati, ku u përshinë gati të gjithë intelektualët dhe opinionbërësit më në zë brenda dhe jashtë kufirit shtetëror (deri te arbëreshët, shih Mandala & Marku, 2006), si edhe prej debateve të tjerë të ngjashëm që janë shfaqur më parë dhe herë pas here në shtypin shqiptar, krijohet përshtypja se çështja e integrimit të Shqipërisë në BE po debatohet seriozisht në publik. Mirëpo nuk është kështu. Si ndodh rëndom në këtë vend, debati Kadare-Qose, si edhe shumë të tjerë para tij, ishte tejet provincial, me gjithë përfshirjen në të të intelektualëve tanë të shquar. E quaj provincial, sepse nuk u fol mbi përfitimet e shoqërisë shqiptare prej procesit të anëtarësimit, detyrimet e Shqipërisë në këtë fazë të re të rrugës së integrimit, mbi ecurinë e reformave, mbi ngadalësimin apo edhe dështimin e tyre të dukshëm në disa drejtime, mbi alternativat e ofruara për realizimin sa më mirë të objektivave të integrimit etj. E thënë shkurt, nuk ishte një debat politik. Debati u soll në mënyrë të ngushtë rreth pyetjes së çuditshme: a janë apo jo evropianë shqiptarët? Pse ndodhi kjo? Pse mendimi intelektual shqiptar është i paaftë të gjenerojë një debat politik mbi integrimin dhe ta lerë "integrimit" të përdoret vetëm në rrafshin e propagandës elektorale dhe të garës së rëndomtë të partive politike për të marrë flamurin e evropianizmit? Pse jemi një vend periferik duhet të zhvillojmë vetëm debate publike provinciale?

Dihet që Shqipëria është në një pozicion periferik ndaj Bashkimit Evropian, për nga shkalla më e ulët e zhvillimit teknologjik dhe e nivelit të jetesës, për nga pozicioni gjeopolitik të fqinjësisë së afërt të BE, për nga aspirata shqiptare dhe për nga tërheqja që BE ushtron nga Shqipërisë që synon t'i bashkohet këtij organizimi (shih Fuga, 2004: 10-12). Në kushte periferike, shumëkush mund të presë që edhe debati publik të jetë në shkallën e provincialitetit. Megjithatë, globalizimi në disa rrafshet e ka

relativizuar marrëdhënien qendër-periferi. Kjo është më e dukshme te globalizimi i komunikimeve dhe i përcjelljes së ideve, i cili krijon mundësinë që së paku mendimi intelektual ta kapërcejë qerthullin e provincialitetit, të konceptualizojë proceset modernizuese në tërësinë dhe ndërlikimin e tyre dhe të marrë përsipër udhëheqjen shpirtërore të integrimit politik të Shqipërisë. Duket se kjo mundësi nuk po shfrytëzohet, përkundrazi në 15-16 vitet e fundit mendimi intelektual në Shqipëri çështjen e integrimit e ka shtruar në mënyrë të tillë, që e ka përjashtuar realisht një debat politik mbi të. Reformat e ndryshme institucionale nga sipër janë bërë pavarësisht mendimit dhe rrahjes publike të çështjeve të integrimit evropian. Edhe qytetarët e Shqipërisë e kanë gjetur modus vivendi të tyre me Evropën, ndonjëherë në trajta origjinale dhe të papritura, pavarësisht prej mendimit të intelektualëve. Pra, mendimi intelektual shqiptar, ashtu siç u paraqit në rastin e fundit të debatit Kadare-Qose ka mbetur prapa realiteteve integruese shqiptare. Pa pretenduar të jem shterues, mendoj se gabimet kryesore të intelektualëve tanë kanë qenë dy qasje ndaj marrëdhënive Shqipëri (apo shqiptarë) - Evropë, që janë të ndërlidhura dhe plotësuese të njëra-tjetrës: "Evropa intime" dhe qasja historiciste. Këto dy qasje do t'i shpëllon në dy pjesët pasuese dhe më pas do të propozoj që marrëdhëniet e Shqipërisë me Evropën të analizohen politikisht në kuadër të procesit të modernizimit të Shqipërisë.

### EVROPA INTIME

Shpeshherë në shkrime të ndryshme, intelektualët shqiptarë kanë ndjekur një qasje emotive të marrëdhënive të Shqipërisë me Evropën, duke i personalizuar ato si lidhje intime midis dy njerëzve. Kjo ka qenë emblematike e Ismail Kadaresë, i cili në një sërë tekstesh letrare dhe sprovash teorike ka tentuar të gjurmtojë lidhjet e ngushta të shqiptarëve me Evropën, lidhjet parapolitike që, sipas tij, përbëjnë "themelet" e përpjekjeve integruese të sotme. Duke përzier materialin historik ai ka përfutur një trinom përonazhesh mitikë - Evropa, Shqipëria, Azia - dhe ka ndërtuar me to një intrigë dashurie-urrejtjeje të denjë për një telenovelë, si ato që marrin shumicën e kohës televizive të shtëpiakeve shqiptare. Marrëdhënia kyçe është ajo midis Evropës dhe Shqipërisë. Kadareja dhe të tjerë intelektualë shprehën se Evropa është "kontinenti mëmë" për shqiptarët (Kadare, 2004, 2006a; Misha, 1997:30). Pra, marrëdhëniet Evropë-Shqipëri shihen si marrëdhënie nënë-bijë, lidhja natyrore primordiale në botën e gjitarëve. Megjithëse Evropa dhe Shqipëria janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, në një çast fatal, kur Evropa tregohet e pakujdesshme, personazhi negativ dhe misterioz me emrin Azia, e rrëmben Shqipërinë-fëmijë për ta birësuar. Qysh atëherë një mall i madh kaplon nënë e bijë dhe ato përpriqen me dëshpërim të ribashkohen: "Të gjithë shekujt që [kombi shqiptar] ka kaluar i ndarë nga Evropa, është një nostalgji e madhe, është kontinenti

\*Autori është pedagog në Universitetin Evropian të Tiranës (UET). Ai është autor i librave "Ligjërimi nacionalist në Shqipëri" dhe "Arratisja nga Lindja". Ai është gjithashtu autor i një sërë artikujsh të botuar brenda dhe jashtë vendit në lidhje me formësimin e identitetit shqiptar; që është edhe fusha e tij e ekspertizës. Enis Sulstarova ka punuar edhe si kërkues shkencor në Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe për momentin është nëndrejtor i këtij instituti. Sulstarova ka dhënë mësim si pedagog i jashtëm në Seksionin e Shkencave Politike në Universitetin e Tiranës. Ai është diplomuar për sociologji dhe më pas për shkencë politike e administrim publik në Middle East Technical University në Ankarë.

ynë mëmë" (Kadare, 2004); "Malli për Evropën e munguar pesë shekuj bëri që [Shqipërisë] t'i dukej e natyrshme që mbreti i saj i parë në liri të ishte një princ gjerman" (Kadare, 2005: 21-22); "Evropa e krishterë përpiqet ta marrë prapë Shqipërinë. 'Është imja, - thotë, - kthemani'" (Kadare, 1991: 111). Mirëpo shekujt kanë bërë të tyren: Shqipëria tenton të ikë prej Azisë, por në çastet e ritakimit me Evropën ndodhin keqkuptime, sepse ndonjëherë nëna nuk e njeh të bijën, për shkak të zakoneve dhe mësimëve që kjo ka marrë nga Azia. Këtë Kadareja e paraqet figurativisht me anë të një legjende të përmendur nga Leon Tolstoi, që flet shqiponje të robëruar që kur më në fund arrin të shpëtojë dhe të kthehet në familje, të afërmit nuk e pranojnë për shkak të një unaze që i kishte mbetur e lidhur në këmbë prej grabitësit. Në rastin e Shqipërisë dhe të vendeve të tjera të Ballkanit, unaza përfaqëson pasojat e sundimit të gjatë osman mbi gadishull (Kadare, 2006a). Mirëpo, ndodh edhe që bija të fajësojë dhe e të urrejë nënën për shpërfilljen e kësaj të fundit. Përsëri Azia përfiton dhe nënë e bijë rihumbasin njëra-tjetrën, duke rrezikuar ndarjen e përzetshme:

*Unë jam nga një vend që e ka humbur Evropën dy herë: herën a parë në shek. XV, kur ra nën pushtimin osman..., herën e dytë më 1944, kur ra nën diktaturën komuniste. Një humbje e tretë e Evropës do të ishte për Shqipërinë e fundbotshme (Kadare, 1996: 179).*

Duket se tashmë telenovela po shkon drejt zgjidhjes së lumtur, por duhen kapërcyer disa mëdyshje të fundit. Prandaj edhe botohet sprovë Identiteti evropian i shqiptarëve (Kadare, 2006b), për të larguar keqkuptimet që akoma kanë disa evropianë, të cilët i mbajnë shqiptarët për turq a gjysmë turq (Kadare, 2006c; Stefani, 2006).

Një paraqitje e tillë e marrëdhënieve të Shqipërisë me Evropën e zhvendos realisht debatin në sferën private dhe intime; ai është publik vetëm në trajtë sepse në përmbajtje bëhet fjalë për lidhje emotive, natyrore dhe primordiale midis nënës dhe bijës, për kultin e familjes. Nuk mund të ketë argumente racionalë, kritika apo mëdyshje për një lidhje të tillë. Prandaj edhe ata që shprehen ndryshe konsiderohen si armiq, si aleatë të Azisë, si barbarë, "haxhiqemalistë", "avokatë të orientalizmit", "mbetëza anakronike të osmanllisë, që gabimisht shkruajnë nga e majta në të djathtë", "talebane", "lindorë", "islamike", etj. Debati mbi integritimin në Evropë ka vdekur qysh në lindjen e tij, sepse është shtruar gabim si lidhje intime parapolitike. Kjo ndikon edhe politikën shqiptare të integritimit, sepse duke qëndruar në pozitat e një fëmije përpara prindit, elita politike ka merakun të kryejë, "detyrat e shtëpisë" që i ka caktuar Brukseli, (dhe shpeshherë i kryen sa për të kaluar radhën), duke e zhveshur në këtë mënyrë veten nga llogaridhënia para elektoratit dhe duke i hequr domethënien

sistemit demokratik (shih artikullin nga Blendi Kajsia në këtë botim).

## EVROPA NËN SHENJËN E HISTORICIZMIT

Ndodh edhe që tonet emotive, me ndjenja e mall për Evropën, të shoqërohen nga përpjekje për një teorizim racional. Mirëpo këtu shfaqet historicizmi, i kuptuar si tendencë intelektuale drejt një historie teorike që bën parashikimin historik nëpërmjet të zbulimit të "ritmeve", "rrugëve", "ligjeve" të evolucionit. Filozofi Karl Popper ka dëshmuar pamundësinë e historicizmit për të parashikuar rrjedhat e historisë, për vetë faktin se parashikimi ndikon në vetë zhvillimin e ngjarjeve që marrin kësajsoj një kthesë të paparishikuar: "Shkencëtari shoqëror përpiqet të gjejë të vërtetën, por në të njëjtën kohë, ai gjithmonë do të ushtrojë një ndikim të caktuar mbi shoqërinë. Vetë fakti që prononcimet e tij do të ushtrojnë një ndikim e prish objektivitetin e tyre" (Popper, 1996: 15). Historicizmi kthehet në një dogmë dhe trajtë sundimi autoritar mbi shoqërinë. Dihet se kjo ka ndodhur me historiografinë zyrtare shqiptare gjatë komunizmit, ku çdo ngjarje apo etapë historike interpretohej nga perspektiva e luftës së klasave dhe nën dritën e evoluimit të shoqërisë drejt revolucionit proletar. Kështu, rendi feudal duhej ndjekur qoftë edhe nga një përpjekje e dështuar e borgjezisë për të marrë pushtetin, në mënyrë që t'i hapej rruga revolucionit proletar. Prandaj u shpik "Revolucioni Demokratiko-Borgjezi Qershorit". Për të dhënë një shembull tjetër meqë historia e revolucionit proletar shqiptar duhej të zhvillohej sipas atij të Bashkimit Sovjetik, edhe në Shqipëri u krijua kategoria shoqërore e "kulakëve", të cilët vuajtën për dhjetëvjeçarë ndjekjen në emër të trilleve të historicizmit.

Në periudhën paskomuniste, historicizmi gjallon kur intelektualët shqiptarë, e riinterpretojnë historinë shqiptare rrotull një njësie të quajtur "Evropë" apo "Perëndim", që është nyja që përcakton pozitën e shënuesve të tjerë në ligjërim. Me të janë të lidhura zhvillimi, përparimi, qytetërimi, dija etj. Intelektualët gjurmojnë historinë shqiptare për të identifikuar ngjarjet dhe motivet që na kanë afruar apo larguar prej "Evropës" dhe për të gjetur një motiv, a impuls linear apo ciklik qoftë, që përcakton marrëdhëniet e shqiptarëve kundrejt Evropës dhe na ofrojnë argumente post hoc propter hoc. Parapëlqimi i tyre është për periudhën paraosmane, që shkon mbrapsht në kohë deri te pellazgët! Për dikë është gjuha shqipe që na vendos në themel të Evropës, për një tjetër janë rrënjët e Arbërit paraosman që duhen rizbuluar për t'u lidhur sërish me perëndimin (Misha, 1997), për një tjetër është Vija traumatike e Teodosit, që prej gati dymijë vjetësh i ka ndarë shqiptarët, madje edhe sot u çan më dysh trutë atyre (Plasari, 1992). Pashmangshmërisht periudha pesëqind vjeçare osmane shihet in toto si një kundërtezë e gjithçkaje që përfaqëson Evropa apo Perëndimi. Ndonjëherë anashkalohet tërësisht, thuhet se arbër-shqiptarët kanë qenë jashtë historisë

gjatë kësaj kohe, pra periudha osmane nuk është një kohë historike. Ndonjëherë ajo shihet si një tunel, në fund të të cilit shqiptarët dolën të shfityruar, pra në këtë rast periudha osmane është një kohë kundërhistorike. Prandaj intelektualët bëjnë sprovë teorike të tipit: "Të mos kishin ardhur këta vëllezër të rinj [osmanët], qysh në shek. XVI do të kishim universitetet tona" (Klosi, 2006). Kuptohet lehtë se edhe mbi këtë rrafsh historicist nuk mund të ngrihet një debat politik për të qenë mbi proceset e tanishme të integritit të Shqipërisë në BE, sepse është një lexim i historisë së prapthi dhe tejet përzgjedhës. Mund të debatohet pa fund nëse "Kultura kombëtare shqiptare në pjesën e saj më të madhe është plazmuar si kulturë romano-papnore" (Kulla, 2006) dhe nëse kjo na veçon nga Lindja, por lidhja me integritimin e sotëm në BE duket shumë e largët, aq më tepër që u hodh poshtë përmendja e vlerave të krishtera në dokumentin themeltar të organizatës. Mendoj se një shtrat premtues dhe të dobishëm për marrëdhëniet e Shqipërisë me Evropën përbëjnë argumentet që e konsiderojnë Evropën si një "horizont modernizues" për shqiptarët.

#### KONKLUZION: EVROPA DHE MODERNITETI SHQIPTAR

Ndër ata që u përfshinë në debatin Kadare-Qose, pati syresh që i konsideruan marrëdhëniet e shqiptarëve me Evropën në kuadrin e modernizimit të Shqipërisë. Kështu Piro Misha shkruan:

*Në të vërtetë gjatë gjithë rrjedhës së historisë sonë moderne s'është e vështirë të dallosh ekzistencën e dy rrymave kryesore të mendimit, të cilat i ndan vizioni i ndryshëm që kanë për të shkuarën e për të ardhmen. Deri në prag të Luftës së Dytë Botërore ato njiheshin me emërtimet Oksidentalitet dhe Orientalitet...shqiptarët kishin nisur rrugën e tyre të vështirë për të bërë një kapërcim të madh në kohë e në hapësirë, nga mesjeta në kohët modern, nga Azia në Evropë (Misha, 2006).*

#### NË TË NJËJTËN FRYMË SHKRUAN EDHE MUSTAFA NANO:

*Rilindja kombëtare shënoi kthesën e madhe. Pa të, sipas të gjitha gjasave ne nuk mund të ekzistonim. Fillimisht rilindasit e më pas të gjithë përfaqësuesit e kulturës shqiptare, njëri pas tjetrit e të gjithë së toku, i kanë mbajtur sytë nga perëndimi e kanë bërë ç'kishin në dorë për ta shkëputur popullin e tyre prej prapambetjes orientale. Ia kanë arritur qëllimit? Pikërisht ky është një diskutim që ia vlen të bëhet (Nano, 2006).*

Merita e këtyre dy analizave është se arrijnë të kapin faktin se marrëdhëniet Shqipëri-Evropë kanë domethënie të analizohen në kuadër të modernitetit. Evropa e shek. XIX përfaqësonte qytetërimin modern, që ishte i një natyre të veçantë prej të gjitha qytetërimeve të deriatëhershme dhe që po përshkonte gjithë botën, qoftë me anë të kolonive evropiane, qoftë me anë të

imitimit të modernitetit nga vendet e tjera. Përcjellësi kryesor i modernitetit evropian në pjesë të tjera të botës ishte nacionalizmi, që kërkonte organizimin e jetë politike rrotull bashkësisë së kombit. Nacionalizmi nuk është thjesht një ligjërime modern, por një ligjërime për modernitetin, që legjitimon ekzistencën e institucioneve moderne dhe mënyrës moderne të jetesës: teknologjinë, industrializimin, mendimin dhe arsimin shkencor, laicizmin, urbanizimin, përfshirjes e masave në politikë.

Rilindja Kombëtare Shqiptare nisi procesin e modernizimit, i cili u pasua prej elitave politike dhe intelektuale shqiptare gjatë shek. XX. Kuptimi modern linear i kohës krijon ndarjen midis përparimit dhe prapambetjes, me anë të të cilit gjykohet e shkuara dhe e ardhmja. Orientimi ndaj "Evropës"/ "Perëndimit" dhe "arratisja" prej "Lindjes" duhet parë si vullnet për t'u modernizuar. Mirëpo deri tani elitat politike dhe intelektuale shqiptare e kanë shtruar çështjen e modernizimit në terma evrocentriste, historiciste dhe orientaliste. Modernizmi shqiptar është evrocentrist, sepse e sheh Evropën si katalizator të modernitetit dhe përpiqet të imitojë zhvillimet evropiane në të gjitha fushat e jetës. Është historicist, sepse ndjek një vizion drejtvizor të zhvillimit. Është orientalist sepse e ndan botën në dy pjesë hierarkike, privilegjon "Evropën"/ "Perëndimin" dhe përjashton atë që e quan "Lindje" dhe që nuk është tjetër veçse panorama negative e karakteristikave të "Evropës"/ "Perëndimit", pra "Evropa"/ "Perëndimi" me kokë poshtë (shih Sulstarova, 2006). Mirëpo këto karakteristika të përbashkëta që ka modernizmi shqiptar në kohë të ndryshme që nga Rilindja nuk duhet të na fshihë dallimet horizontale dhe vertikale në të. Imitimi i Evropës moderne dikur do të thoshte ndjekje e modeleve totalitare fashiste. Po kështu, me gjithë retorikën kundërperëndimore, komunizmi shqiptar në etosin e tij modernizues ishte modernist dhe evrocentrist.

Misha në citimin e mësipërm, duke ndjekur Krist Malokin, një mendimtar i viteve 1930, thekson se periudha moderne është karakterizuar nga përplasja midis oksidentalëve dhe orientalëve dhe nuk përmend se Maloki termin "oriental" e përdor për kundërtëzën e vlerave që ai i quan "oksidetale" dhe moderne. E thënë ndryshe, askush nuk mund të pranojë të jetë "oriental" apo përfaqësues i "Orientit" në ato terma që i ka përcaktuar Maloki. Debati i viteve 1930 dhe ai i sotmi përcaktohet prej "oksidetaleve" të cilët akuzojnë njëri-tjetrin për "orientalë", sikurse tani akuzojnë rëndom Qosjen. Kurse Mustafa Nano thotë se kultura elitare që nga Rilindja ishte oksidetale dhe që nga fundi i shek. XIX i është imponuar një kulturë popullore orientale në Shqipëri. Dy llojet e kulturave i mendon si përjashtuese ndaj njëra-tjetrës, sepse e thotë qartë që shtysa përpara e njëjës do të thotë zbythje e tjetrës. Ky model është i verbër ndaj komunikimeve dhe ndërthurjeve të ndërlikuara midis kulturës elitare dhe masive, i veçon nga njëra-tjera dhe apriori e paragjykon të dytën si paramodernë, tradicionale



apo të prapambetur. Ai nuk sheh se si trajta të tradicionales bashkëjetojnë me trajta të modernes dhe se nuk janë aspak drejt zhdukjes.

Megjithëse moderne, analizat e mësipërme janë evropocentriste, historiciste dhe orientaliste. Si të tilla, të krahasuara me mendimin bashkëkohor politik dhe shoqëror në Evropë, ato janë provinciale. Për t'u ngritur prej provincialitetit, qasja moderniste shqiptare kanë nevojë të përballen me teoritë moderniste bashkëkohore. Sot pranohet se Evropa (perëndimore) nuk është më në ballë të zhvillimeve botërore siç ka qenë nga shek. XV deri në shek. XX. Në një epokë globale, tashmë Evropa është veçse një "provincë" e botës. Erik Hobzbaum thotë se "në fund të shekullit të parë evropian që nga Kolombi [shek. XX], ne, si historianë, nevojitet ta mendojmë të ardhmen e saj [Evropës] edhe si histori rajonale edhe si pjesë e historisë së botës" (Hobsbawm, 1997: 301). Pasoja kryesore në mendimin filozofik dhe shoqëror është historia evropiane nuk shihet më si mishëruese e historisë njerëzore si e tillë, dhe etalon i përparimit (shih p.sh. Vattimo, 2005). Provincializimi gjeopolitik i Evropës shoqërohet me provincializimin e mendimit historicist dhe evropocentrist. Kjo nuk do të thotë se vlerat dhe parimet e Iluminizmit relativizohen apo hidhen poshtë, por se ato tashmë janë globalizuar, janë një visar i vyer i të gjithë botës. Nuk mund të mendohet epoka moderne pa termat e Iluminizmit dhe të zhvillimeve evropiane pas tij, mirëpo kjo trashëgimi interpretohet nën dritën e përvojave jetësore në shkallë globale. Kështu "mendimi evropian është njëkohësisht i paçmueshëm dhe i papërshtatshëm për të na ndihmuar në shqyrtimin imtësor të përvojave të modernitetit politik në kombet joperëndimorë" (Chakrabarty, 2000). Prandaj, në një frymë të njëjtë, filozofi Xhani Vatimo e kupton filozofinë moderne si "filozofi e universale së shekullarizuar" dhe modernizimin si një "oksidantizim të zbehtë të botës", në një mjedis global ku Perëndimi dhe Evropa nuk mund të pretendojnë më rolin sipëran të qytetërimit. Ai thotë:

*Në përgjithësi, një filozofi që e njeh prirjen e botës perëndimore drejt perëndimit dhe prirjen e zbehtë të identiteteve të forta, mund të ndihmojë për ta konceptuar oksidantizimin e pashmangshëm të botës në përmasa që mund të kuturisim t'i quajmë të lehta, të buta, soft (Vattimo, 2005: 45).*

Megjithëse nuk bashkohem me karakterizimin që Rexhep Qosja i bën identitetit shqiptar si pjesërisht evropian dhe pjesërisht lindor, e konsideroj përpjekjen e tij teorike në kahun e duhur për ta kuptuar modernitetin shqiptar jo si proces drejtvizor dhe teleologjik, thjesht si një imitim të "modernitetit evropian", por si një proces i hapur, i papërfunduar dhe i ndërthurur me përvojat lokale, disa prej të cilave i zhvendos dhe i rrafshon, por disa të tjera i ruan, jo si mbeturina të përkohshme të një epoke të

kaluar, por si pjesë përbërëse të jetës moderne. Nga sa u tha më sipër, nuk jam aspak dakord me Mustafa Nanon, kur thotë se debati Kadare-Qose "nuk është ogur i keq në përpjekjet e vonuara të shqiptarëve për të përkufizuar njëherë e mirë vetëdijen e tyre identitare (pothuaj të gjithë kombet evropiane e kanë bërë tashmë këtë gjë)" (Nano, 2006). Në këtë fjali ndjehet tendenca homogjenizuese, evropocentriste dhe historiciste. Fundja, identitetet nuk mund të përcaktohen njëherë e mirë, por janë gjithmonë fusha veprimi të ligjërimeve të ndryshme. Në rrethana të caktuara mund të përftohet një identitet qendror, zyrtar, hegjemonist, por natyra e tij është gjithmonë e përkohshme, e kundërshtuar dhe gjithmonë ai ekziston me një shumësi identitetesh të tjerë, paçka se këta mund të jenë të shtypur a në skaje. Kjo vlen edhe për "identitetin evropian të shqiptarëve". Kjo është e vërtetë edhe për Evropën, identiteti i së cilës nuk mund të quhet i përcaktuar njëherë e përgjithmonë. Zgjerimi i Bashkimit Evropian nuk është thjesht zgjerim i kufijve lindor i një organizmi shumëkombësh, por njëkohësisht edhe ndryshim i natyrës së këtij organizmi. Nëse Bashkimi Evropian në fazën e vet fillestare nënkuptonte bashkimin e vendeve moderne në kostelacionin qytetëruar perëndimor, tashmë ai po zgjerohet në kostelacionet qytetëruar sllavo-bizantine dhe osmano-islamike, të cilat kanë përjetuar varietete të ndryshme të modernitetit (Delanty, 2003).

Shqipëria pa dyshim që do të ndikohet në mënyrë rrënjësore nga modelet moderne të Bashkimit Evropian shpresohet se në të ardhmen jo shumë të largët do të përfshihet në BE, duke u kthyer në një "provincë" e saj, mirëpo kjo nuk përjashton ndërkohë ndërhyrje të tjera në "modernitetin shqiptar" as ngrirjen e identiteteve dhe institucioneve evropiane në trajtën që ato janë sot. Prandaj, njohja me teoritë bashkëkohore mbi modernitetin (për një përmbledhje të debateve të fundit mbi modernizimin shih p.sh. Lee, 2006; Schmidt, 2006) është e dobishme për kapërcimin e dobësive që ndeshen në debatin publik në Shqipëri. Kjo njohje do të japë një panoramë më realiste të shoqërisë bashkëkohore shqiptare, do të jetë një ndihmesë për çlirimin nga provincializimi i mendimit të sotëm intelektual dhe do të krijojë kushtet për një debat mirëfilli politik mbi integrimin evropian të Shqipërisë.

#### BURIMET:

**Chakrabarty, D. (2000).** Provincializing Europe: Postcolonial Thought and Historical Difference. Princeton; Oxford: Princeton University Press.

**Delanty, G. (2003).** "The Making of a Post-Western Europe: A Civilizational Analysis". Thesis Eleven 72: 8-25.

**Fuga, A. (2004).** Shoqëria periferike: Sociologji e ndryshimit në Shqipëri. Tiranë: ORA.



- Hobsbawm, E. (1997).** "The Curious History of Europe". On History. London: Abacus.
- Kadare, I. (1991).** "Lamtumira e së keqes". Endërr Mashtruese: Tregime dhe Novela. Tiranë: 8 Nëntori.
- Kadare, I. (1996).** Dialog me Alain Bosquet. Tiranë: Onufri.
- Kadare, I. (2004).** "Kadare: Majft më me frymën e Partisë!". Gazeta Shekulli. Tiranë, 25.11.2004.
- Kadare, I. (2005).** Dantja i pashmangshëm. Tiranë: Onufri.
- Kadare, I. (2006a).** "Ballkani në kërkim të Evropës". Gazeta Shqip. Tiranë, 13.08.2006.
- Kadare, I. (2006b).** Identiteti evropian i shqiptarëve. Tiranë: Onufri.
- Kadare, I. (2006c).** "E keqja prapa një abuzimi të madh". Gazeta Shekulli. Tiranë, 23.06.2006.
- Klosi, A. (2006).** "Intervistë me publicistin Ardian Klosi". Gazeta Shekulli. Tiranë, 20.05.06.
- Kulla, N. (2006).** "Marrëdhëniet shqiptaro-papnore". Gazeta Shekulli. Tiranë, 24.07.2006.
- Lee, R. L. M. (2006).** "Reinventing Modernity: Reflexive Modernization, vs Liquid Modernity, vs Multiple Modernities". European Journal of Social Theory 9(3): 355-368.
- Mandala, M. & M. Marku (2006).** "Identiteti shqiptar midis nervozizmit dhe cektësisë. Intervistë me studiuesin dhe albanologun arbëresh Mateo Mandala". Fjala 1: 251-268.
- Misha, P. (1997).** Duke kërkuar rrënjët...ose kthimi i shqiptarëve në histori. Tiranë: Toena.
- Misha, P. (2006).** "Keqkuptimet e Qoses për identitetin e shqiptarëve". Gazeta Shqip. Tiranë, 23.05.2006.
- Nano, M. (2006).** "Kultura perëndimore dhe qytetërimi lindor i shqiptarëve". Gazeta Shqip. Tiranë, 22.05.2006.
- Plasari, A. (1992).** Vija e Teodosit rishfaqet: Nga do t'ia mbajnë shqiptarët. Tiranë.
- Popper, K. (1996).** Mjerimi i historicizmit. Tiranë: Onufri & Fondacioni Soros.
- Stefani, A. (2006).** "Shqipëria dhe ndeshja e qytetërimeve". Gazeta Panorama. Tiranë: 14-17.06.2006.
- Schmidt, V. H. (2006).** "Multiple Modernities or Varieties of Modernity?". Current Sociology 54(1): 77-97.
- Sulstarova, E. (2006).** Arratisje nga lindja: Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja. Tiranë: Dudaj.
- Vattimo, G. (2005).** "Filozofia dhe bjerrja e botës perëndimore". Nihilizmi dhe emancipimi. Tiranë: Dita 2000 & IPLS



## EUROSKEPTICIZMI - NJË VËSHTRIM NGA E MAJTA

Fatos LUBONJA\*

**P**ërgjithësisht vijmë nga një kulturë dhe një sistem arsimor që nuk ka nxitur as dyshimin dhe as eksperimentin për gjëjeten e së vërtetës, por bindjen tek fjala e autoritetit. E në përgjithësi kjo kulturë mbetet dominante edhe sot; prandaj në kontekstin shqiptar na del në mënyrë dramatike nevoja për dyshimin si instrument i mendimit dhe i kulturës në tërësi. Pa dyshim, një nga fushat ku është reflektuar kjo kulturë e mosvënies në dyshim të autoritetit është edhe ajo e marrëdhënieve me Perëndimin ku spikat bindja ndaj autoritetit Perëndim, që shpesh ka qenë edhe sinonim i Evropës, adhurimi me verbëri dhe mizizimi i modeleve dhe i të vërtetave të tij. Fakti që sot kemi filluar të flasim për eurodyshimin tregon se kemi arritur në një kohë kur shumë dështime të poskomunizmit na kanë çuar edhe tek nevoja për të parë në mënyrë kritike edhe Evropën edhe marrëdhënien tonë me të, e më në përgjithësi do të thojë për të dekonstruktuar mitin Evropës ashtu sikurse shumë mite të tjera.

### NJË VËSHTRIM I SHKURTËR I MITIT EVROPË

Rënia e komunizmit në Shqipëri, ashtu sikurse në tërë kampin e udhëhequr nga BS, nuk mund të shpjegohet pa patur parasysh edhe procesin e ngritjes së mitit të Evropës që në vende të ndryshme ka filluar të ngrihet në kohë të ndryshme. Përgjithësisht ky mit (si pjesë thelbësore e mitit Perëndim) ka pasur dy trajta: atë të tokës së premtuar si dhe atë të shpëtimtarit. Miti i shpëtimtarit dhe miti i tokës së premtuar në perceptimin mitik të shqiptarëve bashkoheshin në figurën e një zoti monolitik. Pa dyshim njiheshin dallimet historike dhe gjeografike të vendeve të ndryshme perëndimore. Ekzistonin preferenca, por Evropa nuk shihej e fragmentizuar përsa i përket ëndrrës për liri dhe demokraci. Si tokë e premtuar ajo më shumë shihej si një kopësht me parcela të ndryshme ku sejcili do të mund të zgjidhte atë që i pëlqente më shumë. Kurse si shpëtimtar shihej si një e tërë. Ky perceptim ishte i fortë në vitet e para të tranzicionit dhe nuk mund të thuhet se ka mbaruar tani, por çprej asaj kohe perceptimi i Evropës si pjesa kryesore e perëndimit ka ndryshuar jo pak. Gjatë këtyre viteve njohja e realitetit të ndryshme perëndimore, por edhe ngjarje të tilla si roli i vendeve të ndryshme evropiane në ndarjen e Jugosllavisë, apo konstatimi i interesave të përkundërta në Shqipëri të fqinjëve që, si anëtarë të komunitetit Evropian, në vizionin mitik, konsideroheshin si të pandarë kanë ndikuar jo pak

në fragmentizimin e zotit monolitik Perëndim. Në këtë proces fragmentizimi hyn edhe diskuri gjithnjë e më i shpeshtë për ndarjen dhe konkurrencën midis SHBA-ve dhe Evropës.

Duke u ndalur tek këta shembuj do të thojë se i gjithë ky proces kalimi nga adhurimi i mitit tek hutimet dhe hidhërimet e zhgënjimeve, ku bën pjesë, pa dyshim, edhe njohja sadokudo e qëndrimeve kritike të vetë perëndimoreve ndaj realitetit të tyre, ka sjellë njohjen njëfarsoj të realitetit të Perëndimit si një botë me plot probleme - aspak një tokë e premtuar, - duke bërë që edhe në Shqipëri të lindë apo të krijohen premiset e lindjes së një frymë kritike për Perëndimin. Megjithatë ky ndryshim nuk mund të thuhet se është sistemuar nëpërmjet një mendimi të pjekur kritik.

Një nga gjërat që më pak se çdo tjetër kanë zbuluar shqiptarët në Perëndim, në procesin e dekonstruktimit të mitit Evropë janë dallimet midis së majtës dhe të djathtës evropiane. Nuk mund të mohohet se kontakti me nostalgjitë e së majtës për vendet ish komuniste si dhe me antiamerikanizmin e tyre ashtu sikurse edhe kontakti me racizmin e së djathtës edhe ndaj shqiptarëve kanë qenë elementë që kanë hyrë në procesin e ndryshimit të perceptimit të Evropës, por ata më shumë se çdo gjë kanë krijuar përshtjellim në përpjekjen për të rikonstruktuar imazhin e Perëndimit e të Evropës në veçanti sesa ndonjë kthjellim. Principe të majta dhe të djathta, progresiste dhe konservatore, nacionaliste dhe kozmopolite, të pasurish dhe të varfërisht i gjen ende në Shqipërinë e sotme të përzjera tek çdo individ dhe tek çdo parti në një mishmash pa trajtë e pa formë.

Kur flitet për euroskepticizëm sot nënkuptohet kryesisht një dyshim e kritikë që i bëhet nga e djathta projektit të bashkimit evropian. Është qëndrimi i atyre partive politike e intelektualëve, kryesisht në vendet e lindjes ish komuniste, si Polonia psh., që kanë vënë në pah rezervat dhe dyshimet që sipas tyre paraqet hapja ndaj Evropës dhe veçanërisht futja në BE. Këto rezerva e dyshime janë kryesisht dy farëshe: në lëmin kulturor si humbje e vlerave tradicionale si dhe në lëmin ekonomik - sepse euroskeptikët ngulmojnë se këto vende, duke qenë me një ekonomi më të dobët sesa vendet e Evropës Perëndimore, do të mbeten në rolin e një ekonomie të skllavëruar apo në shërbim të asaj perëndimore.

Ndërkaq edhe në vetë vendet perëndimore ekziston një euroskepticizëm i djathtë. Ky sillet kryesisht rreth partive nacionaliste, si ajo e Le Pains në Francë që kërkojnë tu përgjigjen sensibiliteteve të atyre shtresave shoqërore në vendet e tyre që kanë deri qëndrime raciste ndaj të huajve e që kryesisht janë të shqetësuar jo vetëm nga bjerrja e vlerave kombëtare, por mbi të gjitha ngase tek hapja shohin depërtimin në vendin e tyre të lindorëve të cilët do të rrisin, sipas tyre, edhe më tepër nivelin e pasigurisë së jetës nëpërmjet kriminalitetit që mund të sjellin si dhe nëpërmjet zënies së vendeve të punës. Kjo u pa qartë në refuzimin e kushtetutës evropiane nga partitë e djathta dhe

\*Fatos Lubonja është publicist, shkrimtar dhe analist i njohur në shtypin shqiptar. Ai është gjithashtu botues dhe kryeredaktor i revistës "Përpjekja". Ai ka botuar një sërë librash, studimesh dhe komentesh mbi komunizmin shqiptar, situatën politike, demokracinë dhe tranzicionin shqiptar.

elektorati i tyre.

E majta, si sistem vlerash, po të kemi parasysh edhe rrënjët e saj tek Iluminizmi edhe faktin se konsiderohet si progresiste, përfytyrohet si frymëzuesja dhe përkrahësja kryesore e projektit evropian. Dhe kështu është në tërësi, por ndërkaq, po të kemi parasysh refuzimin e kësaj kushtetute në referendumin në Francë do të vemë re se ky refuzim vinte edhe nga e majta, më saktë nga ato parti ose fraksione partish që janë të vendosura më majtas në spektrin politik sesa qendrat e majta. Ato e kanë refuzuar kushtetutën dhe në tërësi projektin evropian për arsye të tjera nga ato që paraqiste e djathta. Refuzimi i tyre mbështetet mbi idenë e refuzimit të një Evrope të liberizmit dhe neoliberalizmit siç është ai që dominon në projektin e hartuesve kushtetutës. Kjo e majtë pra kërkon ndërtimin e një tjetër Evrope për ta pranuar atë, ku të ketë shumë më tepër peshë mbrojtja sociale. Kritika kryesore e saj qëndron në kërkesën për moshumbjen e vlerave të shtetit social kombëtar kur të kalojmë në nivel evropian.

Kur flitet për euroskepticizmin në Shqipëri, si nga e djathta ashtu edhe nga e majta, që sipas mendimit tim sot për sot është thujse krejtësisht mungues në artikulet intelektuale, politike dhe në media, diskutime të tilla duhet të synojnë që të rritet njohja e këtyre dy qëndrimeve euroskeptike. Unë do ta ve theksin tek nevoja për një dyshim e kritikë nga e majta që sipas meje është i nevojshëm edhe në kuptimin e zhvillimit të një ndërgjegjeje të majtë në Shqipëri e cila edhe ajo sot mungon thujse krejtësisht.

Arësyt kryesore pse mungon një mendim i majtë evropian sot në Shqipëri duhet ta gjemë tek ndërthurja e faktit se vendi ynë doli më 1991 nga 45 vjet tragjedi komuniste, (e komunizmi konsiderohet si ideologji e majtë), me faktin se e tërë Evropa Perëndimore konsiderohej si armiku/e kundërta e komunizmit si dhe me triumfin në ato vite të liberizmit në Evropë. Ndërthurja e këtyre tre faktorëve ndikoi që liberizmi të merrej në Shqipëri në mënyrë jo kritike, më mirë të them në mënyrën se si u morr ideologjia komuniste, madje mund të thuash se, në një farë mënyre, e zëvendësoi atë.

Një arsye tjetër është se, elitat kulturore politike u impenjuan në orientimin e shoqërisë shqiptare drejt imitimit të modeleve dhe teorive që vinin nga Evropa dhe SHBA, pa mundur të zhvillonin sensin kritik ndaj tyre pasi edhe objektivisht ishte shumë i vështirë të bëhej njherësh edhe implementimi edhe kritika. Por klasa politike kulturore shqiptare ka qenë refraktare ndaj ideve të së majtës evropiane, jo vetëm për shkak se e kaluara ende e freskët komuniste e vendit i ka bërë njerëzit të jenë refraktarë ndaj ideve të së majtës në përgjithësi, jo vetëm për shkak të përqaimit pa frymë kritike të modeleve liberale, por edhe për shkak të një ndjenje faji të shumicës së individëve që e përbëjnë këtë klasë për shkak të së kaluarës së tyre komuniste.

## ËNDRRA AMERIKANE NË EVROPË DHE KUNDËRSHTIMI I SAJ

Përgjithësisht vështrimi kritik nga e majta i Evropës lidhet ngushtë me një kritikë ndaj projektit neoliberalist të globalizimit. Kjo, pasi e majta e ka parë globalizimin kryesisht si triumf të neoliberalizmit amerikan dhe jo rrallë e ka trajtuar edhe si formë neokolonializmi ekonomik dhe kulturor. Ndërkaq, vendet ish komuniste dhe veçanërisht Shqipëria hynë në epokën e re me "Ëndrën amerikane" të globalizimit, të idealizuar dhe të zilepsur nga tërë bota (edhe nga një pjesë e mirë e Evropës) e që, në një farë kuptimi është një vizion i djathtë, që u zhvillua në SHBA shumë më tepër se në Evropë edhe si një përgjigje ndaj komunizmit. Ajo e ve theksin tek mundësia e pakufizuar e çdo individi për të kërkuar suksesin, e që në interpretimin e kohës ku jetojmë do të thotë mbi të gjitha, nëse jo tërësisht, sukses ekonomik. Në kontekstin e globalizimit e të mbijetesës në konkurrencën globale në shumë vende të Evropës ka pasur reforma që gjithnjë e më shumë kanë synuar afrimin me modelin amerikan. Mendoj se është mirë të njihet se këto reforma janë kontestuar nga e majta evropiane mbi idenë se ëndrra amerikane përqendrohet shumë në progresin material personal dhe preokupohet shumë pak në mirëqenien e përgjithshme të njerëzimit. Jeremy Rifkin, një amerikan i majtë që i ka kritikuar këto tendenca duke bërë thirrje për një "ëndërr evropiane" që duhet ngritur mbi një traditë të vlerave të së majtës e të shtetit social e konsieron të pamjaftueshme ëndrën amerikane në këtë botë të karakterizuar nga rreziku, nga diversiteti, nga ndërvartësia. Përballë saj ai ve atë që e quan "ëndrra evropiane" e cila, sipas tij, ka lindur në kryqëzimin e postmodernizmit me erën emergjente të globalizimit. Duke bërë një krahasim midis ëndrrës evropiane dhe asaj amerikane ai thotë se ëndrra evropiane "...e ve theksin në marrëdhëniet komunitare më shumë sesa tek autonomia individuale, tek diversiteti kulturor më shumë sesa tek asimilimi, tek cilësia e jetës më shumë sesa tek akumulimi i pasurisë, tek zhvillimi i qëndrueshëm, që i merr parasysh të tëra gjërat më shumë sesa tek rritja e pakufizuar materiale, tek "loja e thellë" më shumë sesa tek lodhja e pafundme e punës, tek të drejtat njerëzore universale dhe ato të natyrës më shumë sesa tek e drejta e pronës, tek bashkëpunimi global më shumë sesa tek ushtrimi unilateral i fuqisë." Kush jeton në Shqipëri e kupton menjëherë se sa pak gjejnë jehonë në mendjen e shqiptarëve të dehur me ëndrën amerikane idetë e Rifkin si një propozim për një të ardhme tjetër evropiane i ardhur nga e majta.

## KONKLUZION: ORIENTALIZMI DHE EUROSKEPTICIZMI (ED'JART SAID)

Pa pretenduar kurrsesi se e kam shterruar temën, përkundrazi vetëm sa e kam cekur, dua të konkludoj duke vënë në dukje edhe një tjetër vizion të Evropës ndër shqiptarët të pa vënë në dyshim dhe të pakritikuar. E kam fjalën për vizionin e

ngulitur nga orientalizmi i cili propozon një qasje manikeiste dhe sempliste ndaj dallimeve midis Lindjes e Perëndimit sipas të cilit vizion Perëndimit i vishen cilësime pozitive, ndërsa Lindja trajtohet si "tjetri", si e kundërta e Perëndimit. Ky vizion ka qenë pjesë e ideologjisë nacionaliste shqiptare që në kohën e Naim Frashërit e ka vazhduar edhe në periudhën komuniste duke mbetur edhe sot thuhetse krejtësisht i pakritikuar. Ky është një vizion që sikurse thotë Eduard Saidi e ngurtëson përfytyrimin e dy njësiteve gjeografike duke i trajtuar ato si thelbësisht homogjene, johistorike, të pandryshueshme, të izolurara dhe në kundërvënie me njëra-tjetrën. Kurse, gjithë sipas tij, realitetet që përfshijnë termat Lindje dhe Perëndim janë tejet heterogjene, historikë, të ndryshueshëm, në marrëdhënie shumëplanëshe me njëri-tjetrin dhe jo domosdoshmërisht në kundërvënie. Me anë të ligjërimit orientalist krijohet shëmbëlltyra jashtëkohore e një qytetërimi perëndimor të bazuar në arsye, shkencë, teknologji, tolerancë, laicizëm, demokraci, të drejtat e njeriut, etj. kurse Lindja paraqitet si pasqyra negative e Perëndimit, si mungesa e karakteristikave të Perëndimit. Në këtë mënyrë Lindja - një term që mund të shënojë edhe Rusinë, edhe Evropën Lindore, edhe botën arabe, botën islamike, Indinë apo Lindjen e Largët - mbetet gjithmonë e palëvizshme në një shkallë më të ulët qytetërimi, e bazuar në pasione, bestytni, misticizëm, injorancë, fanatizëm, despotizëm dhe, ç'është më e rëndësishmja, kjo Lindje përbën gjithmonë rrezik për Perëndimin.

Shqiptarët e kanë ndërtuar vizionin e tyre mbi Evropën në përputhje thuhetse të plotë me këtë vizion manikeist dhe konfliktual të dallimeve Lindje Perëndim. Të edukuar me këtë vizion ata kanë ushqyer shumë paragjykime raciste ndaj joevropianëve ndaj botës arabe dhe muslimane veçanërisht. Ndërkaq Shqiptarët kanë nevojë ndoshta më shumë se të tjerë ta njohin kritikën e Saidit ndaj orientalizmit sepse janë edhe vetë një popull që nën këndvështrimin e orientalistëve evropianë konsiderohen si lindorë dhe shumicë muslimane dhe jo si perëndimorë. E për më tepër sepse ata sot janë popull emigrantësh.

Në kuadrin e dyshimit dhe qëndrimit kritik ndaj vizionit orientalist të Evropës do të doja të përmendjamë, për ta mbyllur, dekonstruktimin që i bën Derrida konceptit të tolerancës që i atribuohet Evropës si një nga vlerat e saj kryesore që e dallojnë nga Lindja. Ai e konsideron atë një koncept me origjinë fetare, si një koncept që presupozon ekzistencën e një superiorit që i ve një prag një inferiorit të cilin e toleron deri në atë prag si dhe një koncept që ka edhe elementin biologjik të asimilimit brenda, pra që nënkupton asimilimin e kulturave të emigrantëve nga kultura evropiane. Derrida propozon që Evropa ka si sfidë të fundit të saj "mikpritjen e pakushtëzuar" me çka kupton pranimin e tjetrit të ndryshëm me kulturën e tij. Besoj se vlen dyfish për shqiptarët ky vështrim kritik, sepse midis shqiptarëve ka një prirje shumë të fortë për ta kuptuar integrimin në Evropë si një pranim të pakushtëzuar të asimilimit, si për të hequr damkën lindore që ata mendojnë se kanë.



## NORMA EVROPIANE DHE OPINIONI LOKAL: MANGËSITË E PËRQASJES INSTITUCIONALISTE

PROF. DR. Artan FUGA\*

**P**rovat se opinioni shoqëror shqiptar përgjatë këtyre dekadave ka qenë për një integrim të shpejtë evropian të vendit të tij janë të pakundërshtueshme. Bile, mund të thuhet pa asnjë ndrojtje se këto prova shkojnë shumë më larg dhe më thellë ndër vite. Njëra nga këto prova pati një fund tragjik sepse u shtyp me forcë, me rreptësi dhe me propagandë prej pushtetit totalitar aty nga fillimet e viteve '70. Pak më parë se kjo kohë, regjimi (ende nuk është botuar ndonjë dokument që ta shpjegojë bindshëm se për çfarë shkaku), u duk sikur e çliroi pak rripin e propagandës dhe të censurës ndaj artit, kulturës dhe letërsisë evropiano-perëndimore. Dhe brenda shumë pak kohësh publiku, konsumatori i artit dhe i letërsisë, vetë krijuesit, regjisorët, ndofta edhe vetë organizatorët e ngjarjeve artistike në nivel kombëtar-nisën, qoftë edhe duke imituar, të drejtojnë antenat e ndërgjegjes drejt Perëndimit.

Dënimi i rëndë i festivalit XI në Radiotelevizion dhe gjithë fushata e represioneve që e shoqëroi atë, treguan hapur se elita intelektuale dhe artistike e vendit, vetë publiku, po të lihej i lirë dhe disi i pakontrolluar, prirej drejt shijeve dhe estetikës evropiano-perëndimore. Ashtu sikurse opinioni shoqëror shqiptar në fund të viteve '80 dhe në fillim të viteve '90 kishte si busull orientimi modelin evropian të zhvillimit, prandaj edhe parulla "E duam Shqipërinë si e gjithë Evropa" zinte një vend të parë në sloganet propagandiste të kohës, të drejtuara kryesisht kundër pushtetit komunist apo kundër forcave regresive të kohës.

Fakti i tretë bashkëkohor që dëshiroj të përmend lidhet me atë eksod masiv që shqiptarët ndërmorën për t'u hedhur në brigjet evropiane menjëherë sapo kufijtë e territorit shqiptar u dukën se u lëkundën dhe i shpëtuan kontrollit të administratës dhe forcave të sigurimit të pushtetit totalitar. Dikush mund të thotë se, vërtet, kështu është, por emigrantët shqiptarë u hodhën ta zëmë në brigjet italiane sepse atje u dha mundësia dhe jo për ndonjë parapëlqim evropiano-perëndimor. Ku të shkonin tjetër? Është e vërtetë, por kjo nuk hedh poshtë lidhjet shpirtërore të shqiptarëve me Perëndimin. Sa pak nga ata shqiptarë që më pas u bënë qytetarë me të drejta të plota të shteteve të ndryshme perëndimore,

i lanë këto vende për t'u hedhur në vende të Lindjes apo orientale? Shumë, shumë pak, për të mos thënë aspak. Mjaftojnë këto tre fakte të kohëve të reja për të dëshmuar orientimin kulturor të shqiptarëve dhe ambicien dhe dëshirën e tyre për t'u bashkëngjitur Perëndimit në përgjithësi dhe atij evropian në mënyrë të veçantë. Dhe pikërisht këtu merr zanafillën edhe një kontradiktë e fuqishme, sepse, ndërsa duket qartë se popullsia shqiptare është tepër e lidhur me Evropën Perëndimore dhe individualisht ka bërë çmos për ta çarë rrugën për atje, vetë vendi, vetë shoqëria shqiptare është më pas, edhe më pas në procesin e integritit evropian edhe se shoqëri të tjera të Evropës Lindore, të cilat edhe për shkak të qytetërimit sllav, edhe për shkak të një feje ortodokse, i qëndron disi më larg Perëndimit, i cili sigurisht që nuk mund të veçohet me thikë nga influenca e vlerave të krishtera dhe katolike që e kanë ngjizur si qytetërim.

E gjitha sa parashtroam më lart ka ndofta vlerë për të mos krijuar keqkuptime. Por, fakti se kolektivisht shqiptarët janë treguar proevropianë, nuk ka mundur të ndalojë që procesi i integritit evropian të Shqipërisë të njohë vonesa dhe ngadalësi të konsiderueshme. Përse? Kjo pyetje do të kërkonte një farë kohe për t'u sqaruar, sepse përgjigja për të duket se është shumë e ndërlikuar dhe komplekse. Në këtë shkrim do të ndalem vetëm në një aspekt që më duket se tani për tani luan një rol jo të vogël në krijimin e kundërshtisë që prekëm më lart.

Nga pikëpamja artistike, ligjore, politike dhe nga ndonjë aspekt tjetër, veçanërisht mbi disa anë që lidhen me të drejtat e njeriut qytetarët shqiptarë i kanë përqaftuar gradualisht dhe jo fare keq mësimet evropiano-perëndimore. Përparime të dukshme janë bërë sidomos lidhur me përafrimin e korpusit të ligjeve, normave dhe standardeve politike, të drejtave të njeriut që zbatohen në Shqipëri me ato të vendeve tashmë të integruara në Bashkimin Evropian. Këto norma ligjore prekin anë nga më të ndryshmet të realitetit shoqëror, familjen, shtetin, gjykatat, ekonominë, proceset e urbanizimit etj.

Mirëpo studimet sociologjike në terren na tregojnë se ekziston megjithatë një hendek i madh midis universit të ligjeve dhe të normave juridike dhe botës së opinionit shoqëror. Kjo e dhënë na ka ardhur më së shumti duke studiuar dhe verifikuar nga afër sjelljen kolektive dhe individuale të operatorëve shoqërorë shqiptarë në fusha nga më të ndryshme të jetës. Atë na e kanë dëshmuar anketa sociologjike në terren, analiza e të dhënave ekonomike të vendit apo edhe vëzhgime të ndryshme empirike.

Ku është universi i normave juridike dhe politike dhe ku është opinioni shoqëror? Më duket se në disa aspekte ata përputhen me njeri-tjetrin, por në drejtime të tjera kanë midis tyre dallime dhe largësi jo fort të vogla. Mirëpo këtu fillon pikërisht edhe çështja që duam ta trajtojmë konkretisht. Nëse te ne vijnë dhe bëhen pjesë e legjislacionit tonë ligje, norma juridike, rregulla administrative që kanë frymë evropiano-perëndimore, të cilat

\*Pedagog, filozof dhe bashkëpunëtor shkencor i laboratorit LADYSS (CNRS - Universiteti Paris X), Francë. Z.Fuga është autor i disa librave të botuar në shqip dhe frëngjisht ("Shoqëria periferike", "Ikja nga kompleksi i Rozafës", "Lexime në komunikim", "Majtas jo Djathas", "Shtigje drejt guvës së gjarpri") si dhe i dhjetëra artikujve analitikë në shtyp. Ai do të angazhohet në UET në mësimdhënie e teorive të komunikimit. Z.Fuga ka një përvojë të gjatë pedagogu në Universitetin e Tiranës si dhe në disa universitete të Parisit

mbërrijnë me rekomandimet dhe porosinë e Bashkimit Evropian, a do të thotë kjo gjë se ato janë gjithmonë në përputhje me humoret e opinionit shoqëror shqiptar? Dhe më tej akoma, a do të thotë se kjo botë normative që vjen në anët tona është e tëra në përputhje me normat morale, me vlerat etike, me modelet e perceptimit, me mënyrat e sjelljes kolektive dhe familjare të shqiptarit?

Vështirë të japim një përgjigje të plotë dhe të sigurt pohuese këtyre pyetjeve, ndonëse subjektivisht dhe personalisht do ta dëshironim shumë që të ishte kështu. Por, studimet në terren, studimet konkrete dhe përvojat jetësore kryesisht, nuk na lejojnë të jemi më shumë optimistë sesa duhet. Le të marrim disa shembuj të thjeshtë. Nga Perëndimi dhe Bashkimi Evropian vijnë vlera ideologjike dhe norma juridike, të cilat kërkojnë dhe kanë bërë disi që në Shqipëri të vendosen disa nga elementët e shoqërisë së tregut. Edhe realisht mund të thuhet se ka pjesë të shoqërisë, të cilat funksionojnë pak a shumë sipas këtyre normave, standardeve, vlerave. Paga, prona, të drejtat në punë, raportet midis pronarëve dhe punëmarrësve apo e drejta e grevës, etj., etj. Por, sa larg është bota ideale e normave juridike dhe ideologjike prej universit të sjelljes reale të operatorëve socialë që lëvizin në terren, që kanë interesa, që shquhen për mendësi të caktuara lokale përgjatë veprimtarisë së tyre ekonomike?

Në ekonominë reale gjendja është radikalisht e ndryshme. Një pjesë e konsiderueshme e punës së bërë në ekonominë shqiptare, për shembull, nuk është fare monetarisht e pagueshme. Kjo ndodh në zonat rurale, pra në ekonominë bujqësore familjare, në të cilat pothuajse nuk njihet fare marrëdhënia punë - pare midis aktorëve shoqërorë familjarë. Prindi shqiptar nuk është mësuar që të paguajë fëmijët e tij brenda hapësirave ekonomike që i quan si pjesë të zonave brenda mureve të shtëpisë. Dikush mund të thotë se kjo mungesë e marrëdhënies monetare gjatë procesit të punës vjen sepse në ekonominë familjare bujqësore prona mbi tokën është kolektive, e familjes. Pra, do të vazhdonte kundërshtimi, atje nuk kemi marrëdhënie midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, por ndodhemi më tepër përpara një marrëdhënieje që karakterizon raporte midis pronarëve të të njëjtit titull pronësie, pra të bashkëpronarëve. Do të thoshim se ky kundërshtim nuk duket edhe aq i bazuar, sepse edhe nëse do t'i merrnim operatorët ekonomikë familjarë më tepër si bashkëpronarë, përsëri do të duhej të kërkonim nëse ata e kanë ndarë financiarisht dhe ekzaktesisht pronën e tyre në pjesë të qarta përkatëse. Vështirë se ndodh ndokund, në ndonjë cep të Shqipërisë, kështu. Kjo do të thotë se marrëdhëniet e pronësisë në fakt qëndrojnë mbi një terren lidhesh familjare, të cilat mbizotërohen jo nga faktorë të thjeshtë normativë e ligjorë, të ardhur nga bashkëkohësia apo nga Bashkimi Evropian, por që drejtohen nga mendësi lokale, tradicionale, nga norma etike familjare, në përgjithësi disi patriarkale dhe konservatore. Në këtë rast universi pronësor që ka prirje të duket si i orientuar nga vlera evropiane, nga frymëzime

perëndimore, në fakt mbivendoset në një shtrat moral, etik, tradicional, lokal, shpesh herë konservator. Që këtej lindin shumë tensione dhe kundërshti, rastet konkrete të të cilave do të mund t'i gjenim anë e mbanë krahinave të vendit.

Le të marrim një rast tjetër. Prona familjare dhe ndërmarrja e shërbimeve e tipit familjar që vihet re se është shumë e përhapur në zonat urbane, kafene, restorante, hotele, pika servisesh, dyqane etj. Në këto rast dihet se pronësia është individuale, ajo i takon më shumë njërit prind ose të dy prindërve të marrë së bashku. Fëmijët ose gjyshërit që punojnë atje, megjithatë, nuk ndodh shpesh që të paguhen me para në dorë apo me forma të tjera shpërblimi për punën e bërë. Kjo e fundit konsiderohet punë në gjirin e familjes. Prona nuk konsiderohet si në mall, por si e një e mirë familjare, që siguron të tashmen dhe të ardhmen e saj nëpërmjet punës së përbashkët të papaguar. Në fakt, pikërisht për këtë arsye ky kapital i vogël nuk falimenton. Ai është në krizë sepse është i vogël, dhe nuk falimenton pikërisht sepse është i vogël dhe me substrat familjar. Dobësia dhe forca e tij qëndrojnë në të njëjtin vend. Ai është i dobët sepse është i fortë dhe është i fortë sepse është i dobët. Në çastin kur pronarët - prindër do të duhej të paguanin për punën e bërë fëmijët apo të afërmit e tyre, pra do të zbatonin sipas letrës normën ligjore dhe etike evropiane (puna paguhet), atëherë kjo lloj sipërmarrjeje do të shkonte drejt falimentimit.

Prekëm një rast nga ekonomia, por mund të merrnim edhe raste nga politika. Sistemi politik shqiptar konsiderohet nga pikëpamja ideologjike si shtet ligjor. Në shumë drejtime dhe në sfera nga më të ndryshmet ai është vërtet i tillë. Pa diskutim. Por, po të analizojmë mjaft nga institucionet e tij, do të shohim se në fakt aspekti ligjor nuk është ai që rregullon konkretisht marrëdhëniet institucionale, sepse ky aspekt i "shtetit ligjor", në fakt, mbështetet në një substrat tjetër, më të thellë, që është ai i ekuilibrit midis partive. Në një farë kuptimi "shteti ligjor" në shumë institucione nuk është veçse një farë rregullimi ligjor i marrëdhënieve të pjesshme, një normativizim i militantizmit, një lloj standardizim i raportit dhe i tensionit midis partive të ndryshme politike. Parë nga kjo pikëpamje, këto institucione kanë dy nivele ndërtimi: i pari, evropian, perëndimor, ai i ligjit, si shprehje e vullnetit të përgjithshëm, dhe i dyti, substrati thjeshtë, ai partiaku, i marrëdhënieve midis partive, çka lidhet me kontekstin lokal shqiptar, me traditat e mbivendosjes së aktorëve socialë të fuqishëm, në këtë rast të partive, ndaj ligjit.

Tradicionalisht, shqiptari më shumë i është nënshtruar fuqisë personale të shefave, pastaj të partive, të njëshave, sesa ka qenë i mësuar t'i bindet ligjit. Kështu, si rregull, pushteti presidencial është një pushtet ligjor, por a është mirëfilltazi i tillë, duke përjashtuar në formimin e tij dhe në ushtrimin e kompetencave të tija influencat partiake? Apo ushtrimi i pushtetit presidencial te ne nuk është veçse një veshje ligjore e thelbit që ka të bëjë me



raportin midis partive politike?

Më duket se kjo alternativë e fundit duket si më realiste në përputhje me gjendjen konkrete të vendit. Presidenti zgjidhet nëpërmjet një vendimi të Kuvendit sipas një shumice të cilësuar. Por, kjo shumicë ose është e mirëfilltë partiake, ose krijohet sipas pakteve dhe marrëveshjeje midis partive politike. Kjo mënyrë ndërtimi e pushtetit presidencial bën që ai të jetë tepër i brishtë përpara presioneve partiake dhe ta ketë të vështirë të luajë rolin e një aktori të tretë, sikurse e paraqet Kushtetuta, si garant i unitetit të kombit. Aq më tepër kur bëhet fjalë për rolin e tij për të firmosur ligjet e nxjerrë nga Kuvendi.

Pushteti i vërtetë qëndron atëherë kur ai shprehet nëpërmjet forcës së kundërshtimit. Pushteti i vërtetë tregohet kur aktori në fjalë e ka fuqinë të thotë një "Jo" reale, pavarësisht se pasi e ka këtë pushtet, ai mund të thotë shpesh vetëm "Po". Por, presidenti te ne nuk ka të drejtë veçse një herë që ta kthejë në Kuvend ligjin e votuar nga ky i fundit. Herën e dytë, edhe një shumicë e thjeshtë do të ishte në gjendje të bënte ta rikalojë ligjin e refuzuar herën e parë. Këtë herë të dytë, presidenti nuk do të bënte tjetër veçse do të hidhte firmën mbi një ligj të imponuar nga shumica, cilado qoftë ajo.

Duke u nisur prej këtej, është e vështirë për të mos arritur në përfundimin se pas unitetit ligjor dhe institucional të kombit, që duhej të ishte mishëruar te presidenti, artikullohet një realitet tjetër, ai politik, ai i marrëdhënive midis shefave, midis partive politike. Pra, në njërin anë është ligji dhe institucioni si aspekt i jashtëm dhe formalisht mbizotërues, kurse më anë tjetër, në thelb, poshtë tij, si një subkoshiençë institucionale, qëndron imponant partitizmi, militantizmi si mendësi dhe mekanizëm lokal veprimi.

Diçka e tillë reflektohet qartë në formësimin e administratës publike. Është e vështirë të mos pranosh se emërimi i nëpunësve civilë në administratë nuk ka çuar në mbushjen e radhëve të burokracisë shqiptare me militantë politikë apo me lidhje të caktuara nepotike. Ndonjëherë ka kundërshtime lidhur me sa më sipër dhe si argument, sigurisht fals dhe demagogjik, sillen si fakt që për emërimet bëhen konkurse, shpallen publikisht kriteret, vendosen lista sipas meritave të çdo kandidati. A thua se po të bëhet një konkurs dhe të shpallen disa kriteret, kjo ndalon procedurat e emërimit të burokratëve dhe të ekspertëve militantë që veçse janë të politizuar, në shumicën e rasteve janë edhe të paafte për të bërë detyrat që iu janë caktuar. Mjafton të bëhen anketa të sociologjisë administrative dhe do të dalin në pah të gjitha ato raste mbizotëruese që tregojnë natyrën militante dhe partiake sidomos të administratës shqiptare gjatë viteve të fundit. Mjafton të gërvishtëm pak biografinë e burokratit, administratorit dhe ekspertit të administratës shqiptare të këtij dhjetëvjeçari të fundit dhe do të dalë pamja e militantit, e lidhjes nepotike, e personit që e ka zënë atë vend për arsye të raporteve partiake në

shkallë vendi apo në shkallë lokale. Ligji dhe norma evropiane e nëpunësit civil janë mbështetur edhe ato në një mendësi dhe praktikë lokale të lidhjes personale. Një simbiozë e çuditshme, kontradiktore, shpërthyesë, e mundimshme midis normës evropiane dhe mendësive dhe raportit aktual dhe lokal të forcave. Po kështu nuk ka dyshim se organizimi dhe mënyra e veprimit dhe funksionimit e institucioneve aq të debatuar si Këshilli Kombëtar i Radiotelevizionit apo KKRT-ja, ndonëse paraqiten si ato të organeve ligjore, të pavarura, si institucione të prejardhura nga natyra e paanshme e shtetit, ndërkaq që ato përfaqësojnë vetëm institucione që ndërtohen thjesht si raporte partiake. Përpjekja më e fundit për t'i nxjerrë ato nga partitizmi dështoi. Këto institucione duhet të ishin të paanshme si pjesë e shtetit ligjor. Ndërkaq, ato janë të dyanshme. Ndofta këto institucione prodhojnë paanshmëri partiake, për subjektet partiake, por a është e vërtetë se japin edhe paanshmëri për qytetarin?

Kështu, qytetari mbyllet midis dy alternativave, të dyja të anshme, duke mos pasur më asnjë mundësi për të përfituar nga një paanshmëri që do të vinte nga ligji si vullneti i përgjithshëm i qytetarëve. Dikush mund të kundërshtonte duke thënë se vullneti i përgjithshëm i qytetarëve është diçka formale, e perealizueshme. Kurse e vetmja garanci për demokracinë është të ketë rivalitet midis partive si kusht për ekuilibrimin e shtetit. Logjikë që presupozon se koncepti i shtetit të ekuilibruar është i barabartë me konceptin e shtetit të paanshëm. Nëse këto dy koncepte do të ishin identikë, atëherë duhet thënë se shteti aktual nuk është ndërtuar mbi bazën e referencave që njihen si demokratike e që vijnë nga Ruso, Loku etj., sepse atje flitet për ligjin si vullneti i përgjithshëm, për institucionin e mbështetur në ligj, kurse shpesh hasim institucione të mbështetura në tensionin partiak dhe në ekuilibrimin e forcave politike partiake. Ndërkohë që Kushtetuta përcakton që shteti është sovran sepse ai ngrihet mbi vullnetin e kombit apo të qytetarëve dhe jo mbi vullnetin e partive.

Këto ishin veçse disa shembuj që tregojnë se midis normës ligjore evropiane, legjislationit evropian, koncepteve dhe traditave evropiane që kemi adoptuar nga njëra anë, dhe praktikave që ndjek mekanizmi dhe substrati shoqëror shqiptar nga ana tjetër ka dallime të konsiderueshme.

Le të vazhdojmë të shohim edhe ndonjë fushë tjetër me rëndësi të marrëdhënive shoqërore aktuale. Dihet se adoptimi i një sërë normash dhe rregullash perëndimore dhe evropiane që kanë të bëjnë me të drejtat individuale e kanë rritur hapësirën e lirive të personit në botën shqiptare. Ligjërisht njihet e drejta e abortit, nuk ndëshkohet më penalisht homoseksualizmi, divorci po tashmë është një praktikë e njohur si nga ana e burrit ashtu edhe e gruas, të rinjtë praktikisht, por edhe sipas normave etike të ardhura prej mediave, në radhë të parë atyre audiovizive, kanë filluar ta shndërrojnë në normë marrëdhënien seksuale paramartesore, kulturi dhe miti i virgjërisë ka pësuar një bjerrje të

konsiderueshme - po t'i besojmë anketave dhe studimeve që bëhen lidhur me gjendjen e opinionit publik të vendit. Duket, pra, se modeli perëndimor dhe normat legale dhe etike evropiane në jetën shoqërore, në hapësirën intime të individit, në marrëdhëniet familjare kanë zënë vend të konsiderueshëm.

Vend të konsiderueshëm, po a janë bërë mbizotëruese? A janë ato të vetmet norma dhe modele? Apo edhe më tepër: kuadri ligjor, i prejardhur prej frymës evropiane, a përkon plotësisht me vlerat e opinionit publik dhe të qytetërimeve tradicionale të vendit? Vështirë të jepet një përgjigje pohuese edhe për sa më sipër. Anketat sociologjike dhe vëzhgimet në terren na tregojnë pamje të verifikueshme dhe të larmishme të asaj se sidomos brenda familjes shqiptare, veçanërisht brezi i mesëm dhe i moshuar, e kanë të vështirë të pranojnë si marrëdhëniet seksuale paramartesore të fëmijëve të tyre, ashtu edhe faktin se ata mund të bëjnë qysh duke filluar nga adoleshenca e vonët një jetë të pavarur. Burri shqiptar e ka shumë të vështirë të pranojë ende që nuk është ai "kaposhi" i "kotecit" të shtëpisë dhe i familjes së tij. Në shumë raste burrat nënkuptojnë një farë dhune të justifikuar për ta "bindur" gruan të veprojë sipas "arsyes", që nuk është veçse arsyeja e tyre. Për të mos thënë se të rinjtë shqiptarë, edhe kur e kanë kaluar legalisht moshën e të miturve, përsëri jetojnë brenda diktatit dhe kontrollit të prindërve të tyre, të cilët iu imponojnë deri dhe vijësjellje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e tyre shoqërore apo shijet e tyre.

Ndonëse niveli i normave ligjore dhe i standardeve lidhur me të drejtat e njeriut është bërë sipas kritereve të Evropës së Bashkuar, vështirë se mund të thuhet se e tillë është bërë edhe vetë sjellja dhe mendësia reale e të gjithë shqiptarëve. Kuadri politiko-ligjor në të cilën jeton një komb, vlerat e qytetërimit të tij dhe humoret e opinionet e opinionit publik nuk janë e njëjta gjë. Këto koncepte sigurisht që kanë lidhje me njëri-tjetrin, por, gjithsesi kanë edhe veçanësi që duhen mbajtur me kujdes në konsideratë. Cilado ngatërresë midis tyre sjell pengesa të pashoqe në arsyetimin që bëhet lidhur me probleme të ndryshme shoqërore dhe për atë që quhet identiteti i një kombi.

Një ngatërresë e tillë po ndodh edhe me rastin e debatit rilindas lidhur me problemi e identitetit të shqiptarëve. Ky debat po mbartet nga shumë persona, të cilët, në fakt, pavarësisht qëndrimeve në detaje të ndryshme, përsëri lidhur me metodën dhe logjikën e përgjithshme të trajtimit të çështjes, kanë ngjashmëri të theksuara me njëri-tjetrin. Mbi të gjitha ka një prirje për ta përcaktuar sjelljen kolektive apo individuale të shqiptarëve, apo mendësitë e tyre, vetëm nisur nga disa elemente "superstrukturore", pra vetëm nga feja mbizotëruese, nga tipi i sistemit politik që ka sunduar në periudha të ndryshme, nga lloji i fuqisë së jashtme që ka pas sunduar vendin, nga tërësia e normave ligjore apo etike zyrtare të një kohe të caktuar. Nga pushtimi osman nxirret mendësia dhe tipologjia lindore e sjelljes së shqiptarëve. Nga feja islame

nxirret edhe identiteti i sjelljes së shqiptarëve. Nga fakti se kanë qenë dikur tërësisht apo në shumicë të krishterë nxirret prirja e tyre evropianiste etj.

Sado të vërteta të ketë në këto përjasje, ato mbeten të një natyre thelbësisht ideologjike dhe bien në një ngatërresë të thellë metodologjike. Ato barazojnë shtetin, normat ligjore, me mendësitë e opinionit publik dhe vlerat e qytetërimit të njerëzve. Po të vinim në një kohë më të afërt, sipas kësaj përjasjeje formaliste, do të thoshim se gjatë komunizmit, shqiptarët kishin një identitet komunist. Edhe ata që ishin nëpër burgje sepse ishin të dënuar politikë, edhe ata që pëshpërisnin gjithë ditën kundër pushtetit, edhe ata që mbanin radion ngjitur te veshi për të prituar ardhjen e aleatëve apo për të dëgjuar ndonjë lajm kundër pushtetit ose thjesht për të kapur tingujt e ndonjë kënge të ndaluar, do të quheshin me mentalitet komunist. Po kështu, meqenëse në fshatrat shqiptare operonin kooperativat bujqësore dhe bujqit thërriteshin kooperativistë nga ana e ideologjisë sunduese, shtetit, aparateve propagandistike apo sipas ligjeve në fuqi, atëherë të gjithë bujqit dhe fshatarët duhej të kishin një identitet kooperativist, në lëvizje, pra në dinamikë. Identiteti kooperativist duhet të kishte sipas kësaj logjike edhe kryetari që ndofta sillej si në mall të tij pa pyetur për asamblenë formale të kooperativistëve të thjeshtë, edhe ai bujku që bënte si i sëmurrë për të mos dalë të punonte në arë, edhe ai fshatari që qysh në orët e para të mëngjesit i hipte biçikletës apo gomarit për të shitur vezët a qepët e tij në pazarin fshatar gjysmë klandestin të qytetit më të afërt. Meqenëse regjimi komunist në Shqipëri gjatë viteve '60 të shekullit të kaluar u bë aleat i Kinës maoiste, meqenëse e imitoi zyrtarisht revolucionin kulturor kinez, meqenëse u krijuan edhe vepra të tipit kinez, atëherë do të dilte se identiteti artistik i shqiptarëve u bë kinez, publiku adoptoi shije kineze dhe kështu e me radhë.

Sjellja reale e popullsisë, vlerat e qytetërimit që nuk lëvizin veçse shumë ngadalë nga njëra anë dhe ideologjia apo normat ligjore, politike dhe juridike që rregullojnë jetën e një shoqëri nga ana tjetër, sado përputhje që mund të kenë në një logjikë afatgjatë, përsëri ato nuk janë e njëjta gjë dhe nuk duhet kurrësi të ngatërrohen me njëra-tjetrën. Ndonëse Rilindja shqiptare shpalli parullën se feja e shqiptarit është shqiptaria, vështirë se kështu e mendonin raportin fe - komb edhe shqiptarët e thjeshtë. Ata nuk filluan të shkojnë nëpër vende të shenjta të kësaj feje, të shqiptarisë, duke braktisur kishat e xhamitë. Po kështu, vetëm sepse disa kode morale të shqiptarëve kërkonin që shqiptari të mbante besën, të ishte mikpritës, etj., prej këtej nuk mund të dilet te ideja se besa e mbajtur dhe mikpritja ishin vlerat karakteristike të të gjithë shqiptarëve. Përndryshe mund të thuhet se meqë publiku kishte raste që dëgjonte edhe këngë me ndonjë prirje homoseksualiteti adoleshent, atëherë identiteti i tij ishte pedofil. Është njësoj sikur të thuhet se meqë sot shqiptarët jetojnë në një vend demokratik, në një sistem demokratik të votuar prej atyre vet, atëherë mendësia

e shqiptarëve të sotëm mund të shkruhet si demokratike!!!

As e sotmja dhe as e kaluara nuk mund të gjykohej realisht nëse ngatërrohen me njëra tjetrën normat juridike dhe politike, ideologjitë sunduese, rymat mbizotëruese politike nga njëra anë, dhe mendësitë dhe identiteti kolektiv i njerëzve realë, i atyre qenieve që nuk mund të asimilohen te shteti, apo ideologjia e epokës, sikurse e reduktonte Hegeli individin te koncepti absolut. Edhe Marks i në shembullin e tij e asimilonte individin te klasa dhe grupi përkatës shoqëror.

## KONKLuzion

Nga na vjen në shkencat tona shoqërore dhe në përsiatjet letrareske kjo metodologji që barazon ideologjinë dhe politikën sunduese me vlerat e vërteta të qytetërimit lokal? Nga na vjen kjo përjasje formaliste dhe institucionaliste, krejt ekstreme, krejt abstrakte dhe krejt bosh, që e redukton të gjithë shoqërinë, individët që e përbëjnë atë, te shteti, te institucionet, te kultura mbizotëruese, te feja? Përse kjo metodë përfruese institucionaliste ka dëmtuar, shkatërruar dhe zhvendosur krejtësisht metodën sociologjike, pra atë metodë që nuk sheh se çfarë thonë se janë njerëzit, por kundron atë që njerëzit janë në të vërtetë?

Gjykoj se na vjen në radhë të parë për shkak se metodologjia e një marksizmi të thjeshtëzuar në kulm ka pasur dhe ka rrënjë shumë të forta në Shqipëri dhe në trevat ku banon popullsia shqiptare përtej kufijve tanë shtetërorë. Në të dy anët ka pasur sunduar metodologjia e asaj që quhej në gjuhën e thjeshtëzuar të marksizmit si "përputhje e bazës me superstrukturën". Sipas saj, pak a shumë, si të ishte superstruktura sunduese e shoqërisë, pra si të ishte shteti, feja, kultura, arti i elitave, ideologjia, ashtu do të ishte edhe vetë shoqëria. Edhe e anasjelltas ishte për të po aq e vërtetë.

Sikurse thoshte Karl Popper në veprën e tij mbi shoqërinë e hapur dhe armiq të saj, ky lloj marksizmi i ngurtësuar, ai i sojtit sllavo-rus, nuk bënte gjë tjetër veçse asimilonte faktin social në faktin institucional, pra barazonte shoqërinë me pushtetin, individin me institucionin, sjelljen praktike me normën morale dhe ligjore. Kjo lloj metodologjie e kapërcyer qysh nga fundi i shekullit të XIX - të karakterizon teorinë esencialiste, të cilat vijnë te ne qysh prej kohëve të filozofisë së Lashtësisë. Sado përmbajtja e marksizmit stalinist është kritikuar boll nga ana e elitave shqiptare andej dhe për këndej kufirit, përsëri si metodologji, si mënyrë për ta kuptuar botën, metoda esencialiste ka zënë vend thellë dhe nuk shkulet kollaj. Ajo vazhdon të imponohet në analizat lokale që për pasojë nuk kuptojnë që fakti social është përtej institucionit dhe përtej normës etike sunduese.

Burimi i dytë nga na vjen ajo lloj përjasje institucionaliste, besoj se ka të bëjë me faktin se për historinë tonë

ne kemi shumë pak studime konkrete, të imta, që të hidhnin dritë mbi jetën praktike, të vogël, intime, të shqiptarëve të moçëm dhe më të rinj. Më kujtohet libri i një historiani të madh francez, i përkthyer edhe në Shqipëri, i cili bëri bujë sepse merrej me çështje të vogla të historisë, por që ndriçonin vlerat e mëdha të kombit të tij. Ai e titulloi librin "Djathi dhe krimbat". Kush na ka thënë se historia është e mbretërve dhe e shteteve dhe nuk është ajo e njerëzve konkretë që lindin, jetojnë dhe vdesin brenda, por edhe jashtë kallëpeve institucionale dhe ideologjike?

Askush nuk është në gjendje t'i përgjigjet kësaj pyetjeje, por dihet se është më e lehtë të bëhet historia e pushteteve sepse ata kanë lenë dokumente në arshivat përkatëse, kanë libra që flasin për veten me anë të të diturve të tyre, kurse populli i thjeshtë jeton dhe vdes në heshijen e vet masive. Në arshivën tonë kombëtare do të gjejmë të gjitha dokumentet e regjimeve të mëparshme, por është shumë e vështirë të ketë dokumente për shkallën e vërtetë, për shembull, të besimit të shqiptarët. Duke iu munguar lënda e mirëfilltë konkrete e jetës së përditshme, mendimtarët referohen te ato që quhen fakte të mëdhenj të historisë, dhe, më keq, e përmbledhin historinë te ata. Prandaj gabojnë rëndë.

Se çfarë ishin shqiptarët gjatë shekujve tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë kërkojnë ta gjejnë te ideologjia e Rilindjes. Harrohet kështu se institucionet, sidomos ato politike, kanë edhe natyrë shtypëse, frenuese, rezistuese, kundërvepruese ndaj shoqërisë. Ato e shprehin, pra shoqërinë, por aq edhe nuk e shprehin atë, sepse me karakterin e tyre ndrydhës institucionet dëshmojnë edhe ato anë që shoqëria i ka ndryshe, të papërmbledhshme te institucioni. Në këtë kuptim, institucioni ka edhe aspekte krejt të kundërt me ato të shoqërisë ku është implementuar.

Së fundi, metoda e gabuar e përmbledhjes së shoqërisë te institucionet e saj vjen deri në ditët tona edhe si një lloj oportunitizmi intelektual që prej shekujsh ka tentuar të jetë sa në rezistencë të pashoqe ndaj autoritetit të pushtetit, por edhe po aq në shërbim të shtetit.

Për të riardhur te çështja jonë, më konkretisht do të thoshim se norma dhe rregulla institucionale evropiane po e zgjeror rrethin e vet të veprimit të ne, por në një mënyrë shumë kontradiktore dhe jo pa probleme. Shqetësimi është se ato po hyjnë në shoqërinë tonë jo aq shumë si pasojë e presionit të opinionit shoqëror mbi ligjëvënësin, sesa si një prurje nga jashtë, emancipuese, por edhe me një farë karakteri të huaj për shumë anë të mentalitetit dhe të konjunkturës shqiptare. Nga njëra anë kjo do të thotë se ato e tërheqin shoqërinë drejt një modeli të caktuar, por nga ana tjetër, edhe shoqëria reagon me anë të një lloj hipokrizie individuale dhe kolektive, me anë të një dyfytërsie, që nuk shkakton pak ngadalësi, deprimim, pse jo, edhe patologjira sociale kolektive nga më të ndryshmet, bashkëshoqëruese të një personaliteti të dyzuar.



## HIBRIDIZIMI I HAPËSIRËS POLITIKE

Transformimi i hapësirës politike nën tensionin mes legjitimitetit legal të pushtetit dhe legjitimitetit që vjen nga jashtë - rasti i Shqipërisë 1990-2004

M. A Henri ÇILI\*

**N**ocioni i legjitimitetit të pushtetit në debatin publik në Shqipëri është një problem relativisht i vonë, duke folur gjithnjë për periudhën pas vitit 1990, kur nisën ato që quhen në ligjërimit lokal si "proceset demokratike". Është i vonë madje edhe në vetë dinamikën e procesit të demokratizimit, po të kemi parasysh se termin "legjitimitet" apo debatin rreth tij e ndeshim në media, dhe ligjërimit politik kryesisht pas problemeve të zgjedhjeve të vitit 1996. Pa përjashtuar ndonjë trajtim rastësor apo teorik, mund të thuhet se rreth problemit të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme ka nisur dhe është zhvilluar debati për legjitimitetin në axhendën e temave të ditës.

Kronika në linja të trasha e proceseve demokratizuese në Shqipëri, në kuptimin e përkufizimit dhe klasifikimit të tyre, do të ishte kjo: Pas rënies së komunizmit në fillim të viteve '90, Shqipëria iu fut një procesi demokratizimi mbështetur mbi parimet e pluralizmin politik, tregun e lirë, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, proces i cili përkufizohet rëndom si "tranzicioni drejt demokracisë". Në dinamikën e vendeve evropiane, që i janë nënshtruar një procesi demokratizimi pas përvojave totalitare, ajo klasifikohet në atë që quhet vala e tretë e demokratizimit, pas tranzicionit demokratik të vendeve të Evropës Jugore si Spanja, Portugalia apo Greqia, duke hyrë në grupin e atyre vendeve, që procesin e demokratizimit e nisën pas rënies së Murit të Berlinit dhe shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik.

Por, konstruktimi i kuadrit demokratik të Shqipërisë formon një rast më vete në procesin e demokratizimit, në ndryshim nga demokracitë e tjera të reja në Evropë, për shkak të një elementi esencial të ndryshëm nga të tjerët: prania dhe roli i faktorit ndërkombëtar në zhvillimet e brendshme.

Mund të binim lehtë në pohimin se në këtë aspekt Shqipëria nuk është aspak unike. Në çdo vend të Lindjes, nga Çekia tek Lituania, roli i faktorit ndërkombëtar, sidomos nëpërmjet proceseve se integrimi, ka qenë mjaft i rëndësishëm. Por vertikalisht dhe horizontalisht i pranishëm së komunitetit ndërkombëtar gjatë, përjashtoi vendet e ish - Jugosllavisë për shkak të luftës, nuk ka qenë i tillë si në Shqipëri. Për shembull asnjë vend nuk ka përjetuar një operacion paqeruajtës në kushtet e trazirave të brendshme, siç ishte rasti i operacionit "Alba" në vitin 1997, dhe nga ana tjetër, asnjë prej vendeve të marrë për

bazën krahasuese nuk ka një të tillë marrëveshjeje me OSBE<sup>1</sup> si Shqipëria, ku kësaj të fundit i jepeshin vërtet prerogativa në vendimmarrjen e brendshme që i takojnë normalisht institucioneve të një shteti sovran. Kjo u pa më tej me funksionin legjitimues që morën raportet e OSBE-së për vlefshmërinë apo pavlefshmërinë e zgjedhjeve.

Është ky element, pra roli i komunitetit ndërkombëtar në asistimin e demokracisë shqiptare, ai që përbën rastin shqiptar në një masë të tillë, sa është jashtëzakonisht e vështirë sot në Shqipëri të dallosh se ku është "dora" e faktorit vendas në një masë të marrë, në një institucion të ngritur, dhe ku është ajo e organizmave ndërkombëtare, e FMN-së, Bankës Botërore, Komunitetit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës apo Italisë, Greqisë e kështu me radhë.

Shqipëria e kishte të nevojshme në fillim të viteve '90-të të thërriste në qeverisjen e vendit faktorin ndërkombëtar, për një arsye të thjeshtë: kapacitetet e saj ekonomike, institucionale dhe njerëzore për të kryer tranzicionin demokratik, ishin minimale ose mungonin fare. Nga pikëpamja ekonomike ajo ishte në një gjendje katastrofike, për shkak të mungesës masive të furnizimit të rrjetit shtetëror të dyqaneve, për shkak të rënies drastike të prodhimit vendas dhe për shkak të mungesës së mjeteve financiare, valutës së fortë për të blerë në tregun perëndimor. Prandaj ajo i bëri thirrje urgjente Perëndimit për ndihma ushqimore humanitare të të gjitha llojeve, deri tek ai që u njoh me emrin "operacioni Pelikan" i ushtrisë italiane, i cili shpërndante në të gjithë vendin ushqime të nevojës së parë. Fjala "ndihmat" që bërë një eufemizëm i zakonshëm në zhargonin popullor të viteve 1991-1994, aq sa rreth tyre zhvillohej dhe beteja politike mes aktorëve lokalë. Kështu për shembull, në zgjedhjet e vitit 1992 Partia Demokratike e opozitës, në një slogan elektoral të saj thoshte "Ne qeverisim, bota na ndihmon". Nga ana tjetër, ish-kryeministri i fundit i qeverisë komuniste, Fatos Nano, u dënua me 11 vjet burg për një skandal lidhur me ndihmat italiane të vitit 1991. Po ashtu, Bashkimi Evropian dhe FMN-ja mbulonte një pjesë të konsiderueshme të bilancit të pagesave për zyrtarët publikë, arsimin, ushtrinë, shëndetësinë etj.

Kurse specialistët e huaj, kryesisht juristë dhe ekonomistë, ishin të domosdoshëm në reformën ekonomike dhe atë të institucioneve, aq sa ata ishin vendimmarrësit e vërtetë në kushtet e mungesës së kompetencës së zyrtarëve shqiptarë, aq më pak e specialistëve vendas. Për gati 40 vjet në Shqipëri nuk kishte më shkollë dhe formim profesional për ekonominë kapitaliste apo të jurisprudencës së një shteti demokratik dhe liberal. Gjatë regjimit komunist, të vetmit që kishin një farë formimi bashkëkohor me botën perëndimore në fushat e tyre, ishin specialistët e shkencave të natyrës apo ata të minierave dhe

*1-Marrëveshja e Shqipërisë me OSBE, për misionin e OSBE në Shqipëri, gusht 1997*

industrisë. Kishte shumë pak ose aspak specialist të formuar në shkencat humane si ekonomi, drejtësi, sociologji apo filozofi, degë të cilat ishin të domosdoshme për të konstruktuar hapësirën e re politike të kushteve të reja, të një demokracie liberale të modelit perëndimor. Diskuri i ri i ditës dukej i huaj krejtësisht për publikun kur flitej për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, ndarjen e pushteteve, kontrollin dhe balancën e pushteteve, privatizimin masiv, apo bursën. Në këtë shkretëtirë të burimeve njerëzore dhe të njohurive për sistemin e ri, nevoja e specialistëve të huaj ishte jetike dhe legjitimiteti i fjalës së tyre as që vihej në dyshim dhe barazohej me vetë sistemin.

Tranzicioni shqiptar nga pikëpamja e strukturimit të hapësirës së re politike sipas modelit të demokracisë liberale, përveç dinamikës së brendshme, lojës dhe interesave lokale, vjen dhe na shpërfaqet kryesisht produkt i pranisë, ndihmës dhe asistencës, apo më mirë të themi e vendimmarrjes së faktorit ndërkombëtar, pikësepari atij perëndimor, Evropës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në këtë kuptim, prania e fortë ndërkombëtare në demokracinë e re shqiptare, edhe si një kundërpeshë e një 15-vjeçari të fundit të diktaturës komuniste, ku sundonte përmes i "mbështetjes me forcat e veta" dhe izolacioni i plotë, ishte më shumë se e nevojshme, ishte mjaft legjitime. Autoriteti i faktorit ndërkombëtar në sytë e aktorëve të brendshëm ishte unanim, e artikulluar kjo që në protestat e studentëve, që pasuan me lejimin e pluralizmit politik, në parullat e të cilëve thuhej "E duam Shqipërinë si e gjithë EVROPA". Nga ana tjetër, faktori lokal politik e kishte "hapjen" si një lajtmotiv kryesor të vetin në kushtet e izolimit të gjatë të vendit.

#### **DINAMIKA E RE E BRENDSHME DHE RRETHANAT E JASHTME NË LEGJITIMIMIN E NJË PUSHTETI.**

Në momentin kur më 12 tetor të vitit 1990, pas protestave të studentëve në qytetë universitare të Tiranës, dhe pas përkrahjes së gjerë të tyre nga populli i kryeqytetit, pleqtë e byrosë politike vendosën të lejojnë krijimin e partive të tjera politike pak njerëz ishin të vetëdijshëm për ndryshimin rrethësor që do të pësonte hapësira politike vetëm me këtë akt të vetëm: lejimin e krijimit të organizatave politike. Themelimi i partisë së parë opozitare, Partisë Demokratike, dhe më pas i shumë partive të tjera, do të shënonte një ndryshim themelor në mënyrën, ligjërimin dhe procedurën e mëtejshme të legjitimitetit të pushtetit në Shqipëri tani e tutje. Kjo implikoi drejtpërdrejt dhe daljen në skenë të institucionit të zgjedhjeve të lira, të ndershme, të barabarta dhe të fshehta, tanimë si forma e vetme e marrjes dhe lënies së pushtetit nga partitë politike. Tani e tutje qytetarët do të organizoheshin lirisht nëpër organizata politike, partitë politike, të cilat në një periodicitet të caktuar do të garonin mes tyre me kandidatët e vet për të marrë shumicën e votave dhe për pasojë për të qeverisur vendin në nivel lokal dhe qendror.

Kjo mënyrë e re e legjitimitetit të pushtetit pas përvojës dhjetëvjeçare, ku procesi politik nuk ishte në dorë të qytetarëve, ku zgjedhjet ishin formale dhe ku në të vërtetë nuk konkurrohej mes kandidatësh apo forcash politike, krijonte një dinamikë krejt të re të shprehjes politike të interesave të qytetarëve, të ndjeshmërive politike, ideore të komunitetit politik. Aktorët shoqërorë tani e tutje mund të artikuloreshin lirisht si pasojë e interesave të tyre, të bindjeve të tyre, të trashëgimisë së tyre. Kështu, në radhë të parë ata që nuk e kishin dashur sistemin diktatorial apo Partinë Komuniste, mund të renditeshin tek partitë e opozitës. Nga ana tjetër, pasardhësit e forcave të tjera politike, të cilat komunistët i shtypën menjëherë pas mbarimit të luftës, mund të rindërtonin formacionet e tyre politike, siç ishin forcat e Ballit Kombëtar apo nostalgjikët e ish-mbretërisë dhe Ahmet Zogut, që e konsideronin gjithnjë jolegjitim suprimimin e regjimit monarkik, mund të ndërtonin forcën e tyre politike. E njëjta gjë mund të thuhet për ish-pronarët e shpronësuar, ish-të përndjekurit politikë e kështu me radhë të gjitha grupet shoqërore. Krahas shprehjes së lirë të identiteteve dhe interesave politike, këto grupe shoqërore nisnin të organizohen në formacione politike dhe të përgatiten për betejat e para elektorale të lira.

Hapësira e re demokratike i dha kështu mundësinë trupit politik të shprehej në një mënyrë krejt të re, të lirë dhe në bazë të një procedure demokratike, racionale, të njohur dhe të mirëpranuar nga të gjithë aktorët shoqërorë e politikë; zgjedhjet e lira, të ndershme, të barabarta. Ushtuesi i pushtetit do të ishte ai që do të dilte fitues i kësaj procedure, që do të grumbullonte më shumë vota të qytetarëve me të drejtë vote. Shkurt, trupi shoqëror, më shumë sesa si vullnet i brendshëm për analogji me atë që ndodhte në Perëndim, pranoi lojën demokratike në gjirin e hapësirës politike të aktorëve të ndryshëm në funksion të marrjes dhe ushtrimit të pushtetit. Pranoi pra "legjitimitetin racional, juridik"<sup>2</sup>, nëse do t'i referohemi termit të sociologut gjerman Max Weber.

Por nuk është vetëm kjo dinamikë e brendshme ajo që merr pjesë në procesin politik vendas. Një aktor tjetër shumë i rëndësishëm tanimë i pranishëm si domosdoshmëri i asistimit të procesit të tranzicionit politik është faktori i jashtëm. Faktori ndërkombëtar ka pranuar të ndihmojë Shqipërinë në këto ndryshime demokratike të vështira dhe të dhimbshme, për dy arsye: sepse Shqipëria ndodhet në portat juglindore të Evropës, në një pozitë kyçe për gjeopolitikën e rajonit, dhe jo më larg se 70 milje larg brigjeve italiane. Mjafton të kujtojmë këtu rolin lider të Italisë, si fqinji më i madh i afërt i BE-së, në asistimin e Shqipërisë në të gjitha fushat në 6-7 vitet e para. Kjo e fundit ndërtoi operacionin "Pelikan" në 1991-1994, për të shpërndarë ndihma ushqimore në të gjithë Shqipërinë, pas eksodeve biblike

<sup>2</sup> -Max Weber "Economie et societe", editions PLON, Paris 1972, faqe 78

të vitit 1991, drejt Italisë dhe po ashtu udhëhoqi operacionin ALA në 1997-ën për të rivendosur rendin dhe gjendjen e brendshme. Në radhë të parë, stabiliteti dhe qëndrueshmëria e vendit janë një kontribut për sigurinë e kontinentit evropian. Po ashtu, stabiliteti, shmangia e trazirave civile në këtë vend janë garanci për të mos lëshuar në brigjet perëndimore të Adriatikut eksode me mijëra qytetarë të uritur dhe të pashpresë, që kërkojnë një jetë më të mirë. Këta të fundit do të trazonin jo thjesht ndërgjegjen e “Perëndimit të nginjur” tek shihte “shqiptarët e uritur”, por dhe jetën e pasurinë e qytetarëve të Perëndimit.

Po ashtu, Perëndimi ka pranuar të ndihmojë Shqipërinë në një rrugë kalimi në një model politik dhe ekonomik si ai i veti, i cili në një kohë të dytë do ta shndërronte vendin në një hapësirë paqeje, stabiliteti dhe zhvillimi dhe në një treg të ardhshëm. Në këtë gamë interesash dhe lojërash gjeopolitike faktori ndërkombëtar e ka kushtëzuar ndihmën ndaj Shqipërisë dhe ndaj aktorëve vendas në pushtet. Kështu, do të mbështeten ata aktorë, të cilët i kontribuojnë procesit të reformave të nisura të tregut dhe atyre të institucioneve demokratike; që shpien në zhvillim demokratik, në një sistem të lirisë ekonomike, i cili garanton liritë politike të qytetarëve dhe liritë dhe të drejtat e tjera themelore.

Për sa kohë përkrahja e faktorit ndërkombëtar dhe ndihma e tij e mëtejshme është jetike lind si pasojë edhe një funksion legjitimues i komunitetit ndërkombëtar në dinamikën e brendshme, në lojën demokratike të brendshme. Thjesht fare, në sytë e qytetarëve është më i preferuar ai kandidat, ajo parti, e cila ka më shumë mbështetje ndërkombëtare, prej së cilës Shqipëria dhe qytetari i thjeshtë presupozohet se do të përfitojë më shumë ndihma, investime, viza, apo shkollim. Pra, tanimë, në këtë fazë të parë sidomos, ky funksion legjitimues i faktorit të jashtëm është bazik dhe shumë influent ende sa pa vajtur votuesi në kutinë e votimit. Por edhe pas rezultatit elektoral përkrahja ose mospërkrahja nga jashtë luajnë rol të jashtëzakonshëm në mbetjen ose rënien e pushtetit.

Në një fazë të mëtejshme, kur kalon emergjenca e parë, roli legjitimues i faktorit ndërkombëtar transformohet në forma të tjera. Ai rivlerësohet tanimë në funksion të ecurisë së dinamikës së brendshme, kur loja demokratike është e pastabilizuar dhe funksioni auto-rregullues i sistemit mungon ende, ose është i dobët. Në këtë rast, kur dinamika demokratike e brendshme bllokohet dhe askush nuk e ka aftësinë e arbitrimit të lojës së brendshme për të përcaktuar “kush ka të drejtë”, “kush ka gabim”, për të përcaktuar ndëshkimin dhe rivendosjen e së drejtës, komuniteti ndërkombëtar merr rolin e një “arbitri”. Në këtë moment funksioni i tij legjitimues që kishte në fillim shndërrohet në një legjitimitet më vete, në legjitimitetin që vjen nga jashtë. Tanimë në hapësirën politike lokale faktori

ndërkombëtar bëhet një aktor më vete, dhe si “arbitër” ai në fakt shfaqet vetë si legjitimuesi” ose “de-legjitimuesi” i pushtetit në demokracinë e re shqiptare. Sepse mekanizmi politik lokal e ka të vështirë të funksionojë si vetërregullues apo të përmbahet brenda disa normave kryesore, pa praninë apo presionin e faktorit ndërkombëtar. Pa këtë prani ndërkombëtare “skenari ideal” do të ishte Shqipëria e vitit 1996–1997. Pa ndërhyrjen dhe presionin e faktorit ndërkombëtar Partia Demokratike e Sali Berishës do të kishte vijuar të qeveriste me një Parlament, ku 122 nga 155 deputetët i kishte ajo dhe kundërshtari kryesor, Partia Socialiste, kishte vetëm 9 deputetë. Nga ana tjetër, Partia Socialiste, pa ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar me siguri do ta kishte dashur të ta çonte finishin e trazirave të viti '97 ndoshta në një qeveri të “komiteteve të shpëtimit kombëtar”.

#### **LEGJITIMITETI I BRENDSHËM DHE LEGJITIMITETI I JASHTËM, DY LOGJIKAT TË NDRYSHME**

Në një kohë të dytë, në momentin kur faktori i jashtëm e fiton këtë rol legjitimues në funksion të pushtetit të brendshëm, edhe pse në nisje, ai kishte të njëjtat qëllime si aktorët e brendshëm për ndërtimin e një demokracie liberale në vend, logjika dhe interesat e aktorëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm vijnë pak nga pak dhe diferencohen. Edhe pse janë pak a shumë në të njëjtat linja të mëdha, për tema konkrete, për kohën e aplikimit të kësaj apo asaj politike, ato ndahen gjithnjë e më tepër. Mekanizmi që strukturon përmbajtjen dhe përcakton vendimmarrjen e aktorëve të brendshëm, është krejt tjetër nga i faktorit të jashtëm. Kështu, faktori i brendshëm e strukturon aksionin e tij në funksion të interesave të grupeve shoqërore që e mbështesin, të një tradite dhe ndjeshmërie kombëtare rreth temave të caktuara të axhendës rajonale apo të problemeve me fqinjët, rreth disa akteve të qëndrueshme të gjeopolitikës të vendit. Dhe mbi të gjitha, aktorët politikë të brendshëm në funksion të marrjes dhe ruajtjes së pushtetit, janë vazhdimisht të orientuar nga logjika elektorale: sa elektoral është ky apo ai vendim, sa vota humbet apo fiton kjo forcë politike, duke aplikuar këtë masë apo atë masë politike.

Krejt e ndryshme është logjika e faktorit ndërkombëtar. Së pari, faktori ndërkombëtar është krejt i përçarë dhe me interesa të diversifikuara kundrejt një vendi të tillë të vogël. Ai është konsensual vetëm në disa linja të mëdha gjeopolitike të rajonit dhe pjesa tjetër e faktorëve që merr pjesë në ndërtimin e aksionit të komunitetit ndërkombëtar është me natyrë të paqartë, është subjektive apo situacionale. Por, mbi të gjitha, komuniteti ndërkombëtar nuk ka asnjë përgjegjësi para ndokujt për përmbajtjen e aksionit të vet. Në radhë të parë, nuk ka asnjë përgjegjësi kundrejt atyre mbi të cilët rëndon vendimmarrja e tij: komunitetit politik lokal, që në këtë rast janë qytetarët shqiptarë. Sepse ndërkombëtarët as votohen dhe as japin llogari për aksionin e tyre. Si diplomatë, ata japin llogari në vendet e tyre, para



qytetarëve të tyre, të cilët i kanë zgjedhur në funksion të një politike të jashtme për interesat e tyre.

Me kalimin e kohës, ose në mënyrë gjenerale, ose për çështje të ndryshme, faktori i jashtëm dhe ai i brendshëm janë të prirur të fërkoen dhe ndeshen: nëse ligjërimi lokal ka prioritet një problematikë tjetër, ai ndërkombëtar një tjetër. Një ilustrim i spikatur nga kronika e kohës për këtë: Kështu, në vitin 2001, kur kryetari i Partisë Socialiste, Fatos Nano, ndërmori një fushatë për pastrimin e partisë së tij nga korrupsioni duke bërë thirrje për rrëzimin e qeverisë së kryeministrit Ilir Meta, kryetar i Komisionit Evropian, Romano Prodi, erdhi në Shqipëri më 28 nëntor 2001 dhe tha lakonikisht: “Stabilitet, stabilitet, stabilitet”<sup>3</sup>

Kështu, një tension i vazhdueshëm sundon në marrëdhëniet mes faktorit lokal dhe atij ndërkombëtar. Hapësira politike pak nga pak nis dhe ndjen efektin e këtij tensioni, i cili ndikon në mënyrë esenciale mbi vetë ligjësitë e funksionimit të një hapësire politike demokratike. Kuadri i hapësirës politike nis dhe turbullohet dhe ne kemi një hapësirë politike hibride. Ajo nuk është më as një hapësirë politike që funksionon mbi bazën e mekanizmit demokratik, lojës demokratike dhe legjitimitetit racional dhe juridik; nuk është as një hapësirë politike e qeverisur nga jashtë prej ndërkombëtarëve në formën e një protektorati ndërkombëtar. Mekanizmi legjitimues i pushtetit nuk mbështetet më as plotësisht tek vota e qytetarëve, as tek delegimi i autoritetit ndërkombëtar. Ashtu sikurse e gjithë kjo ka nevojë të plotësohet me evoluimin e aksionit të aktorëve të jashtëm, të cilët në skenën e brendshme kalojnë nga pozitat e diplomacisë dhe të strukturimit të marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe, në një “aktor më vetë” në hapësirën politike lokale, për të përfunduar tek roli i “palës së tretë”.

Për të vlerësuar apo më saktë për të operuar në një situatë të tillë bashkëveprimi mes aksionit politik me burim lokal dhe atij me burim të jashtëm, është e nevojshme të shkojmë të burimet e konceptit të legjitimitetit dhe evoluimit të tij në kohë e hapësirë. Në radhë të parë del nevoja e konsolidimit i konceptit të “legjitimitetit” përmes kalimit tek aktorë të ndryshëm: Weber, Platon, Monteskje, Hobs, si dhe ndarja e bashkëveprimi i legjitimitetit me koncepteve të tjera që i asociohen atij, si “autoriteti”, “pushteti”, “sovrانيتi”, “dominimi”. Pas konsolidimit të këtyre koncepteve dhe në përputhje me to, është e nevojshme të merret në analizë ligjërimi politik i aktorëve lokalë dhe atyre ndërkombëtarë më me influencë në Shqipëri. Nga aktorët lokalë është me interes të analizohet dinamika rreth temës në fjalë, i dy prej liderëve politikë kryesorë të tranzicionit shqiptar, kryetarit të Partisë Demokratike, Sali Berisha, dhe kryetarit të Partisë Socialiste, Fatos Nano. Kufizimi tek ligjërimi politik i këtyre dy liderëve është i përligjur me faktin që ata

përfaqësojnë në mënyrë të qëndrueshme gati 90 për qind të elektoratit shqiptar. Po ashtu, ligjërimi i tyre në dinamikën 15-vjeçare në fakt nuk është “ligjërimi i dy personave”, është “ligjërimi përfaqësues” i drejtuesve të dy formacioneve më të mëdha politike në vend, ligjërim që reflekton ndjeshmëritë, situatat, gjendet ideore dhe elektorale që pjesë të shoqërisë si Partia Demokratike dhe Partia Socialiste përfaqësojnë në Shqipërinë politike të pas vitit '90. Kurse nga aktorët ndërkombëtarë paraqesin interes për t'u analizuar raporte të ndryshme të organizmave ndërkombëtare për Shqipërinë dhe zgjedhjet atje, deklarata dhe raporte të OSBE-së, BE-së si dhe të Departamentit të Shtetit dhe Ambasadës së SHBA-së në Tiranë si dhe deklarime publike dhe intervista të ambasadorëve të këtyre organizatave ose shteteve në Tiranë.

Në sferën politike “legjitimiteti” paraqet një kundërpërgjigje ndaj kapriçove të anarkisë, të arbitraritetit apo ndaj “politikës së paarsyeshme; ai i jep autoriteti politik në fuqi një forcë të plotë aksioni dhe reagimi. Shumë autorë ndërhyjnë në këtë mes, ose më saktë konkludojnë mbi domosdoshmërinë apo dobinë e “të qenit legjitim”, kur bëhet fjalë për një pushtet apo autoritet publik. Kështu Maks Weber shtjellon që “pa legjitimitet pushteti është i paralizuar dhe përfundon në shpërthim”<sup>4</sup>. Guiglielmo Ferrero, përpunues i konceptit politik të legjitimitetit në librin e tij “Legjitimiteti, gjeniu i padukshëm i qytetit”, nënvizon se “legjitimiteti përmban frikën dhe kërcënimin ndaj të cilave janë të ekspozuar kundrejt njërit - tjetrit të qeverisurit dhe qeverisësit”<sup>5</sup>.

Në funksion të legjitimitetit të pushtetit, një hapësirë politike e caktuar në një moment të caktuar aplikon një formë të caktuar legjitimimi. Në rastin e Shqipërisë dhe në përgjithësi në rastin e demokracive të reja që bëjnë pjesë në valën e tretë të demokratizimit të vendeve në zhvillim, forma e re e legjitimitetit të pushtetit janë zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Pra, legjitimiteti racional apo juridik i pushtetit, i shprehur ky në një “neutralitet axiologjik”, që do të thotë: një procedurë legale zgjedhore, e cila është neutrale kundrejt secilit aktor që hyn në garë, ose që plotëson kushtet për të hyrë në garën elektorale.

Në një moment të supozuar zero të kësaj rruge, gjithçka është e qartë: tani e tutje aktorët politikë, që përfaqësojnë grupe të ndryshme të shoqërisë, do të konkurrojnë mes tyre me programe dhe ekupe, sipas një procedure të caktuar, për të cilën palët që kanë hyrë në garë i kanë pranuar që në fillim të famshmet rregullat e lojës. Shumica e zgjedhësve do të përcaktojë dhe atë që fiton pushtetin për një mandat të caktuar.

Por shpejt ky model nis dhe gjendet nën efektin e faktorëve të tjerë, të cilët e deformatojnë principin e vendosur në

4-Max Weber "Economie et societe", editions PLON, Paris 1972, faqe 69

5-Ferrero, Guiglielmo, Pouvoir: les génies invisibles de la cité, editions Les livres de poche, collection essais, Paris 1988, page 173).



këtë “moment fillestar” të dhënë të “kontratës politike”. Në skenë si një domosdoshmëri, për shumë arsye shfaqet faktori ndërkombëtar ose ndërkombëtarët. Në fillim është nevoja për ndihmë ekonomike nga jashtë, për asistencë teknike, njerëzore dhe ekspertizë për sistemin e ri që po ndërtohet, ajo që bën që komuniteti ndërkombëtar të jetë i lutur të vijë për të marrë pjesë në hapësirën politike. Nga ana tjetër, përtej kësaj nevojë që ka vendi dhe institucionet publike për këtë ndihmë nga jashtë, e të gjitha formave kjo, duket se prania e faktorit ndërkombëtar është gjithashtu shumë legjitime dhe e preferuar në sytë e qytetarëve. Përderisa ne duam “ta bëjmë Shqipërinë si e gjithë Evropa”, përderisa duam të aplikojmë, të kopjojmë në vendin tonë modelin përëndimor, pra të “imitojmë” Perëndimin, ndërkombëtarët janë jo vetëm ata që po na ndihmojnë për të kaluar krizën humanitare, për të rindërtuar rrugët, shkollat, spitalet, por ata janë dhe “modeli” që duam të imitojmë.

Ndërkombëtarët shfaqen në hapësirën politike jo thjesht si nevojë, por dhe si të mirëpritur, madje të “adhuruar” nga komuniteti politik. Në këtë moment të parë roli i tyre vjen dhe bëhet i rëndësishëm në raport me aktorët lokalë dhe zgjedhësit. Në sytë e zgjedhësve, ai aktor politik lokal që ka marrëdhënie më të ngushta me komunitetin ndërkombëtar, që është i aftë të sigurojë më shumë ndihmë, më shumë asistencë për vendin, të përparojë më shpejt integrimin e vendit në strukturat euro-atlantike, ai është sigurisht dhe më “legjitim” në skenën e brendshme. Aksioni i tij është me efikas në skenën e brendshme jo thjesht për shkak të legjitimitetit të tij në skenën lokale, por dhe për shkak të ndihmës së huaj. Nga ana tjetër, komuniteti ndërkombëtar është i prirur të shtojë mbështetjen, ndihmën apo inkurajimin për aktorët lokalë, të cilët janë me mbështetje popullore të gjerë. Sipas parimit të efikasitetit, harxhohen më pak energji për të prodhuar një rezultat politik, kjo duket diçka normale.

Në këtë mënyrë, në këtë fazë të parë, komuniteti ndërkombëtar në sytë e bashkësisë politike dhe të qytetarëve të thjeshtë identifikohet me palën në pushtet, pra “është bërë njësh me ta”. Ky “përforcim” prej dy legjitimitetesh që posedon aktori në pushtet, nuk ka sesi të mos degradojë në një shkarje drejt arbitraritetit politik, arrogancës, prishjes së rregullave të lojës. Sidomos në një vend ku kultura politike është e mangët dhe aftësia vetërregulluese e sistemit politik është ende e brishtë.

Mjafton të kujtojmë mbështetjen e madhe ndërkombëtare të presidentit Berisha në fillim të viteve ‘90, e cila ishte një prej arsyeve të arrogancës së pushtetit të tij në mesin e viteve ‘90 më zgjedhjet problematike të 26 majit dhe depresionin ndaj opozitës.

Në një kohë të dytë, në momentin kur konflikti politik ka mbërritur në një pikë kritike ose është në prag dhe ku ky konflikt rrezikon të hedhë në erë veç të tjerash edhe investimin

e komunitetit ndërkombëtar, këtij të fundit i duhet tanimë të ndërrojë rolin me shpejtësi. Nga një mbështetës dhe asistues i faktorit të brendshëm, në një “ndërmjetësues” i konfliktit që kërcënon me shkatërrim gjithçka. Në këtë çast hapësira politike ka hyrë në një krizë të fortë; Tanimë nuk është më e mundur të sigurohet një farë integriteti i kësaj hapësire politike pa praninë prej “ndërmjetësuesi” të komunitetit ndërkombëtar. Dhe më tej ajo nuk mund të funksionojë pa arbitrimin e ndërkombëtarëve. Ky model, pak a shumë i teorizuar në këtë mënyrë, është Shqipëria në ngjarjet politike dhe krizat e marsit 1997 dhe protestat e fuqishme të opozitës në shkurt të 2004-ës. Komuniteti ndërkombëtar është kthyer në ndërmjetësin politik mes aktorëve politikë të brendshëm, në “vlerësuesin” apo “noterin” e procedurës demokratike, i vlerësimit të zgjedhjeve apo i vendimeve të rëndësishme politike.

Si pasojë e këtij dimension të ri të legjitimitetit të faktorit ndërkombëtar edhe principet e legjitimitetit, të autoritetit apo sovranitetit nisin dhe transformohen për t’u shndërruar në forma hibride të modeleve origjinale apo teorike të autoritetit apo legjitimitetit.

Për aktorët lokalë, loja e tyre politike nuk zhvillohet më si më parë. Krahas strukturimit të aksionit politik në funksion të elektoratit, i cili normalisht është legjitimuesi i vetëm i aksionit të tyre, ata duhet ta strukturojnë atë edhe në funksion të interesave, të axhendës dhe dinamikës e faktorit ndërkombëtar. Është mjaft e vështirë t’i takosh këto dy logjika, atë të interesave dhe axhendës së elektoratit dhe atë të interesave dhe axhendës së ndërkombëtarëve. Ato zhvillohen secila në drejtimin e tyre, duke iu nënshtruar principeve krejt të ndryshme.

Hapësira politike nis dhe turbullohet dhe zgjedhësit kanë përshlypjen se ata “nuk vendosin më”; se vendimet merren në ambasada, në Bruksel apo Uashington; se sido që të votojnë ata në zgjedhje, e rëndësishme është se “kujt do t’ia japë fitoren OSBE-ja apo ndërkombëtarët”. Kjo manifestohet dukshëm në perceptimin që gazetatat apo gazetaret kanë mbi “faktorët” që e çojnë një parti drejt humbjes apo fitores. Mjafton të shohësh shtypin e kohës për të dalluar se të gjithë hetojnë me vëmendje çdo detaj të aksionit të ndërkombëtarëve lidhur me aktorët lokale. Kështu, zgjedhjet e vitit 2001 u duk se do të fitoheshin nga Partia Socialiste, apo se asaj do t’i njihej fitorja. Pak kohë para zgjedhjeve kryeministri i ri, Ilir Meta, bëri një vizitë në Shtëpinë e Bardhë, në SHBA, dhe pati një takim me zv.presidentin Dik Cenei dhe u takua shkurt në korridoret e Shtëpisë së Bardhë edhe me presidentin amerikan Bush. Detaje të tilla peshojnë shumë në skenën lokale.

Po ashtu, aktorët politikë lokalë në funksion të mbijetesës së tyre politike janë të detyruar të ndërtojnë një aksion politik krejt tjetër, që merr parasysh këtë princip të ri, sipas të cilit funksionon hapësira politike tani e tutje, me praninë përcaktuese

të ndërkombëtarëve në të. Aktorët lokalë dhe mbi të gjitha elektorati, zgjedhin dhe zgjidhen, por ata praktikisht nuk vendosin më vetë. Ose nuk vendosin më vetëm ata. Kjo, duke filluar që nga momenti me krucial: kush është fituesi i zgjedhjeve dhe gjithë të tjerat që vijnë pas kësaj.

### **ROLI I AKTORËVE NDËRKOMBËTARË NË NJË HAPËSIRË POLITIKE HIBRIDE: ATA VENDOSIN POR NUK JANË TË ZGJEDHUR.**

Komuniteti ndërkombëtar është jashtëzakonisht aktiv në Shqipëri, jo vetëm pse ka qenë gjatë gjithë këtyre viteve një kontribues financiar shumë i madh; jo vetëm pse është një kontributor i madh në ekspertizë dhe asistencë teknike për reformat në vend, por edhe për arsye gjeopolitike atij i duhet të jetë shumë aktiv në terren. Shqipëria ndodhet në një zonë gjeopolitike kyçe, në një rajon të trazuar apo në një pikë tranziti në portat e Perëndimit me të gjitha sa implikon kjo: trazira, trafik apo eksode probabël. Dhe së fundi, po aq e rëndësishme, prania e tij është bërë e domosdoshme për të ruajtur ekuilibrin politik në vend, për të mbështetur aftësinë “autorregullatore” të sistemit politik ende jashtëzakonisht të brishtë.

Për të gjitha këto arsye dhe për shkak të dinamikës që ka pësuar aksioni i komunitetit ndërkombëtar në terren, që nga viti 1991, nga një asistues i fushës politike, në një ndërmjetës apo lehtësues i lojës politike të brendshme deri tek shndërrimi në një arbitër dhe gjykatës i dinamikës së brendshme, ndërkombëtarët tani janë “pala e tretë” në hapësirën politike. Nëse hapësirën politike do ta ndajmë në mënyrë imagjinare në qeveria dhe opozita, me gjithë çfarë implikon kjo ndarje në elektorat, pra do të kishim dy palët e para, ndërkombëtarët do t'i quajmë për konvencion “pala e tretë”.

Kjo palë në hapësirën e re politike hibride ka një status krejt origjinal. Ajo ka fituar statusin e “palës së tretë” në kuptimin që gjykon, verifikon, certifikon apo noterizon procedurën demokratike në aspektet e saj themelore, siç janë ecuria e proceseve zgjedhore dhe reformat e rëndësishme në vend. Nga ana tjetër, “pala e tretë”, pra komunitetit ndërkombëtar, për të plotësuar funksionin e parë, i duhet të shprehet periodikisht “çfarë është mirë apo çfarë është keq” në aksionin e dy palëve të para. Duke bërë këtë, ai hyn direkt si bashkautor me dy palët e tjera në strukturimin e aksionit politik të brendshëm. Por, në ndryshim nga dy palët e tjera, kjo e fundit ka një specifikë: ajo nuk votohet nga elektorati, nuk jep llogari për përmbajtjen dhe rezultatin e aksionit të vet. Është jashtë logjikës që ndërkombëtarët të mund

të mendohej se do të votoheshin, duke qenë aktorë politikë të plotë në hapësirën politike. Në këtë mënyrë, pala e tretë ose ndërkombëtarët vendosin, por nuk votohen.

Edhe kritikët më të mëdhenj të rolit të komunitetit ndërkombëtar në Tiranën politike as e shkojnë ndër mend të kthehemi në një situatë të tillë, ku hapësira politike do të zhdukte praninë dhe rolin e ndërkombëtarëve në zhvillimet e vendit. Efekti i parë i këtij operacioni do të ishte një rrezik i hapur për të rënë një tirani apo izolim të ri. Një hapësirë politike lokale pa praninë e ndërkombëtarëve do të “zhdukte” çdo kujdes të pushtetit për të qenë i kujdesshëm dhe luajal në skenën politike me opozitën apo me elektoratin. Prania e komunitetit ndërkombëtar është një presion mjaft pozitiv kundrejt aktorëve lokalë, në mënyrë që këta të fundit të sillen sa më konform procedurës demokratike. Ndërsa një hapësirë politike ku ndërkombëtarët “do të zhdukeshin”, është jo vetëm e paimagjinueshme për kontekstin lokal dhe rajonal të sotëm, një gjë e tillë është po aq e padëshirueshme nga komuniteti politik lokal. Përveç ndonjë aktori episodik, edhe apo mediatic, edhe pas kritikave në rritje për aksionin ndërkombëtar në Shqipëri, ligjërimi i aktorëve shoqërorë është i tillë që pranon nevojën e kësaj pranie ndërkombëtare në skenën politike lokale. Po nga ana tjetër, mënyra se si e strukturon aksionin politik komuniteti ndërkombëtar atje, mbetet një problem i hapur.

Një hapësirë politike e tillë, me praninë e kësaj forme, kësaj cilësie dhe këtyre përmasave të komunitetit ndërkombëtar në strukturimin e aksionit, shndërrohet vërtet në një “tjetër gjë”.

Në të njëjtën kohë kriteret e vlerësimit dhe gjyqimit të një hapësire “politike hibride” në funksion të legjitimitetit të pushtetit dhe legjitimitetit të aksionit të tij politik, mbeten për t'u riparë. Ato nuk mund të jenë kurrsesi ato të parat, ku kjo hapësirë politike dhe sjellja e aktorëve lokalë do të bëhej në funksion të kriterëve të “legjitimitetit racional”.

Nga ana tjetër, nuk mund të flasim as për një “sovrانيتet ndërkombëtar” ndaj Shqipërisë. Ky i fundit as nuk është i vendosur zyrtarisht dhe as kriteret praktike të tij në terren nuk janë të tilla.

Implikimet e brendshme të gjithë kësaj i ndeshim përditë në mënyrën se si strukturohet aksioni politik i brendshëm, se si misionet ndërkombëtare apo evropiane janë të instaluar në pothuaj çdo ministri apo fushë të veprimtarisë së qeverisë, se si manëveshjet për reformën elektorale, janë bërë dhe bëhen ende nën asistencën e OSBE-së apo të BE-së.

\* Autori është pedagog në Universitetin Evropian të Tiranës. Ai është doktorant në filozofi politike. Ka kryer master për filozofi politike në universitetin PARIS 8, Francë dhe është diplomuar për shkencë politike në Universitetin Paris 8, Francë. A

## MONITORIM

### \*INTEGRIMI, I (PA) KUPTUARI I MEDIAS SHQIPTARE\*

Nëse je dikush që për arsye pune apo apo pasioni je ekspert për çështjet e integritimit European, i historisë apo të institucioneve të BE, dhe nëse ndjek median shqiptare, ka gjasa të të ndodhë si atij muzikantit profesionist, i cili është i pranishëm në një dasëm dhe tërbohohet nga mungesa e harmonisë muzikore tek sazet amatore. Kështu mund të shohësh një shkrim për Komisionin European dhe të gësh si ilustrim për të një foto të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Mund të dëgjosh në televizion, një lajm mbi mbledhjen e shefave të shteteve dhe qeverive të BE, i cili për kronikanin është një mbledhje e “Këshillit të Europës”. Një pafundësi e tillë detajesh do të seleksionohet me pasion nga një monitorim manierist i trajtimit të çështjeve të BE dhe integritimit European në median shqiptare.

Por të mos e teprojmë: gazetarët janë gjithsesi grupi shoqëror dhe profesional që di megjithatë më shumë për Europën sesa grupet e tjera të vëzhguara. Ky është përfundimi një sondazhi i zhvilluar në vitin 2003, nga Instituti i Studimeve Ndërkombëtare në Tiranë, i publikuar nën titullin “Integritimi European: perceptime dhe realitete”. Blendi Kajsu, lektor i shkencave politike në Universitetin e Tiranës, autor i studimit thotë:

*“Duhet theksuar që gjatë sondazhi konstatoam se njerëzit e medias kishin më shumë njohuri mbi Bashkimin European dhe integritimin në BE sesa kategoritë e tjera të intervistuar si Administrata Publike, OJQ-të dhe Biznesi.”*

Nuk ka asnjë zgjidhje tjetër përveç medias. Përmes saj, kategoritë e gjera të popullsisë dhe të gjithë ne jemi të detyruar ta ndjekim dinamikën e procesit të Integritimit European të Shqipërisë apo të ecurisë së vetë Bashkimit European. Përveç një grushti ekspertësh apo studiuesish, të cilët burim për këtë kanë shkresat, dosjet e punës, librat apo arkivat.

#### 1 - INTEGRIMI, TEMA E RE DHE E VJETËR E MEDIAS SHQIPTARE

Nëse kolegët perëndimore të gazetarëve shqiptarë, kanë të paktën që nga Traktati i Qymyrit dhe i Çelikut, që flasin, trajtojnë, ndjekin apo kualifikohen rreth çështjeve të Integritimit European, këtë fat nuk e kanë gazetarët shqiptarë. Europa është një temë e shtypit shqiptar me të njëjtën moshë si “Demokracia”, “Pluralizmi” apo “Ekonomia e Europës”. Në fakt parrulla kryesore e studentëve të dhjetorit 1990, gjatë demonstratave kundër

komunizmit, “E duam Shqipërinë si e gjithë Europa”, do të shënonte edhe “temën e parë europiane” në median shqiptare dhe krejt shoqërinë shqiptare, pas së cilës “një gazetar europian” do të rritej bashkë me gazetarin e lirë shqiptar në vitet që pasuan.

Temat e para rreth “Tregut të Përbashkët European”, “Unionit European” e kështu me radhë nisën të shfaqen në median shqiptare pak e nga pak, kryesisht si ilustrim i alternativave politike të partive të ndryshme, të cilat shpejt shpallën “integritimin euro-atlantik” si objektivin e ri politik të Shqipërisë.

Në vitin 1993, dhe më tej për publikum e gjërë Televizioni Shtetëror hapi një emision periodik me raportime nga Brukseli materiale njohëse për Bashkimin European. Dalëngadalë “subjekti” Europa u bë një temë prezente në median shqiptare në forma të ndryshme. Së pari si pasqyrim i ligjërimit politik të ditës, më tej “Europa si donatorja më e madhe e Shqipërisë” pak më vonë me negociatat për marrvëshjen e Asocimit, e më tej me Marrvëshjen Shengen e kështu me radhë.

*“Europa” është njëkohësisht një temë e re dhe e vjetër e shtypit shqiptar, sepse vete BE është një realitet në lëvizje. Gjatë këtyre 15 viteve të fundit, kemi marrvëshje të reja, traktate të reja, insitucione të reja, anëtarë të rinj, rregulla të reja.*

Nëse specialistët apo ekspertët nuk kanë shpresë të mësojnë ndonjë gjë të re nga gazetatat apo televizionet rreth integritimit european e BE-së, po “lexuesi”, a është mjaftueshmërisht i informuar nga media shqiptare rreth kësaj çështjeje. Në fund të fundit ky është preokupimi kryesor i shtypit. Mark Marku, pedagog në departamentin e gazetarisë, Universiteti i Tiranës dhe drejtor i zyrës së Etikës në gazetën “Shekulli” vëren:

*“Mendoj se dy janë problemet kryesore në lidhje me informimin për BE-në dhe çështjet e integritimit. Problemi i parë: lexuesi informohet pak dhe në mënyrë jo cilësore për Evropën nga media për shkak se niveli i informimit të stafëve mediatike nuk është në nivelin e duhur, si dhe për shkak se “informacioni për Evropën” shitet pak ose e shprehur në zhargonin gazetaresk, përbën lajm shumë rrallë dhe vetëm kur bëhet fjalë për ndonjë gjë që ka lidhje me fatin e Shqipërisë në BE. Dhe meqë Shqipërisë nuk po “i del fati” atëherë njerëzit nuk shohin ndonjë interes të veçantë për çështje evropiane. Problemi i dytë ka të bëjë me dezinformimin sistematik për çështjet e integritimit. Meqenëse Shqipëria apo më saktë qeveria shqiptare ka patur shumë dështime në këtë drejtim bëhen mjaft përpjekje propagandistike për të dezinformuar për të kundërtën d.m.th. që qeveria nuk ka dështuar.”*

Rreth kësaj vertebre dyfishe mbështillet problemi i trajtimit të problemeve të Europës dhe integritimit në median shqiptare: nga njëra anë Europa duket larg për "lexuesin" që ka në kokë çdo kryeredaktor kështu që dhe redaksitë janë të preokupuara me kronikën e ditës; nga ana tjetër sepse siç është e natyrshme për çdo qeveri, tentohet që publikut "Europa" t'i largohet në mënyrë që paqartësia rreth ecures së integritimit të jetë sa më madhe.

Për Edmond Harizajn, gazetarin, i cili ka braktisur përkohësisht profesionin për të bërë zëdhënësin e ministrisë së re të Integritimit, tabloja e trajtimit të problemeve të integritimit në median shqiptare nuk duhet parë me aq dramacitet:

*"Procesi i integritimit evropian mund të quhet "i ri" për shoqërinë shqiptare. Për këtë arsye edhe media nuk bën përjashtim. Duke nisur nga kjo, ende gazetaret dhe analistët nuk kanë kuptuar thelbin e vërtetë të procesit të integritimit të Shqipërisë në BE; që ky integrim arrihet vetëm pas plotësimit të disa standarteve, e që Shqipëria për shumë arsye, që kanë lidhje edhe me të kaluarën e saj, pavarësisht hapave të hedhur, është në rrugën e duhur, por ende larg. Megjithatë media në përgjithësi është e fiksuar vetëm pas datës së mbylljes së negociatave. Kjo do të thotë, që media pak ose aspak ka kuptuar realitetin e procesit të integritimit, i cili është shumë kompleks dhe pas dates 1 maj, akoma dhe më i vështirë."*

Vetë gazetaret dhe drejtuesit e redaksive konstatojnë pothuaj unanimitisht se problemet e integritimit nuk janë të trajtuara mirë në median shqiptare. Analizën e fenomenit e bëjnë të parët ata, të cilët si të thuash e njohin nga brenda situatën. Për Robert Rakiplarin, kryeredaktori i gazetës SHEKULLI, e përditshmja më e madhe në vend:

*"Ka një konfuzion në kuptimin që kanë gazetaret mbi çështjet e integritimit evropian. Duke nisur nga elementët e thjeshtë, data, emra, insitucione. Kuptohet pastaj që në trajtim ka edhe më tepër probleme. Shpesh-herë kjo çështje është trajtuar në kuptimin e pozicioneve që kanë mediat. Mediat opozitare theksojnë mesazhet negative të Brukselit, ato proqeveritare bëjnë të kundërtën. Ky trajtim ka sjellë si rezultat një perceptim të ngushtë në opinionin publik, një perceptim të tipit: Po hymë në BE do të hiqen vizat."*

Për kryeredaktorin e gazetës TEMA dhe editorialistin Mero Baze, një analizë do mënyrës sesi media shqiptare e trajton temën e Europës do të kërkonte zgjerimin e optikës, për të parë në të vërtetë se sa e vogël është ende ajo:

*Ka një vështrim sipërfaqësor për problematikën e integritimit dhe njohjen me shtetin e Evropës. Shumë gazetarë kryesorë, janë ende të paqartë për detyrimet shqiptare për t'u strukturuar si një shoqëri e gatshme të pranojë hyrjen në BE. Në shumë raste e marrin thjesht si detyrë qeverie. Në të vërtetë është një detyrim shumë i madh dhe shoqëror, është një disiplinë e re, të cilën nuk e kemi marrë seriozisht, si shumë tema të globalizmit dhe fenomeneve bashkëkohore.*

Por më shumë se sa t'i shohim çështjet në përgjithësi apo teorikisht, disa të tjerë janë të mendimit se duhet vepruar konkretisht: zgjerimi i hapësirës së temave europiane në faqet e gazetave apo ekrane. Kështu televizioni KOHA, një ekran, i cili së fundi është riformatuar dhe po garon në kërkim të audiencës së tij në tregun shumë të ashpër të ekraneve shqiptare, ka hapur një program të posaçëm dedikuar krejtësisht temave të BE. Dokumentarë njohës, telereportazhe, që "edukojnë" publikun për Europën. Televizioni Satelitor ALSAT, ka kohë që bën një gjë të tillë, ndoshta jo dhe aq në mënyrë të programuar, se sa në kuadrin e dokumentarëve të shumtë që ai transmeton, një program tipik për formatin e këtij ekrani. Kryeredaktori i lajmeve në TV KOHA, Franko Egro, i cili ka qenë për shumë kohë vetë një gazetar për çështjet ndërkombëtare, sheh megjithatë problemet e mbulimit të temave të Europës:

*"Ndonëse disa përpjekje bëhen, kam përshtypjen se ato janë të pakta, të izoluar dhe sporadike. Janë shumë të pakta TV dhe radiot që i kushtojnë hapësirë këtyre temave që janë realisht jetike për të ardhmen. Nuk i kushtohet rëndësia dhe vëmendja e duhur zbërthimit të temave të integritimit, të përgjegjësive, detyrave, detyrimeve dhe mbi të gjitha mënyrës se si do të përmbushen ato konkretisht. Vështirë se mund të gjenden gazetarë që do të mund t'i merrnin në pyetje "inkuizitive" politikanët shqiptarë që merren me këto çështje."*

Shtypi i shkuar e ka më të vështirë për të qenë aq efikas sa televizioni në këtë mes, por mund të bëjë diçka. Kryeredaktori i gazetës Korrieri, Alfred Peza "ndërton" përpjekjen e tij për të trajtuar më mirë çështjet e BE në gazetën e tij, ku iniciativat për ta bërë "më të kuptueshme" Europën dhe Integritimin nuk kanë munguar:

*"Në bashkëpunim me Ambasadën Gjermane në Tiranë, kemi botuar një cikël shkrimesh informuese rreth historisë, insitucioneve por edhe një fjalorth të integritimit. Nga ana tjetër, jemi munduar të jemi të vëmendshëm për t'i dhënë hapësirat që meritojnë në gazetë, ngjarjeve kryesore rreth procesit evropian. Gjithsesi, nuk mund të themi se ne jemi plotësisht imunë, ndaj*

*sëmundjes sonë të përbashkët, të mungesës së perceptimit të qartë të procesit të integrimit evropian.”*

Tema evropiane në median shqiptare duket se është ende e “re” në kuptimin e e rëndësisë, përmasës që ajo duhet të ketë. Shefi i sektorit politik në gazetën SHEKULLI, Arion Sulo, pas shumë vitesh punë në redaksitë politike, ka përshtypjen se:

*“Ndonëse me kalimin e kohës ka një avancim në kahun e duhur dhe duke përjashtuar raste të veçanta (debatet në televizion), përgjithësisht media është në fazën e paqartësisë dhe të moskuptuarit me rrënjë të çështjeve të integrimit, gjë që i përcillet dhe publikut. Fjala vjen, në shumë media ngatërrohet ende Komisioni Evropian me Këshillin Evropian.”*

## **2- BE DHE INTEGRIMI, TË “MBULOSH” NJË NGJARJE QË ZHVILLOHET KUDO**

Por nuk është e thjeshtë për kapacitetet e medias shqiptare të mbulojnë mirë problemet e Europës dhe integrimit. Së pari kërkon kapacitete të të dy llojeve, materiale dhe njerëzore. Gazetarët dhe redaksitë janë alergjikë ndaj një kritike thjesht në parim, e tipit: “media shqiptare nuk i mbulon mirë çështjet e Europës”. Dhe vërtet në redaksitë shqiptare sundon realizmi kundrejt foljes pavetore “duhet”. Redaktorët “ulërasin” pak a shumë këtë thirrje: ku janë ekspertët, ku janë politologët apo ekonomistët që të shkruajnë për çështjet evropiane?

Alfred Peza, kryeredaktor i gazetës Korrieri tregon së pari përvojën e tij për të mbuluar çështjet që kanë të bëjmë me BE ose integrimin në gazetën e tij:

*“Me mundësitë njerëzore, financiare dhe teknologjike që kemi në dispozicion, jemi munduar që këtë boshllëk ta plotësojmë nëpërmjet shfrytëzimit të të gjitha burimeve për të informuar sa më mirë që të jetë e mundur lexuesin, jo vetëm me lajmet rreth procesit të integrimit, por edhe nëpërmjet analizave dhe opinionëve të ekspertëve më të mirë për këto çështje.”*

Por të mbulosh çështjet e Evropiane nuk është e thjeshtë. Së pari tema “Europa” në vetvete është shumë e gjerë. Duke filluar nga Brukseli ka ndodhet e përqëndruar administrata kryesore e BE, e deri në një pafundësi destinacionesh dhe temash, të cilat janë të lidhura direkt ose tërthorazi me problemet e integrimit: si problemi i zgjerimit, apo gjeopolitika e BE, si çështjet e peshkimit dhe ato të bujqësisë, si çështjet e sigurisë e deri tek ato të vizave.

Pra një gazetari evropiane më vete, do të duhej të zhvillohej në gjirin e redaksive për të përmbushur mirë mbulimin e çështjeve të integrimit në median shqiptare. Shumë redaksi e kanë filluar punën me atë metodikë që ata e kanë menduar më të përshtatshme. Psh një korrespondent në Bruksel apo Strasburg.

Gazeta TEMA, një e përditshme e qendrës së djathtë, modeste nga pikëpamja e mjeteve financiare në dispozicion në krahasim me rivalët e saj të qendrës së majtë, megjithatë ka vlerësuar që në fillim se do ti duhej një korrespondent në Bruksel. Përkundër idesë së një korrespondenti në Bruksel a Strasburg kushton shumë për redaksitë tona Mero Baze, kryeredaktori i TEMA thotë:

*Nuk kanë një preokopim për këtë çështje pasi mundësi gazeta ka. Gazetarët shqiptarë që raportojnë nga Brukseli nuk janë aq luksoz sa gazetarët që raportojnë nga kafenetë e Tiranës. Ne duhet të pranojmë që një gazetar prej Bruskelit të raportoj për disa media të shkruara dhe elektronike në Shqipëri Kosovë dhe gjetk dhe ai plotëson një rrogë të mirë. Por së paku kushton më pak se gazetarët që rrijnë në Tiranë në kafene dhe flasin për Bruskelin. Pra nuk është luks i tepërt ta kesh një gazetar në Bruskel, është çështje e konceptit që ka shtypi këtu për rëndësinë e Bruskelit.*

Ka një vështirësi të kundërt Robert Rakiplari, kryeredaktor i gazetës SHEKULLI, e përditshmeja më e madhe në vend me një linjë editoriale që është afër qendrës së majtë. Ai mendon se problemi fillon tek koncepti i botuesve, të cilët nuk kanë ndonjë ide të qartë të rëndësisë së “redaksisë së Bruskelit” për mediat tona.

*Edhe pse pothuajse të gjitha mediat kanë korrespondent në Bruksel, mesa duket ende nuk ka një mbulim të saktë të çështjeve të integrimit në median shqiptare për shkak të filozofisë së drejtuesve të tyre. Shtypi shqiptar u jep më tepër rëndësi ngjarjeve në formën e kuriozitetëve dhe nuk përballon dot problematika që përfshijnë trajtime specifike që lidhen me filozofinë dhe ekonominë. Botuesit shqiptarë janë të prirur të kenë të njëjtat standarte trajtimi të korrespondentëve në Bruksel me reporterët në redaksitë e tyre, gjë që nuk shkon.*

Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për të gjitha redaksitë, edhe nëse janë redaksitë më të rëndësishme të medias shqiptare. Rasti është i TV KLAN, për kryeredaktorin e lajmeve të cilit, Zylyftar Bregu, ndryshe nga kolegët e tjerë problemi i vërtetë është “botuesi”, i cili është i pandërgjegjësuar për vendin që duhet të zënë në organet e tyre temat evropiane. Për pasojë dhe mjetet financiare që kjo kërkon.

*TV Klan nuk ka korespondent në Bruksel. Unë mendoj që media shqiptare ka kapacitet njerëzor por jo teknik*

*për të mbuluar dinamikën e procesit evropian. Dhe kjo vjen ngaqë botuesit shqiptar nuk investojnë për të arritur këtë gjë. Nuk jam i sigurt për arsyen pse nuk investojnë. Për shkak se nuk kanë mundësi financiare për të bërë një gjë të tillë. Apo nëse paragjykojnë, mendojnë apo janë të bindur se një investim i tillë nuk është i justifikueshëm parë në aspektin e biznesit të tyre. Për këtë duhet të shprehen pronarët.*

Këtij mendimi i bashkangjitet edhe drejtori i lajmeve të TV KOHA, Franko Egro, i cili megjithatë insiston gjithashtu edhe në një moment tjetër: qasja tejet politike që kanë mediat shqiptare ndaj temave europiane.

*Në Shqipëri mediat nuk i kanë kapacitetet e duhura. Më konkretisht: Nuk ka njerëz të specializuar në këtë drejtim: Nuk njihen prej gazetarëve temat që permenda në përgjigjen e pyetjes së parë: Nuk ka shume korrespondentë cilësorë në qendrat europiane: Lajmet nga Brukseli, Luksemburgu dhe Strasburgu shpesh trajtohen nga këndvështrimi politik dhe jo profesional: Një trajtim i tillë ja heq opinionit dëshirën për t'i dëgjuar dhe më pas për t'i tretur këto çeshtje: Bisedat me perfaqësues të Brukselit dhe të trupit diplomatik në Tiranë më kanë lënë të kuptoj së gjithshka bëhet në Shqipëri është sipërfaqësore dhe aspak konkrete: Keqkuptohen shumë tema, duke e reduktuar integritimin në perfundime të tilla si heqja e vizave etj: Mediat e shohin procesin e raporteve me BE jo si tema të ditës, ose të rëndësisë parësore*

Për korrespondentën e Agjensisë Franceze të Lajmeve në Tiranë, Briseida Mema, e cila ka një përvojë të gjatë në bashkëpunimin me një agjensi europiane, kontrasti mes asaj që kolegët europiane të mediave shqiptare dhe atyre vetë është shumë i madh.

*Për Europën në median shqiptare flitet pak e trajtohen keq. Mediat nuk kanë kapacitete. Interesohen thjesht në mënyrë të rastësishme për këto probleme, që shihen të shkëputura e jo në një trajtim global të tyre. BE bëhet objekt vetëm në rast se në ndonjë rast është cituar Shqipëria. E kjo bën që problematika e BE-së të jetë shumë e cinguar në shtypin shqiptar, duke krijuar shpesh edhe kundërthënie*

Një korrespondent në Bruksel, është një gjë e domosdoshme por jo e mjaftueshme. Duhet edhe shumëcka tjetër. Kështu mendon kryeredaktori i gazetës Korrieri Alfred Peza lidhur me një mendim që e redukton mbulimin e çështjeve europiane vetëm në pasjen e një korrespondenti në Bruksel, i cili shumë shumë mund të kontaktojë ndonjë zëdhënës të komisarëve europinë. Përtej kësaj ai nuk do të bënte dot ndonjë gjë më të madhe, sepse njoftimet për shtyp janë të disponueshme për të gjithë në faqet e internetit.

*Mediat shqiptare dihet që megjithëse të shumta aktualisht në numër, janë të varfëra. Për rrjedhojë, nuk mund të pretendohet se kanë kapacitetet e mjaftueshme njerëzore dhe teknike për të mbuluar hap pas hapi, të gjithë dinamikën e procesit të integritimit evropian, pjesë e së cilës është edhe Shqipëria. Një boshllëk i tillë, nuk mund të mbulohej me ndonjë korrespondent që disa media mund të kenë në Bruksel, por nëpërmjet investimeve inteligjente, me strategji të qarta dhe koshiente nga ana e botuesve.*

Për Edmond Harizajn, zëdhënës i ministrisë së Integritimit, gjendja e mediave shqiptare në raport me kapacitetet njerëzore dhe materiale paraqitet shumë më e komplikuar seç duket. Aty marrin pjesë shumë faktorë, ku sundon ideja që integritimi është “zarf” që do të vijë në valixhen diplomatike të diplomatëve direkt nga Brukseli në Rinas.

*Nuk mund të japësh një përgjigje të sakte persa u perket kapaciteteve njerëzore dhe teknike. Por është evident fakti, se për çështjet e integritimit evropian, mediat nuk kanë marre asnjë ekspert “me qira” për të luajtur rolin e gazetarit vetëm në këto fushe, duke shpjeguar gjithë strukturat dhe funksionimin e BE-se, apo për të shpjeguar rrugën që kanë bërë vendet që janë futur rishtaz në BE. Besoj se egziston një mendim, që Shqipëria nuk e ka vete në dorë integritimin, gjë që është shume e gabuar. Nga ana tjetër, botuesit ende nuk e shohin integritimin si çështje primare, që të investojnë njerëz dhe teknike. Mund të thuhet se shkrimet, komentet apo dhe analizat që lidhen me integritimin janë në plan të dytë nga editoret.*

“Edhe për teknologjinë elementi i parë është njeriu”. Ky slogan i një reklame vjen dhe bëhet aktual kur bëhet fjalë për kapacitetet njerëzore të redaksive shqiptare për mbulimin e çështjeve të BE. Pas shumë vitesh përvojë duket se këtu kërkohet të investohet. Arion Sulo, redaktor politik i SHEKULLI, thotë se



të punosh me reporterët politikë nuk është e thjeshtë. Pikërisht këtu duhet përqëndruar.

*Shumë media kanë korrespondentë të atashuar në Bruksel apo ndjekin samitet e rendëishme të BE-së me të dërguar nga Tirana, por ajo që mungon është cilësia e raportimeve, të cilat mbeten sipërfaqësore dhe në kuadrin e deklaratave. Për këtë arsye investimet duhet të drejtohen tek trajnimet.*

Kjo nevojë e këtij momenti duket se ka mbërritur deri në tavolinën e ekipit akademik të departamentit të gazetarisë së universitetit të Tiranës, i cili është prej kohësh burimi kryesor i furnizimit të medias shqiptare me reporterë, gazetarë, redaktorë. Aktualisht në programin e gazetarisë ka një cikël leksionesh për institucionet e BE dhe integrimin European por kjo duket se nuk mjafton më. Departamenti i gazetarisë në kuadrin e ristrukturimit sipas Procesit të Bolonjës, planifikon jo vetëm të shtojë lëndët që i formojnë studentët në këtë lëmi por edhe të japë në nivelin mastër edhe një diplomë për “Gazetari Europiane”. Merk Marku, pedagog në këtë departament mbështet plotësisht idenë e përfundimit të dozës “europiane” në formimin universitar të kandidat – gazetarëve të ardhshëm.

*Mendoj se departamenti dhe universiteti në përgjithësi është vendi ku informohet më mirë për këto probleme, por megjithatë mendoj se ende ka shumë gjëra që duhen rregulluar në këtë drejtim. Studentët duhet të kenë në strukturën programore lëndë të veçanta për Evropën dhe problemet evropiane pasi deri tani çështjet evropiane trajtohen si të gjitha çështjet e tjera ndërkombëtare e jo çështje të një strukture multinacionale shtetërore ku synojmë të përfshihemi.*

### **3- INTEGRIMI LEHTËSIA E RËNIES NË NJË PROPOGANDË TË RE.**

Media e lirë është një mjet efikas për përballuar çdo lloj propogande, por po aq është edhe një mjet efikas për të krijuar e ngulitur propoganda të reja, në kohë të ndryshme, për tema të ndryshme. Shumë vlerësime rreth integritetit europian të Shqipërisë bëjnë pikërisht këtë konstatim: Përmes medias integrimi po kthehet në një propogandë të re, që pak nga pak po i zë vendin një “propogandë” pasardhëse, siç që deri para pak vitesh propoganda mbi “tranzicioni”. Proceset e komunikimit kanë ligjësitë e veta dhe nuk është e thënë që një qendër e vetme të vendosë një herë e mirë për to. Rënia në propogandë e një termi apo procesi ndodh natyrshëm për shumë faktorë; si rezultat i pasqyrimin të aktulitetit politik; si rezultat i parazitizmit apo

dembelisë së redaksive për tema të reja, për subjekte interesante dhe për trajtim jo skematik të tyre.

Gjatë studimit për realitetet dhe perceptimet e Integritetit European, kërkuesi Blendi Kajsia vuri se edhe pse gazetarët ishin më mirë se grupet e tjera të testuara në ngushtimin e hendekut mes perceptimit dhe realitetit të integritetit, prapëseprapë.....

*Megjithatë edhe këtu vereheshin disa nga keqperceptimet që mbizoteronin në përgjithësi. Nga këto vlen të veçojmë dy. E para lidhet me levizjen e lirë, e cila shikohej si përfitimi kryesor i Shqipërisë nga integrimi, lëvizja e lire shikohej edhe më e rëndësishme se zhvillimi ekonomik apo demokratizimi, gjë që është shqetësues pasi duket se vjen si pasojë e dëshirës së madhe për t'u larguar nga Shqipëria. Së dyti integrimi shikohej si një proces që fillon në Bruksel dhe mbaron në Tiranë dhe jo anasjelltas.*

Në kushtet e një medie të lirë, cili është ai vullnet apo ai “shkak” që sjell që një temë të bëhet një lloj propogande? Është e qartë se mungesa e një vështrimi kritik jo thjesht mbi ecurinë e procesit, nga aktorët që e bëjnë atë, por pikësisht mbi përmbajtjen e tij. Kjo duket se mungon dhe i le një terren për “rjedhje të lirë” propogandës. Sipas autorit të studimit në fjalë, Kajsia

*Vërehet një nje unitet i frikshëm mendimi se antaresia e Shqipërisë në BE jo vetëm është rruga e vetme për zhvillimin e Shqipërisë, por edhe zgjidhja përfundimtare e të gjitha problemeve të saj. Them unitet i frikshëm mendimi pasi shpesh nga menyra se si artikulohej të kujton dogmatizmin komunist kur ekzistonte qartësia absolute se komunizmi ishte zgjidhja totale e problematikës shqiptare. Sado e vertete të jetë apo të duket teza e mësipërme është shqetësues fakti që nuk artikulohej në asnjë rast teza e kundërt. Jo vetëm kaq por mendoj se ekziston edhe një farë autoçensure që pengon shprehjen e kritikës apo dyshimit në lidhje me absolutizmin e integritetit pasi një qendrim i tillë mund të marginalizojë. Këtu flitet jo vetëm për mediat, por edhe për OJQ-të apo analistët e varur dhe të pavarur.*

“I dyshuari” i parë në qëllimet e tij për ta shndërruar problemin e integritetit në një lloj propogandë me ndimën e medias është pushteti. Kjo nuk ndodh vetëm, këtu, është kudo dhe është në natyrën e pushtetit. Por pretendimi i parë që mediat dhe shoqëria duhet të kenë ndaj qeverisë është transparenca e procesit. Për Edmond Harizajn, qeveria është mjaftueshmërisht e hapur dhe transparente dhe për pasojë shtypi ka mundësi, të shohë, të dëgjojë, të gjejë, të konfrontojë faktet

dhe të bëjë analizat. Ai e shikon kyçin e detyrës së qeverisë për të qenë transparente në ndërtimin e marrdhënieve publike sa më efikase. Ministria e tij ka një rol të dorës së parë këtu lidhur me të cilin ai thotë:

*Mund të them me bindje të plotë se askush prej gazetërëve që kanë trokitur në dyert e Ministrisë së Integritimit Europian nuk janë kthyer pas. Madje, edhe vetë Ministria e Integritimit Ermelinda Meksi, përherë ka qenë e gatshme për të komunikuar me gazetaret në çdo moment që ata kanë dëshiruar, me qëllimin e vetëm, sqarimin deri në detaje të çështjeve të ndryshme të këtij procesi të komplikuar. E njejtë gatishmëri ka qenë edhe nga stafi i ministrisë së integritimit. Gjithsesi do të thosha që Ministria e Integritimit Europian, përpiket të japë relitetin e procesit, veshtiresitë e tij dhe jo ta zbkuroje atë. Sepse duke qenë të gjithë koshiente për këto veshtiresi do të mund të gjejme gjuhën dhe rrugën e duhur drejt qëllimit të perbashket, integritimit në Europë.*

Qëndrimi editorial dhe linja e botimit, në fund të fundit është ajo që mbetet në mendjen e lexuesit. Ky i fundit e ka të pamundur të orientohet në pafundësinë e fakteve, detajeve, axhendave, standarteve etj etj. Pikërisht këtu tek komentet dhe qëndrimi editorial rreth çështjeve të integritimit duket se ka diçka që nuk shkon, e cila pranohet thuajse unanimisht nga njerëzit e medias. Shumë media përpunojnë një opinion, sipas të cilit “integrimi është çështje e të gjithëve”, “të gjitha palët janë përgjegjëse” etj. Kjo skemë duket se e bllokoi gjykimin, që pa nisur dhe i lë gjërat pa lëvizur. Shkurt asgjëzoi një nga mjetet më të efektshme të demokracisë liberale: llogaridhënien. Lidhur me këtë Alfred Peza, komentoi:

*Ky lloj gjykimi është një sëmundje e tranzicionit në mediat shqiptare, jo vetëm kur ato flasin apo analizojnë çështjet e integritimit, por edhe për shumë çështje të tjera. Shumë analistë, opinionistë, apo redaksi mediash, në emër “të paanshmërisë” apo “pavarësisë” editoriale, gjykojnë në mënyrë të rrumbullakosur, duke mos vënë gishtin në plagë. Ky lloj oportunitizmi është një nga sëmundjet e medias sot, që i bën ato në këtë mënyrë, pa ngjyrë, pa formë, pa trajtë dhe duke qenë se mendimet e tyre janë tashmë krejt të lexueshme, i bën vetë mediat, të paluxueshme, duke qenë një nga faktorët se përse publiku ka humbur besimin tek ta.*

Edhe për kryeredaktorin e gazetës SHEKULLI, Robert Rakiplari, ka pak a shumë një pamje të tillë, e cila

është edhe për shumë çështje të tjera të aktualitetit politik dhe shoqëror në Shqipëri.

*Por në të vërtetë ekziston një modë e tillë e të trajtuarit të kësaj çështjeje në disa prej gazetave dhe TV-ve, sipas të cilave “kanë faj të dyja palët”. Kjo lloj atmosfere që krijohet kësaj ruan në të vërtetë status-kuonë, madje do të thoja se ndihmon në rritjen e abuzimeve të qeverisë, shtimit të korrupsionit dhe sidomos stimulon dhe pajtohet me vjedhjen e votave, një prej shkaqeve kryesore që Shqipëria nuk bën përpërpara në raport me Brukselin që nga 26 maji i vitit 1996. Ka mjaft zëra, të cilët në emër të “pavarësisë” e shohin integritimin si “një përgjegjësi të shoqërisë shqiptare”, “një sfidë të përbashkët pa ngjyrim politik”, et, etj.*

Për kryeredaktorin e lajmeve në televizionin KLAN, duket se ka një tjetër frymë në shtyp e cila si të thuash e ruan fillin e ngjarjeve dhe rendin e gjërave.

*Me duket se shtypi e thotë qartë se përgjegjësia kryesore për pengesën e integritimit është ekzekutivi, pra pozita. Por nuk përjashtohet edhe opozita, e cila mund të behet katalizator apo pengesë e proceseve për përmbushjen e kriterëve që kërkon ky proces. Për të qenë më konkret në këtë mendim timin, mendoj se në masën 80 përqind është pozita dhe 20 përqind opozita.*

Rreziku që i kanoset komunikimit, përkatësisht medias për tu bërë monoton, është shumë evident, bëhet fjalë për tema të tilla si ajo e integritimit, e cila perceptohet nga qytetarët si çështje larg tyre. Edhe media e vendeve europiane, anëtare të BE, janë gjithnjë para këtij rreziku. Aq më tepër media shqiptare, kur jemi ende shumë larg integritimit real dhe përfundimtar. Fenomenet apo efektet e padëshiruara, janë ato që mbërrijnë të parat.

#### 4- INTEGRIMI, NË KËRKIM TË KRITIKËVE TË TIJ?

Herbert Markuze, filozofi emblemik i Shkollës së Frankfurtit, thoshte në vitin 1960, se kundërshtimi i një sistemi është një nga mënyrat për ta forcuar atë. Kjo dialektikë të kundërtash ka kaluar edhe tek vetë procesi europian që nga koha e projektimit dhe fillimeve të tij. Integritimi Europian i Shqipërisë nuk ka pse të bëjë përjashtim. Ai do të bëhej me siguri më i sukseshëm, më i shpejtë nëse do të shoqërohej me kritikën e tij. Kritika, pikërisht kritika e integritimit, kjo është e munguara e madhe e procesi të integritimit europian në peizazhin tonë politik dhe atë mediatic.

Për Marku Markun, pedagog në departamenti e Gazetarisë, arsyet janë më të thella, më strukturore.



*Kritikët në anët tona gjenden rrallë dhe aq më tepër kur bëhet fjalë për të kritikuar ndonjë gjë me Evropën. Edhe pse ne jemi përfshirë prej 90 në procesin e përfshirjes në BE ende nuk është krijuar një ide e qartë për strategjinë e përfshirjes, për hapat konkretë, për kushtet dhe standartet, për përfitimet dhe humbjet që do të kemi nga kjo përfshirje dhe kjo për shkak të mungesës së kritikës dhe debatit. Evropa dhe e ardhmja jonë të ne këtu po kocohej siç kocohej në kohën e komunizmit sistemi global komunist për të cilën as nuk e merrte mundimin kush të debatonte thjesht propagandohej pa i hyrë analizës.*

Por ndoshta kritikët e Integritimit janë, ekzistojnë, por ato nuk gjejnë dhe aq vend në media, ose media nuk i parapëlqen. I këtij mendimi është Adri Nurellari, master në studimet europiane dhe pedagog në Departamentin e Historisë. Ai drejton një shoqatë që quhet “Shoqata Libertariane Shqiptare”, anëtarët e së cilës debatojnë shpesh për integritimin. Kryesisht kritikojnë.

*Duke njohur median shqiptare une nuk pres që media shqiptare të adresoj çështje të tilla me syrin kritik, duke qenë se ky fakt nuk përputhet me axhendën politike që ka secili Tv apo gazetë. Çështja e integritimit evropian ka marrë formën e një tabuje jo vetëm tek media por në gjithë shoqërinë shqiptare. Në fakt i takon medias që të përcjellë tek publiku edhe ato forma kritikizmi që mund të hasen në shoqërinë shqiptare (si Shoqata Libertariane Shqiptare) duke zhbiruar qe ti gjej ata aktorë që do mund të bëjnë oponencën e të kenë kurajon qe ti shohin gjërat ndryshe.*

Por ndoshta është ende pretendim i madh të kemi në median shqiptare kritikën e procesit të integritimit. Të paktën të kemi analizën e tij. Kështu pyet kërkuesi Blendi Kajsiu.

*Çfare ndikimi ka integritimi ne procesin e shtetformimit shqiptar, cila është marrëdhënia midis integritimit dhe demokracisë, a ka përplasje apo mospërputhje midis të dyjave, si perceptohet, artikullohet, përkufizohet integritimi nga aktorë të ndryshëm. A ka alternativa të tjera? Shumë nga këto janë debate me vlerë që nuk zhvillohen, pjesërisht pasi integritimi ka marrë trajtat e një klisheje apo tabuje që sa më shpesh përdoret aq më pak analizohet në menyre kritike.*

Është e ditur. Nga të gjitha sondazhet dhe vëshgimet e vendeve të rajonit, shqiptarët janë popullsia me kuotat më të lartë pro – europiane. Ndoshta si një refleks që i përgjigjet izolimit komunist pro – europianizmi është një e pririje pa asnjë dyshim. Për Aldo Bumçi, lektor i shkencave politike në universitetin e Tiranës dhe kërkues në Institutin e Studimeve

Ndërkombëtare, të gjitha duken objekt i kritikës, po jo vetë integritimi.

Nuk ka kritikë ndaj procesit të integritimit në vetvete. Kritikë ka pasur për shembull për marrëveshjet e tregtisë së lirë që Shqipëria duhet të nënshkruante si pjesë e kushteve për marrëveshjen e Stabilizim asocimit të cilat u pane si të parakohshme nga një pjesë e biznesit shqiptar. Kritika të shumta ka pasur për paafesinë e qeverisë për të krijuar besimin e duhur se do të zbatonte marrëveshjet e ndërrmarra çfarë ka ngadalsuar procesin. Por besoj se debati publik për këtë çështje kohet e fundit ka pesuar një rritje në krahasim me periudhat e mëparshme dhe ky interes do të jete në rritje duke pasur parasysh se disa vende balkanike do të futen në 2007 në Bashkimin Euroipian, çfarë do të rrisë kërkesat në Shqipëri.

Vetë gazetarët e gjejnë evidente mungesën e kritikës së integritimit evropian.. Por ata ndahen në shkaqet e këtij fenomeni. Për ta, media nuk pasqyron veçse atë frymë që ekziston në shoqëri, në politikë, në qarqet intelektuale dhe shkencore: nëse atje nuk ka kritikë nuk ka dhe në media. Për analistin Mero Baze është pikërisht kjo:

*Nuk ka kritikë ndaj procesit të integritimit jo se këtij procesi realisht i mungon opozita, por se i mungon përmajtja. Askush nuk e di se çfare po bëhet me intrgimin dhe ku po na çon për ta kritikuar apo miratuar atë. Deri tani integritimi identifikohet me çështje vizash dhe lëvizjes së lirë. Asgjë më tej. Njësoj si kuptohet para tri katër vjetësh marrëveshja për Tregëti të Lirë si shans dhe jo edhe si detyrim. Pra nuk kemi ende oponencë se nuk kemi ende një projekt të qartë publik për integritimin. Kur ta kemi atë, kur ky projekt të jetë bërë pjesë e opinionit publik, natyrisht që do të kemi dhe oponencën e tij.*

Për Sami Nezën, kryeredaktor i METROPOL, një e përditshme e re pretencioze në tregun e medias shqiptare ka një diferencë mes lajmit dhe analizës dhe kritikës së procesit të integritimit.

*Lajmet mbi integritimin evropian të Shqipërisë në struktura evropaine janë të përditshme në shtypin shqiptar por vetëm në këtë kënd, duke iu shmangur apo duke mos i konsideruar problemet e BE-së. Shumë pak njerëz në Shqipëri dinë detaje mbi funksionimin e BE-së por ndërkohë flasin në mënyrë sociale lidhur me integritimin vendit të tyre në BE.*

Franko Egro, e shikon një prej arsyeve të mungësës së kritikës së procesit të integritimit tek vetë politizimi i medias

shqiptare. Pozicionimi sipas, tij, e zbeh kritikën dhe zhvlerëson atë.

*Analistet, gazetare jane pozicionuar ne llogore politike dhe nisur nga ky kendeveshtrim analizojne dhe komentojne gjithcka. Raporti i fundit tejet kritik i BE-se, nuk vuri perpara pergjegjesise askend. Gazetat shikonin gjithcka bardh – e zi. Nuk u analizua ne imtesi cfare arritjesh ka, sado te pakta te jene. Me tej kritikate nuk ishin asnjehere teknike dhe profesionale, por gjithnje politike. Debatet ne parlament ishte gjithashtu nje farse. Nuk u analizua nga asnje gazetar raporti ne imtesi, por edhe kur pati tentative ato ishin serisht sporadike.*

Edhe qeveria është e pakënaqur me kritikën që i bëhet procesit të integrimit. Për Edmond Harizajn, zëdhënësi i ministrisë së integrimit, kritika e këtij procesi është në të shumtën e saj pa përmbajtje

*Sic e thashë edhe më lartë, kritika e vetme ku eshte kapur "me thonj" media eshte data e mbylljes se negociatave. Ndërkohe që shumë herë më të rëndësishme janë reformat dhe implementimi i neneve te negociuara me Bashkimin European. Por kritikate dhe debatet, më shumë përdoren për të sulmuar politikisht, se sa për të ndihmuar realisht procesin e integrimit. E për fat te keq, ne kete rast, media behet nje prapavije e politikës dhe jo nje pararoje e integrimit*

## 5 - EUROPA E NDËRTUAR NGA MEDIA SHQIPTARE

Në fakt pa komunikimin e median, si të thuash pa një "vendim kolektiv" të pashkruar për të krijuar një identitet të caktuar, ne nuk do të kishim veçse një identitet fisnor, maksimumi atë të fshatit tonë, nuk do të kishim komb apo atdhe. Ajo që politologu francez Ernest Renan, përcaktoi për kombin si një "plebshin të përditshëm i një numri të madh njerëzish", do të mund të përshtatej edhe në rastin e identitetit European. Ndoshta nuk do të kishim një Europë në kuptimin e sotëm, ndoshta nuk do të kishim flamurin blu me 12 yjet në formë rrethi, nëse nuk do të kishte një "vendim" i popujve të Europës për t'u atashuar rreth një identiteti të ri.

Integrimi european është një "imagjinare", e cila ushqet vazhdimisht nga një makineri mediatike dhe politike. Në fund të fundit Europa është një ide dhe përfytyrim që i pergjigjet një lloji "identiteti european". Por a gjejmë në median median shqiptare programe, projekte, forma të "propogandimit" të Europës në sytë e qytetarëve, ose më saktë të ngulitjes dhe afrimit të ideve rreth integrimit tek lexuesi e shikuesi masiv. Përgjigja është: ende shumë pak.

Për Mark Markun, i cili ndjek rregullisht dhe analizon shtypin shqiptar prej vitesh ka vend për skepticizëm në rolin që

mund të luajë media në krijimin e ushqimin e idesë së "identiteti european"

*Kam përshtypjen se pjesa më e madhe e shqiptarëve as që vrasin mendjen nëse kanë apo jo një identitet evropian. Problemi për ta është i thjeshtë: Evropa të siguron atë komoditet dhe mirëqenie që e ëndërrojmë prej kohësh dhe që prej kohësh s'kemi bërë asgjë për ta siguruar. Evropa është sipas këtij konceptimi një "happy and" i jetës së tyre mizerabël. Me hyrjen në Evropë sipas kësaj logjike shqiptarët mendojnë se do t'i thonë lamtumirë jetës së tyre shqiptare dhe si me magji do të fillojnë jetën e tyre evropiane. Këtu siç shihet as që mund të bëhet fjalë për ndonjë projekt të propagandës identitare.*

Nëse media do të flasë më shumë për Europën këtë e kushtëzon edhe tregu. Për Alfred Pezën, kryeredaktor i gazetës Korrieri kemi një sitatë të kushtëzuar:

*Ato që bohën shpeshherë i vendosin drejtuesit e mediave nën presionin e tirazheve, duke i detyruar mediat që ta kanalizojnë punën e përditshme me ata pak gazetarë që kanë në dispozicion, tek mbulimi dhe pasqyrimi i sensacioneve të ditës, duke lënë mënjanë në këtë mënyrë, me dashje apo pa dashjen e tyre, punën për pasqyrimin e temave të tilla madhore siç janë ato për integrimin. Pasi këto çeshtje, nuk duken ende aq atraktive, kurioze apo të domosdoshme për lexuesit, në atë masë që të ndikojnë në tirazhet e gazetave apo revistave. .*

Për kërkuesin Blendi Kajsio, ka një lidhje komplekse mes imazhit që krijon media për Europën, integrimit dhe kritikës së tij, dhe në fund të fundit, qëllimit primar të çdo komuniteti politik: Mirëqenia dhe zhvillimi i vendit. Kjo e komplikon çështjen dhe në fund të fundit godet vetë qëllimin e integrimit.

*Ne zhvillohemi për tu integruar dhe jo anasjelltas. Shpesh te krijohet ndjesia se ne duhet t'i zhvillojme zgjedhjet e lira, te zbatojme ligjin dhe te luftojme korrupsionin ne menyre qe te integrohemi dhe jo sepse keto jane te mira ne vetvete. Ky keqkuptim eshte i rrezikshem sepse e zhvendos vemendjen nga ngjarjet apo parametrat e zhvillimeve te brendeshme drejt "ardhmerise integruese".*

"Ushqimi" i idesë së Europës nga media është akoma shumë larg kuotave të duhura. Alfred Peza, i korrierit vëren se

*Shembulli më kuptimplotë i mosperceptimit dhe mungesës së koshiencës mediatike në këtë fushë, ishte procesi i anëtarësimit të 10 vendeve të reja të ish lindjes komuniste në BE, ku ditën e zhvillimit të ceremonisë zyrtare të këtij evenimenti historik, vetëm njëra nga 18 gazetatat e përditëshme i kishte dhënë hapësirën e merituar, duke botuar një suplement prej disa faqesh. Ndërsa të tjerat, në mënyrë trishtuese nuk i kishin dhënë asnjë rresht ngjarjes ndoshta më të madhe, që pas rrëzimit të Murit të Berlinit në Europë.*

Shpesh është autoriteti publik apo vetë BE që financon dhe mbështet projekte, të cilat e bëjnë më të pranishme idenë e Europës në sytë e qytetarëve, në funksion të përgatjes së “qytetarëve europianë”, të cilët ta shohin botën pak a shumë njësoj, nga Portugalia deri në vendet Balltike, nga Irlanda në Qipro.

Ende janë të pakta këto programe dhe projekte. Media do të ishte mjeti më i mirë, si gjithnjë, për të ushqyer këtë imagjinare kolektive. Në fund të fundit të ardhmen europiane që e aspirojmë.

\*Ky kërkim është përgatitur nga pedagogu i departamentit të gazetarisë dhe komunikimit Henri Çili, në maj-qershor të vitit 2004, për llogari të Qendra Europiane dhe është publikuar për herë të parë në revistën "ANGAZHIMI EUROPIAN", botim i Qendrës Europiane, kryeredaktor Prof. Ass. Bashkim Gjergji



## ANALIZA E ANALISTËVE: SHËNIME PËR NJË SOCIOLOGJI KRITIKE TË ROLIT TË ANALISTIT

Besnik PULA\*

Në Shqipëri tashmë është etabluar profesioni i "analistit politik", mirëpo mbetet për t'u themeluar akoma kritika ideologjike dhe sociale e premisave mbi të cilat analistët ndërtojnë analizat e tyre. Kjo analizë e analistëve, një analizë sociale e aktivitetit të analistit që duhet të bëhet paralelisht me analizën e produkteve të tyre ideologjike, përbën njëkohësisht bazën për ndërtimin e një kritike të ideologjisë, kritikën e doksës dominante mbi të cilën është ndërtuar hegjemonia e re politike. E në këtë gërshetim strukturash analisti, zëri i të cilit paraqitet si i privilegjuar në komentimin e ngjarjeve politike, zë një pozicion të veçantë. Ky pozicion përkufizohet pikërisht nga roli kontradiktor që luan analisti në raport me fushën politike, atë gazetareske dhe atë intelektuale. Analisti nuk është politikan, mirëpo ai merret me politikën. Analisti nuk është intelektual, mirëpo ai kultivon imazhin e vetes si të tillë. Analisti ngarkohet me më pak punë sesa gazetari, mirëpo statusi social i tij është më i lartë se ai i gazetarit, ndonëse formalisht i përkasin të të njëjtës fushë. Dhe analisti, ndërsa përpiqet ta paraqesë zërin e një "qytetari të thjeshtë", nuk është fare i tillë. Pozicioni që gëzon analisti është pasojë e "privilegjeve" të akumuluar shoqërore, në radhë të parë një akumulim i caktuar i kapitalit kulturor dhe shoqëror nga të cilët janë privuar kategori të tëra shoqërore, dhe jo një pozicion shoqëror që ai e okupon si pasojë e rrethanave dhe rastësisë. Analisti flet "në emër të publikut" ose "për interesin e publikut" vetëm pasi të jetë arritur shkëputja e tij nga eksperiencia sociale e mesatares së publikut, pasi ai të jetë ngritur në rangun e një publicisti me të drejtë fjale, autoriteti i të cilit autorizohet nga instancat dominante të sferës publike (redaksitë, pronarët e medimeve etj.).

Aktiviteti kryesor i analistit është polemika, ndërsa mediat janë arena kryesore e realizimit të aktivitetit polemizues. Çdo gazetë sot ka një seksion të veçantë për "analizën" (faqet e rezervuara për editoriale dhe opinione), ndërkohë që në treg ekzistojnë publikime të veçanta që mision qëndror kanë botimin e polemikave, të kuptuar si një zhanër i veçantë shkrimi autorial i cili objekt ka komentimin dhe gjykimin e ngjarjeve politike, dhe si pasojë, marrjen e një pozicioni politik nga autori. Edhe në

televizion, përkundër asaj që zhanri i prezantimit të editorialeve redaksionale gjatë programit të lajmeve ka dalë mode, formati i emisioneve polemizuese, me një apo më tepër të fluar, është i pranishëm kudo. Në rastin e emisioneve televizive polemizuese mund të përrjashtohen rastet kur në këto emisione ftohen politikanë - interesi i politikanit është tjetër nga interesi i polemizuesve jo-politikanë, pasi investimet dhe interesi që ata kanë në fushën politike dhe mediatike janë krejt të ndryshme. Objekt i këtij shkrimi janë këta të fundit, pasi politikanët polemizojnë njëri me tjetrin dhe kështu pozicionohen politikisht njëri karshi tjetrit dhe karshi pushtetit, ndërsa polemizuesit jo-politikanë polemizojnë me politikanët pa qenë vetë të tillë.

Një sociologji e fushës së polemikës, si një nënfushë e veçantë e aktivitetit gazetaresk do të nxirrte në shesh objektivitetin e polemikës si aktivitet, duke ekzaminuar në radhë të parë raportin e forcave simbolike (të repertuareve zakonisht të pabarabarta retorike, kulturore, biografike, institucionale dhe politike të cilat mund të mobilizohen dhe vihen në përdorim nga polemizuesi) midis polemizuesve dhe aktorëve në fushën politike, midis tyre dhe gazetarëve, dhe midis polemizuesve të ndryshëm. Si aktivitet intelektual, objekt themelor i polemikës është kapja (sado momentale) e monopolit mbi definimin objektiv të "realitetit politik" dhe, si hap i dytë, dhënia e "diagnozave" dhe "analizave" që shpjegojnë raportet shkak-pasojë në fushën politike. Në esencë, kuptimi i problemeve politike ka të bëjë me zbulimin e defekteve morale dhe kulturore që i dalin në rrugë projektit (për çfarë besohet të ekzistojë një konsensus i përgjithshëm shoqëror) që thërret në veprim fuqinë e shtetit që të transformojë strukturat shoqërore që pengojnë lëvizjen drejt arritjes së synimeve kolektive, synime që zakonisht identifikohen nga terma jo gjithmonë përmbajtësorë por me një efikasitet të jashtëzakonshëm simbolik (p.sh. "evropianizimi", "demokratizimi", "tranzicioni", "integrimi", "sundimi i ligjit" etj.).

Në veprimtarinë e tij polemizuese, analisti gëzon një pozicion të veçantë brenda fushës gazetareske dhe asaj politike. Ky pozicion është i veçantë pasi për analistin, aktiviteti polemizues nuk është një aktivitet i përkohshëm apo i rastit, por një një aktivitet profesional, në kuptimin e një aktiviteti që ushtrohet rregullisht dhe kundrejt një shpërblimi financiar (honorarit apo, në rast më të privilegjuar, rrogës). Në krahasim me gazetarin, e drejta e të cilit kufizohet në pretendimin për paraqitjen objektive të ngjarjeve dhe fakteve, analistit i jepet licenca e veçantë për shtjellimin e një metadiskursi politik (që do të thotë se përmes këtij diskursi analisti pretendon të vendoset mbi politikën), të interpretimit të ngjarjeve në fushën politike dhe shtruarjen e tyre në një plan moral, e vlerësimit të tyre në raport me "interesat jetike", "aspiratat historike", "vlerat themelore" apo "qëllimin përfundimtar" të bashkësisë së gjerë politike, siç interpretohen ato nga analisti. Në këtë rol, analisti evokon parimet etike të fushës politike, duke e mbivendosur moralin publik si bazë e akteve politike, një privilegj nga i cili politikani është i privuar për shkak të balancimit të vazhdueshëm që ai apo ajo duhet të bëjë duke konstruktuar barazvlera midis interesave të veçanta dhe potencialisht kontradiktore të grupeve të ndryshme të interesit dhe, si

\* Besnik Pula është kandidat për gradën doktor pranë Departamentit të Sociologjisë të Universitetit të Aftësisë (SHBA). Ka mbaruar MA në shkencat politike dhe studimet evro-lindore në Universitetin Georgetown kurseku diplomuar në shkencat politike në City University of New York, SHBA. Interesimet e tij studimore lidhen me kolonializmin, nacionalizmin dhe sociologjinë e dijes. Studimi i tij i doktoraturës është mbi shpërndarjen në Shqipëri në periudhën 1919-1939, punim për të cilin po bën hulumtime arkivore pranë Arkivit Qendror të Shtetit në Tiranë me mbështetjen e bursave Fulbright-Hays dhe IREX.

pasojë, duke ndërmarrë veprime domosdoshmërisht të (një)anshme.

### ANALISTI SI ASPIRANT PËR ROLIN E INTELKTUALIT

Ajo që është fasinuese për kontekstin post-socialist, është fakti që roli publik i analistit ka marrë përmasa të tilla që ai pothuaj ka zëvendësuar rolin që dikur rezervohej për intelektualët (një zhvillim që ka paralelet e veta edhe në vendet perëndimore, ku intelektualit e ka gjithnjë e më të vështirë paraqitjen në sferën e gjerë publike). Për këta të fundit, marrja e së drejtës për dhënie e fjalës publike fitohet vetëm pas akumulimit të autoritetit përmes punës shkencore apo artistike, e tillë që vlerësohet në bazë të kriterëve të fushave të specializuara të krijimtarisë intelektuale, që në kushtet ideale, kanë një shkallë të caktuar autonomie dhe distance nga fusha politike dhe ajo ekonomike. Në qoftë se marrim për bazë përkufizimin elementar të intelektualit të angazhuar publik, sic e ka dhënë Sartri, si personi i cili merr përsipër përgjegjësinë e marrjes së qëndrimeve publike me karakter politik, por pa hequr dorë tërësisht nga aktiviteti artistik (p.sh. letërsia) apo shkencor (p.sh. hulumtimi), atëherë shohim se si analisti i sotëm është i liruar tërësisht nga barra e dëshmisë së punës intelektuale karshi një audience të specializuar specialistesh (atë të kritikëve të krijimtarisë artistike apo të komunitetit shkencor). Në vend të kësaj, kemi një proces në dukje mistik, që analistit i lejon pozicionimin si intelektual, por jo në mënyrën e mundimshme të ngritjes në hierarkinë e gradave të sanksionuara nga sistemi arsimor, sepse analisti arrin deri te marrja legjitime e fjalës publike duke anashkaluar autoritetin e sistemit të lartë arsimor (gjithsesi jo plotësisht, meqë edhe analisti ndjen nevojën e legjitimitetit të diskutit të tij duke u mbështetur në grada universitare). Bazament i këtij ndryshimi historik nuk është ndonjë aftësi e veçantë personale e analistit, por oportunitetet e krijuara si pasojë e ndryshimeve të thella në strukturën e institucioneve mediatike (me thyerjen e monopolit shtetëror mbi prodhimin mediatik dhe formimin e tregut mediatik) dhe në delegjitimimin e prodhimtarisë intelektuale për shkak të implikimit të një pjese të madhe të saj me regjimin e vjetër. Në vend të punës për prodhimin e njohurisë shkencore (çfarë mund të jetë puna e shkencëtarit), apo e krijimtarisë artistike (sikur e shkrimtarit apo artistit), apo të informatës (siç është puna e gazetarit), aktiviteti i analistit përqëndrohet në radhë të parë në polemikën, pra, në ruajtjen e një qëndrimi polemizues karshi ngjarjeve politike, të çfarëdo natyre qofshin ato.

Karshi intelektualit që pretendon dije të specializuara, dhe i cili mund të mobilizojë në mbështetje të aktivitetit polemizues autoritetin shkencor, analisti pretendon një pozicion monopolizues të njohurisë specifikesht politike, e cila, sipas rregullave të fushës gazetareske, ka të bëjë kryesisht me zotërimin e kapitalit informacional, të njohjes së zhvillimeve më të fundit në qarqet politike, sidomos ngjarjet e "mbrapaskenës" të cilat analisti,

përkundrejt gazetarit, gëzon legjitimitetin e transmetimit. Mirëpo, analisti nuk mund t'i ikë raportit të dominuar që ai ka karshi fushës intelektuale, sepse bazë e gjykimeve të ngjarjeve politike dhe tentativës për të ndërhyrë në debatin politik të momentit (qoftë ai dënimi i "korrupsionit" apo denoncimi i një akti politik si dhunues i "vlerave demokratike"), janë gjithmonë kutet morale dhe ideologjike të përvetësuara nga fusha intelektuale, me të cilën analisti gjithnjë ruan një raport të zhdrejtë.

### POLITIKANI PA PORTOFOL

Analisti në radhë të parë synon një rol politik, edhe pse pa interes të drejtëpërdrejt politik, që e bën analistin një fetisht të politikës. Por nga aspekti social, pozicioni dukshmërisht kontradiktor i analistit, ai që gjendet, në dukje, edhe brenda edhe jashtë politikës, që është kritik ndaj politikës por gjithmonë i afërt me institucionet dhe, jo rrallë edhe me protagonistët e fushës politike, e shndërron veprimtarinë e analistit në një politikë surrogate dhe vetë analistin në një politikan surrogate - diçka që, figurativisht, mund të quhet politikan pa portofol. Kështu, raporti që analisti ka me politikën është në disa pikëpamje analog me atë të artistit në fushën artistike. Në fushën artistike konsiderohet si një artist "puro" ai që krijimtarinë e tij nuk e bën direkt për tregun, por në frymën e l'art pour l'art (artit për hir të artit), ku parimet vlerësuese i vendosin artistët e tjerë dhe kritikët e artit dhe jo shija e publikut të gjerë apo vlera komerciale e veprave. Në një situatë të ngjashme gjendet edhe analisti, në raport me fushën politike. Veprimtaria e analistit ka si parim themelor një ideal të politikës që bëhet për hir të vetë politikës - politikës, kuptohet, të reduktuar në një aktivitet polemizues, një "debat" të përhershëm dhe të papërfunduar sepse është ndërtuar mbi premisa që kërkojnë që ai të jetë i papërfundueshem, një dramë e përhershme ku zhvillimet në dukje çojnë gjithmonë në përsëritjen e dramës (në këtë frymë mund të kuptohet dukuria e zakonshme e shpjegimit të realitetit post-socialist shqiptar si të një "tranzicioni" pa fund).

Nga pozicioni social, thellimi i analistit brenda strukturave politike, pa pjesëmarrje zyrtare në to, e bën atë pjesëmarrës në mirëmbajtjen dhe në legjitimimin e tyre. Në esencë, analisti nuk ka si objekt analizën në kuptimin e zbërthimit të gjendjes politike, të zbulimit të relacioneve reale politike dhe të interesave shoqërore që shprehen në fushën politike (diçka që, paradoksalisht, imponon një shkëputje nga rrjedhat e fushës politikës), por ai ka analizën si mjet për arritjen e efekteve imediate politike. Kështu, roli i pretenduar si kritik dhe denoncues i politikës (p.sh. denoncuesit të "korrupsionit" të zyrtarëve dhe politikanëve të caktuar, i skandaleve të ndryshme, i kundërshtimit ose përhëndetjes së masave të caktuara etj.) përbën metodën përmes së cilës, analisti synon në radhë të parë legjitimitetin publik për veprimtarinë e tij si veprimtari që bëhet për publikun dhe në emër të tij, me analistin si përfaqësues të publikut. Për më tepër, analisti

synon, përkundërpretencës për njohuri mbi mesetaren për ngjarjet e ditës në politikë, kultivimin e imazhit të tij si një "qytetar i zakonshëm". Kjo strategji e prezantimit të vetes (Goffman 1959) arrihet kryesisht përmes formave gjuhësore që nxjerr në përdorim analisti, pra me denoncimet dhe sulmet që kryen ai kundër politikës, jo rrallë duke përdorur një "gjuhë popullore", me një fjalë, duke denoncuar apo aplauduar politikën në mënyrën që atë do ta bënte ky i ashtuquajtur "qytetar i zakonshëm" i fantazisë ideologjike të analistit (që sidoqoftë është një konstrukt kulturor dhe jo krejt personal i analistit). Sigurisht se rreth formave të prezantimit të vetes, ekziston një rivalitet në mes të analistëve, duke e përfaqësuar veten në rangun e "ekspertit" (p.sh., ata analistë të lidhur me institute të ndryshme studimore, të cilat jo rrallë i udhëheqin vetë), kush të "intelektualit të pavarur" (analistit që vepron si një "free agent", pa lidhje me një institucion të caktuar), kush në rangun e "njeriut popullor" (njerëz që për t'u diferencuar nga "elitistët" dhe për të maskuar pjesëmarrjen e tyre brenda elitës, theksojnë origjinën e tyre të ulët sociale, biografinë e përndjekjeve të mëherëshme etj.).

#### ZËDHËNËS APO ZËVENDËS I PUBLIKUT?

Çdo analist ndërton identitetin e vet personal dhe profesional në kundërshti me imazhin e "qytetarit indiferent", ndërsa në këtë mënyrë analisti projektton premisat sociale dhe ideologjike të rrethit të tij social (analistë të tjerë, gazetarët, politikanët etj.) mbi gjithë shoqërinë, duke ndërtuar dhe imponuar përmes vetë formës së diskutit të tij idealin e qytetarit kritik, të qytetarit publik që është përherë në mbikqyrje të veprimtarisë së shtetit dhe i informuar mbi problemet e shoqërisë. Analisti kështu, në njëfarë mënyre, imponon veten si qytetarin ideal dhe gjuhën e tij si gjuhë ideale politike, por përmes kësaj, ai siguron se do të ngelen jashtë debatit ato segmente të shoqërisë që kanë interesa reale në vendimet e caktuara politike, por që nuk i njohin finesat e diskutit dominant politik ashtu siç i njeh analisti, pra nuk kanë "licencë" të duhur për t'u përfshirë në debat (nuk kanë njohje të mjaftueshme të ngjarjeve politike, janë më të dobët në zotërimin e gjuhës etj.). Në të njëjtën kohë, duke ruajtur një distancë nga segmentet dhe klasat shoqërore me interesa të caktuara, dhe duke e paraqitur veten si një individ krijues (ngjashëm me një artist apo krijues intelektual), analisti afirmon pozicionin e tij si një pozicion etik dhe mbipolitik. Mirëpo pikërisht përmes refuzimit të kategorizimit të tij politik (që nuk duhet medoemos të jetë një pozicionim partiak), analisti arrin dhe efektin më të madh politik, arrin që diskutin e tij ta paraqesë si një diskurs të pastër moral, të pa-ideologjizuar dhe të pa ngarkuar politikisht, një gjuhë të pastër "vlerësuese" dhe "gjykuese". Dhe përmes pretendimit se gjuha e tij është një gjuhë neutrale e vlerësimit dhe denoncimit, analisti krijon dhe atë iluzion të nevojshëm për ta kultivuar imazhin si përfaqësues i zërit publik. Mirëpo zëri i analistit është një zë

paradoksal, sepse ai jepet në emër të publikut, por vetë analisti distancohet nga publiku dhe nga cilido sektor i organizuar shoqëror që ka interesa reale të përfaqësimit politik (p.sh. sindikatat, grupet ambientaliste, shoqatat e pronarëve apo të biznesit etj.). Me një akt të këtillë, analisti vazhdon ta kultivojë imazhin e një vëzhguesi mbi-politik, përderisa ky imazh përforcohet edhe si ego-imazh (apo ego-ideal në terminologjinë freudiane) që i reflektohet nga roli që ai thirret ta luajë nga mediat - pra pikërisht rolin e "analistit të pavarur" që vëzhgon politikën i pa lidhur me asnjë forcë shoqërore. Kështu, analisti i bindet ideologjisë dominante mbi rolin e tij, e nuk e sheh se ky rol është në fakt efekt i strukturës, të cilës ai i përket. Përkritazi me rolet, sociologët e dinë se roli nuk është rezultat thjesht i një vetë-zgjedhjeje apo voluntarizmi të pastër, por marrje përsipër e një detyre të ngarkuar nga të tjerët, dhe veprimtaria e të cilës sanksionohet dhe legjitimohet përmes një të drejte (jo medoemos në formë legjislativë) të dhënë nga kolektivi. Siç e ilustron rrëfimi legjendar i Pascal-it, Mbreti nuk sundon sepse është i dërguari i Zotit, ai sundon sepse të sunduarit besojnë se Mbreti është i dërguari i Zotit, pra, ajo që paraqitet si mandat nga Zoti është në realitet mandat nga të sunduarit për të qenë të sunduar. Roli i analistit mund të kuptohet në mënyrë analoge si një rol shoqëror, pra një rol i sanksionuar nga kolektivi (ndonëse kryesisht ai i ngushti mediatic, dhe jo nga "publiku" në kuptimin e gjerë të fjalës), rol të cilin personi i analistit ftohet për ta ekzekutuar sipas një ideal-ego-je të caktuar (të ideologjisë dominante mbi atë se çfarë duhet të bëjë një analist, të analistëve që merren si shembuj për formimin e rolit etj.). Roli, kështu, i paraprin në kohë aftësi dhe njohurive personale të analistit, në të njëjtën kohë duke ia kushtëzuar ato.

Në konfiguracionin e sotmën institucional, në gjendjen e sotme "strategjike" në mes të fushave përmes së cilave kryhet dominimi (institucionet politike, ekonomia, mediat, të gjitha të lidhura në një qark gjithnjë e më të konsoliduar), në të cilin ekziston një ndërvarshmëri e thellë në mes të politikës dhe mediave, dhe si rrjedhojë e ekonomisë dhe politikës, roli i analistit sot është shndërruar në rol kyç për racionalizimin dhe përligjen e dominancës të strukturave politike, të legjitimitit të vendimeve të caktuara politike, të arsytimit të përjashtimeve (shpesh të padallueshme) që bëhen në fushën politike dhe në procesin e vendimmarrjes në politikë. Analisti, që asnjëherë nuk konteston rolin që ka në riprodhimin e strukturave dhe të diskutit dominant (diskursit të prodhuar nga po ata prej të cilëve analisti synon të distancohet dhe t'i kritikojë, por nga i cili mbetet përherë në varësi), shërben jo si zëdhënës i publikut, por si zëvendës i tij. Në vend të të qenit zëdhënës i publikut karshi pushtetit, analisti në realitet funksionon si zëdhënës i pushtetit karshi publikut, pasi zëri i tij përbën mbyjtjen e zërit publik, mbyjtjen e një debati të vërtetë ku vlerë parësore ka zëri i një qytetari anonim ("të zakonshëm", siç cilësohet në gjuhën gazetareske) dhe jo ai i një personazhi publik

me detyrën e moralizimit të politikës.

Po përse analisti është, në njëfarë mënyrë, zëdhënës i pushtetit? Meqë ka kohë që politika jonë është "de-ideologjizuar" (p.sh. politikanët nuk merren dhe nuk botojnë trakte politike, pushtetarët nuk ndjejnë obligimin e shpjegimit dhe përligjes së vendimeve të tyre para publikut, programet politike të partive nuk vlejnjë si pika reference në vendimet politike, instancat ndërkombëtare, që caktojnë kahet e politikave kryesore shtetërore, trumpetojnë një ideologji në dukje të pastër teknokratike etj.), këtë mangësi të fushës politike e mbush analisti, i cili përmes diskursit të tij mbush boshllëqet ideologjike që mbetën nga veprimtaria politike e pushtetit. Këtë, analisti e arrin përmes pjesëmarrjes në ushtrimin e një "diktature të aktualitetit", ku një ngjarje politike është e rëndësishme jo për shkak të peshës reale shoqërore që ka, por për shkak të rëndësisë që asaj i jep komuniteti auto-referencial i organizatave mediatike, i centralizuar siç është në hapësirën gjeografike (duke qenë tërësisht i përqëndruar në kryeqytet) por edhe në hapësirën sociale (duke qenë i afërt dhe duke kultivuar marrëdhënie me strukturat politike që pretendon t'i vëzhgojë në mënyrë kritike, duke qenë i hapur për lëvizje kuadrosh nga një organizatë mediatike në tjetrën, por edhe nga organizatat mediatike në politikë dhe anasjelltas). Analisti që devijon nga kjo normë e fetishizimit të ngjarjes më të re politike dhe nuk pranon t'i nënshtrohet mendimit të tufës (group think) që ai detyron, sanksionohet nga vetë bashkësia mediatike, në radhë të parë duke u përjashtuar nga privilegji i fjalës publike që ajo ia jep. Në të njëjtën kohë, kjo formë disiplinimi shoqëror siguron që "zëri heretik", ai që mund të marrë analisti karshi zhvillimeve të caktuara, mbetet gjithmonë i parashikueshëm (dhe, deri dikund, i kontrollueshëm), duke e lënë atë të veprojë si një zëvendësim për herezinë e vërtetë politike, atë që Agamben (2005) do ta quante një akt të vërtetë politik.




Fig. 1. Skema e dikotomive themelore që organizojnë diskursin e analistit. Kjo skemë dikotomish bëhet e efektive kur i mbivendoset një kahjeje imagjinare kohore që duhet ta ketë "tranzicionin" i Shqipërisë, ndërsa ky tranzicion përshkruhet nga analistët të ketë

ngecur në një pikë të palëvizshme, ashtu që skema ekzistuese e dikotomive bëhet përherë valide dhe asnjëherë e tejkalueshme.

### STRUKTURA FORMALE E DISKURSIT TË ANALISTIT

Diskursi standard që vihet në përdorim nga analistët ndërtohet mbi një sërë dikotomish përjashtuese me një efikasitet të fuqishëm simbolik (shih fig. 1). Siç dëshmon Sulstarova (2006), këto dikotomi kanë një histori të gjatë në diskursin politik dhe kulturor shqiptar, gjë që shpjegon edhe qëndrueshmërinë e tyre dhe forcën retorike që ato kanë edhe sot (dhe duke qenë në radhë të parë një retoricien, analisti duhet të mobilizojë mjetet retorike që prodhojnë efektet më të fuqishme të lexuesit - prandaj dhe dikotomizimi i ekstremeve është një strategji normale). Ndërkaq, termi që mbulon në formë gjithpërfshirëse gjithë periudhën historike nga pëmbysja e regjimit komunist është ai i "tranzicionit", një tranzicion që ka një fillim por fundi i të cilit duket pothuaj përherë i paarritshëm. Përkundrazi për këtë arsye, tranzicioni duket gjithmonë të ketë ngecur në një pikë (përkundër kalimit të kohës), ngecje që shënohen nga kriza apo skandali i radhës që ka mbërthyer skenën politike. Në këtë mënyrë, ngelja e realitetit politik midis dy pikave të pabashkueshme i jep efikasitet simbolik skemave dikotomike, sepse efekti simbolik i shënjesve është më i fuqishmi kur ato ngelin në nivelin e dëshirës, e aspiratës, e jo në shënjimimin e një realiteti konkret. Siç thotë Lacan, paradoksi i dëshirës është se synon jo arritjen e një objekti, por riprodhimin e vetes - pra objekti i dëshirës duhet, në një mënyrë, të jetë i paarritshëm. Rrjedhimisht, sikur Shqipëria vërtetë të bëhej perëndimore, kosmopolitane, moderne, "evropiane" etj., nuk do t'i ngelej asnjë aspiratë, asnjë raison d'être. Logjika e dëshirës është mekanizmi tjetër që siguron efikasitetin e strukturës së dikotomive të përshkruara më sipër - ato, në ekzistencën e tyre diskursive, përbëjnë domosdoshmërisht një ecje në rreth, të domosdoshme sepse mundësojnë shmangien e një krize ekzistencialiste në të cilën do të cilën do të futej e gjithë shoqëria.

Në të njëjtën kohë, për analistin, pika e referencës nuk është realiteti i vërtetë social, por një model ideal i sistemit politik që ai ka parasysht, që po të ndiqej me përpikmëri nga aktorët politikë, nuk do të prodhonte fërkimet e vazhdueshme që vëzhgohen në fushën politike. Edhe ky sistem ideal politik, nuk është ndonjë model i caktuar teorik që ka parasysht analisti (një koncept i artikuluar mbi demokracinë liberale etj.), por zakonisht mbështetet mbi thirrjet që kanë për referencë Perëndimin, atje ku, të krijohet përshtypja se as muti s'ka erë, meqë gjithçka funksionon sipas parashikimit, sipas planit dhe kontrollit të përkryer që ushtron pushteti mbi shoqërinë dhe anasjelltas. Kjo thirrje "në Perëndimin", apo, thënë më saktë, "në Tjetrin", është veçse një zëvendësim për vlerësimin e vërtetë kritik të situatës, duke ilustruar se ajo që plasat nëpër media nën firmën e "analizës" është, në radhë të parë, një konstrukt formulaik. Kjo formulë në instancë të



fundit mbështetet mbi justifikimin, e ndërtuar më shumë mbi një fantazi ideologjike se sa në një njohje empirike, se "atje [pra, në Perëndim] nuk bëhet kështu" dhe kjo shërben si argumenti përfundimtar se ngjarjet apo praktikatat në Shqipëri kanë trajtë të papranueshme.

Në anën tjetër, papërmirësueshmëria e pushtetit, skandalet dhe abuzimet që vëren analisti, nuk merren si probleme politike, por si çështje që kërkojnë racionalizime dhe interpretime të një rendi tjetër. Dhe në këto raste problemet zakonisht paraqiten si probleme me burime kulturore (shih figurën 2). Momenti i kalimit në rrafshin e shpjegimeve kulturore përbën edhe fundin e "analizës politike", ngaqë rrafshi kulturor, i papërcaktushëm dhe amorf nga pikëpamja teorike, i konstituuar nga një pseudo-antropologji mbi esencën e "qenies shqiptare" ("identitetit" në gjuhën e diskursit dominant), shërben si një repertoar që pëmban instrumente që mund të vihen në përdorim për të shpjeguar çdo dukuri (shih figurën 2). Nuk është çudi atëherë që denoncimi më i fuqishëm i politikës është pikërisht denoncimi kulturor, denoncim i një kulture që besohet ta ngërthejë politikën dhe të jetë elementi përbërës themelor i saj. Në një perversion të çuditshëm të marksizmit ortodoks, në të cilën ekonomia përbën strukturën mbi të cilën ndërtohet superstruktura e institucioneve politike, analisti kulturor sheh të keqen tek struktura kulturore e cila shihet si përgjegjëse për prodhimin e imperfeksioneve në superstrukturën politike. Si pasojë, edhe debatet më të ashpra lidhen pikërisht me problematikën e kulturës (si nocion i gjerë), e arritur kjo përmes abstraktimit të kulturës si një entitet i veçantë nga politika, thuase kemi të bëjmë me dy objekte të ndryshme, e jo një dallim historik në mes të instancave ose fushave të ndryshme, dallimi në mes të cilave është vetëvetiu një produkt historik i pushtetit ('pouvoir' në kuptimin Foucault-ian të termit). Dhe kjo është arsyeja pse debatet kulturore shpesh arrijnë në pikën e ripërtëritjes së modeleve totalitare të mendimit, me gjithë kontradiktat e tyre - politika e keqe është produkt i kulturës së keqe, e për ndreqjen e kulturës së keqe kërkohet ndërhyrja politike. Qarku ideologjik kështu i afrohet strukturës formale të fashizmit, i cili kërkon një Sundimtar të Fortë që me vullnetin e tij të çeliktë të kthejë gjërat në vend të vet.




Fig. 2. Raporti standard kauzal që shfaqet në diskursin e analistit. Ky raport bazohet mbi ndarjen klasike platonike të rrafshit të

shfaqjeve (fenomenon) dhe atij të shkaqeve (noumenon), që në diskursin e analistit merren si të barazvlefshme me rrafshin e kulturës dhe të politikës. Në këtë konceptim, që përbën premisën gjysëm të vetëdijshme apo edhe të pavetëdijshme teorike mbi të cilën ndërtohet diskursi i analistit, kultura funksionon si një substrat mbi të cilën ndërtohet ngrehina politike, prandaj edhe shkaqet fundamentale gjithmonë i përkasin rrafshit të kulturës. Në të njëjtën kohë, edhe forca e denoncimit ndjek në drejtim të kundërt vijën e kauzalitetit - sa më të thella shkaqet, aq më i fuqishëm është denoncimi që analisti ia bën situatës. Për ta siguruar forcën e denoncimit, denoncimet kulturore shpesh ndiqen edhe me përfshirjen e vetë analistit në denoncim ("ne jemi të këtillë", "ne nuk meritojmë më mirë" etj.), ku analisti nuk ngurron që në emër të saktësisë dhe gjithpërfshirësisë së "analizës" të shpreh edhe vetë-urrejtje.

## DISKURSI HISTERIK DHE KËRKESA E TJETRIT

Pozicioni ortodoks - dhe, si pasojë, konservator - i cili adoptoi analisti i imponohet atij, nganjëherë pavarësisht dëshirave të tij. Analisti, si çdo autor tjetër, nuk e thotë "atë që dëshiron", apo në një rrafsh ku dëshira e tij realizohet në mënyrë krejtësisht karteziante dhe autonome. Diskursi i analistit nuk ka referenca arbitrare dhe krejt subjektive por objektive dhe ndërsubjektive, ai i referohet një "realiteti politik" jashtë vetes së tij, realitet i cili vihet para interpretimit të analistit dhe që ai i jep kuptim përmes aktit interpretues. Dhe këtë interpretim ai ia ofron një lexuesi ose dëgjuesi, një konsumatori të veprës së tij. E kjo domethënë se analisti gjithmonë shkruan për kënaqësinë e një Tjetri, simpatinë dhe pranimin e të cilit e synon, mbase edhe në mënyrë të pavetëdijshme. Diskursi i analistit kështu i ngjan diskursit të histerikut (siç e përkufizon atë Lacan), pasi që analisti, sikur histeriku, e ofron veten si objekt për kënaqësinë e Tjetrit, apo, më saktë, e ofron diskursin e tij si objekt për kënaqësinë e Tjetrit. Në diskursin e tij ai projektton Tjetrin, lexuesin dhe konsumatorin e produktit ideologjik të tij, nevojën për dije politike të të cilit ai do ta plotësojë me diskursin e tij. Siç argumenton Fink (1995), një veçori e neurozës sipas interpretimit lacanian është pikërisht ajo se neurotiku ngatërron dëshirën e Tjetrit me kërkesën e tij. Analisti kështu nuk shkruan e thotë "atë që dëshiron", por, paradoksisht, atë që Tjetri kërkon nga ai.\* Siç shkruan Zizek: "përkritazi me çdo 'luajtje të rolit', pyetja është: për kë subjekti po e luan këtë rol? Soditja e cilit merret parasysht kur subjekti identifikon veten me një imazh? Kjo zbrastësi midis mënyrës që unë shoh veten dhe pika nga e cila shikohem për të qenë i pëlqyeshëm për veten është kyçe për kuptimin e histerisë" (1989: 106). Dëshira e analistit kështu është që veten ta shoh si të pëlqyeshëm nga lexuesi/dëgjuesi, i cili në esencë mbetet një konstrukt i fantazisë së analistit dhe jo një person konkret empirik.

Dhe pikërisht përmes konstruktimit të këtij konsumatori si një subjekt të padijshëm, atë figurë stereotipike injorante dhe të

pashije që duhet të përfaqësojë "popullin" (kuptohet, shënjeshtër "popull" gjithmonë përdoret për të aluduar në shtresat më të ulta shoqërore), analisti mbron veten nga paraqitja e vetes si i dalur nga normat e përgjithshme politike, ato norma të cilat garantohen nga ekzistenca e pokëtij Tjetri. Ky Tjetri i padijshëm, i pashije dhe konservator i fantazisë ideologjike të analistit (përfaqësuesi i "popullit", konsumatori i produktit ideologjik të analistit) kështu paradoksalisht ia imponon analistit kufijtë e gjuhës së tij, sepse analisti, për të aritur efektin e dëshiruar retorik, pohon qëndrimin e tij në pritje të reagimeve të Tjetrit, duke i paramenduar dhe llogaritur ato reagime paraprakisht në regjistrin e tij imagjinar. Gjuha e analistit kështu kufizohet nga Tjetri, me një fjalë, Tjetri ia imponon kufijtë e diskutit, normat e saj të paterkalueshme, norma që në vetëvete bëhen të padiskutueshme. Ndërkaj, këto norma përcaktojnë kufijtë e diskutit analitik mbi politikën, apo, nëse mbështetemi në terminologjinë e Bourdieut, doktrinën e saj klasifikuese - pozicionet ortodokse dhe heterodokse në fushën politike, pozicionet konservatore dhe heretike, një diskutim i mbyllur ku intervenimet nga jashtë janë çenuese dhe të papranueshme.

Larg të qenit një autor origjinal, vetë kushtet e pjesëmarrjes në aktivitetin që ai bën e detyrojnë analistin që të jetë i varur nga strukturat dominante diskursive dhe kategoritë formale të mendimit që imponojnë ato, sepse ai i përdor ato në konstruktimin e diskutit të tij, e siç dihet, kategoritë dhe konceptet e mendimit (siç janë ato të pashmangshmet e kohës sonë, p.sh. "demokracia", "korrupsioni", "Evropa" etj.) nuk janë struktura neutrale gjuhësore, ato mendojnë të menduarën për subjektin, apo, thënë më shkurt, ato ia sigurojnë subjektit rehatinë e konformizmit dhe të mosmenduarit. Me përdorimin e lirshëm të kategorive dominante nga analisti, kategori që merren si të mirëqena, të natyrshme dhe transparente, lexuesi ftohet për të marrë pjesë në një ritual ku do të konfirmojë paragjykimet e veta mbi ndodhitë dhe kahjen e gjërave dhe viktimizimin e pashmangshëm që ato prodhojnë. Dhe pikërisht këtu qëndron konservatorizmi radikal i analistit - jote diskutimi i manifestuar i tij, te përmbajtja formale e tij (qëndrimet politike që merr etj.), por në riprodhimin jokritik të kategorive të mendimit që janë produkte të vetë strukturave të pushtetit. Analisti, ai që paraqitet në rolin e kritikut më të madh të pushtetit, kështu paradoksalisht bëhet operatori më efikas i

hegemonisë së tij.

## BIBLIOGRAFIA

**Agamben, Giorgio. 2005.** State of Exception. Chicago: University of Chicago Press.

**Bourdieu, Pierre. 1984.** Distinction: A Social Critique of the Judgment of Taste. Cambridge: Harvard University Press.

**Bourdieu, Pierre. 1985.** "The Genesis of the Concepts of Habitus and Field." Sociocriticism, Vol. 2, Nr. 2, fq. 11-24.

**Bourdieu, Pierre. 1993a.** "Some Properties of Fields," në Bourdieu, Sociology in Question. London: Sage Publications.

**Bourdieu, Pierre. 1993b.** The Field of Cultural Production. New York: Columbia University Press.

**Bourdieu, Pierre. 2001.** "Forms of Capital," në Mark Granovetter dhe Richard Swedberg, editorë, The Sociology of Economic Life. Boulder: Westview Press.

**Fink, Bruce. 1995.** The Lacanian Subject. Princeton: Princeton University Press.

**Goffman, Erving. 1959.** The Presentation of Self in Everyday Life. Garden City, NY: Doubleday.

**Sulstarova, Enis. 2006.** Arratisje nga lindja: orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadare. Tiranë: Botimet Dudaj.

**Zizek, Slavoj. 1989.** The Sublime Object of Ideology. New York: Verso.

## Shtime

1 - Përdorimi i termiit "fushë" këtu bëhet sipas përkufizimit specifik që ia jep këtëj termi Bourdieut.

Çdo fushë ndërtohet në raport me një habitus të veçantë, ndërsa fushat përkufizohen nga një formë specifike e kapitalit të cilat mbartin, zakonisht në shkallë të pabarabarta, pjesëtarët e fushës. Fushat kështu organizohen rreth disa parimeve të kultuara, janë hierarkike dhe njëkohësisht kanë raporte të drejta ose të zhdrejta me fusha të tjera. Shih Bourdieu (1985) dhe Bourdieu (1993a)

2 - Për konceptin e kapitalit social dhe kapitalit kulturor (forma të veçanta që dallojnë nga forma klasike e kapitalit ekonomik), shih Bourdieu (2001) dhe Bourdieu (1993a).

3 - Vlen të përkujtohet në këtë rast kuptimi burimor i fjalës "polemikë", që rrjedh nga fjala e greqishtes së vjetër: polemos, domethënia e së cilës është luftë.

Analisti mund të kuptohet kështu si një figurë që është në luftë të përhershme me fushën politike, jo në luftimin e luftës politike që bëjnë aktorët e fushës politike (ku lufta politike është mjet për qëllim të caktuar që ndjekin protagonistët e fushës politike), por ku lufta dhe konfrontimi është qëllim në vetë.

4 - Për organizimin e fushës artistike shih studimin e Bourdieut (1993b).

## PRITSHMËRI TË MËDHA: BE DHE RIVALITETI I BRENDSHËM POLITIK NË EUROPËN LINDORE DHE QËNDRORE

Anna GRZYMALA-BUSSE DHE Abby INNES

### HYRJE: PASOJAT E BRENDSHME PËR SHTETET NË KUADËR TË ZGJERIMIT TË BE-SË

Në ish-vendet komuniste të Europës Lindore dhe Qëndrore, premtimi për zgjerimin e Bashkimit Europian, bashkë me potencialin për integrim politik dhe ekonomik, solli krahas, lirive të reja për të lëvizur e punuar, dhe shumë përfitime të tjera publike. Gjithashtu pati përmirësime në drejtim të të drejtave të minoriteteve, në lirinë e shtypit dhe në përpjekjet kundër korrupsionit. Por zgjerimi nuk është pa kosto të brendshme për shtetet dhe këto kosto nuk janë vetëm në lëshimet e paevitueshme/pashmagshme gjatë negociatave mes vendeve anëtare dhe vendeve kandidateve.

Kushtet e BE-së për vendet e Europës Lindore ishte më të rënda sesa për pararendësit e anëtarësuar të grupit të Mesdheut. Kjo tërësi "pritshmërisht të mëdha" që BE-ja ka ndaj vendeve kandidate përsa i përket përputhshmërisë së tyre me ligjet, rregullat dhe normat e saj, ka dominuar në debatin publik mbi natyrën e politikave në rajon. Si rezultat, jo vetëm që me dashamirësi, i dha fund debatit në lidhje me formën e dëshiruar të regjimit (demokraci apo ndonjë nga alternativat e saj), por përmbylli debatet e detajura dhe ideologjike në lidhje me shumë fusha të politikave publike. Është pikërisht perceptimi i mospasjes së një alternative tjetër i cili përforcoi qëndrimin e atyre politikanëve kundër BE-së të cilët zunë vendin e populizmit në debatin mbi ideologjitë ose politikën në demokracitë e reja të Europës Lindore dhe Qëndrore. Shkurt, kërkesat për zgjerim ndrydhën në rivalitet partiak të përgjegjeshëm në raport me votuesin dhe, me daljen më në pah të karakterit të zgjerimit, nxitën populistët dhe demogogët.

### RIVALITETI TEKNOKRATIK

Një nga rrjedhojat e para të pritshme nga BE-ja, ashtu si u parashtruan dhe në Marrëveshjet e anëtarësimit dhe në negociatat në vazhdim, ishte se rivalitetit partiak në rajon ka vazhduar të mbetet peng i projekteve perëndimore për politika publike. Këto projekte, ashtu si u përcaktuan nga organizmat financiare ndërkombëtare dhe aktorët rajonalë, konsistojnë si fillim në strategji neoliberales për liberalizim dhe marketizim nën mbikqyrjen e bankave huadhënëse dhe kohët e fundit, u formëzuan nga kushtet e reja për anëtarësimin në BE. Të dyja në vetvete janë shumë kërkuese.

Në fillimin e viteve '90, elitat politike në rajon u përballen

me një buxhet publik tërësisht të shkurtuar përballë kërkesave gjithnjë e më të rritura ndaj shtetit. Sapo u arrit që krizat ekonomike të viheshin nën një farë kontrolli, (kjo në shtetet më të suksesshme), u prezantua një tërësi politikash të reja, të cilat vinin në plotësim të kushteve të shumta detyruese për anëtarësim në BE. Në pritshmërinë e shumta politike dhe ekonomike, BE-ja i dha prioritet krijimit të një ekonomie të hapur, më konkurruese, më funksionale dhe të rregulluar, krijimit të strukturave të reja administrative për thithjen e fondeve të BE-së dhe kapaciteteve administrative në sektorin e vjetër publik dhe sektorin e ri privat, krijimit të një gjyqësori të drejtë e të pavarur dhe inkurajimit të forcave të brendshme bashkëpunuese. Secili shtet duhet të arrijë rezultate të larta në çdo drejtim, nga legjislacioni bankar te ai i sigurimeve, nga mbrojtja ligjore e të drejtave të minoriteteve në harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me standardet e BE-së, dhe çdo shtet duhet të adoptojë tërësisht 80 000 faqet e *acquis communautaire*-rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet ekzistuese të Bashkimit Europian. Të gjitha të sipërpërmendurat duhet të ingranohen e përfshihen në legjislacionin e brendshëm, mundësisht si prioritet kryesor, (pavarësisht faktit që shoqëritë në ndryshim të këtyre vendeve kërkonin një përshtatje të qëndrueshme të legjislacionit në çdo fushë). Për më tepër, Komisioni Europian bëri të qartë, se zbatimi i plotë i *acquis-it*, dhe jo vetëm thjesht harmonizimi i legjislacionit, duhet të bëhet para anëtarësimit të plotë të vendeve kandidate. Që kur anëtarësia në BE u pa jo vetëm si një e mirë publike, por edhe si një nevojë publike, vendet kandidate, filluan të zbatojnë kushtet e BE-së por me një kosto të lartë buxhetore dhe politike.

Nevoja për këto reforma, bëri që partitë më kryesore në rajon të hartonin strategji të rivalitetit ndërpartiak të cilat iu jepnin mundësinë të shfaqeshin sa më përgjegjëse para elektoratit, ndërsa në fakt menaxhonin një axhendë të paracaktuar reformash dhe përafrimi. Në fakt, përpjekja për të ecur sipas planit të reformave në të gjitha fushat e politikave thelbësore publike të shtetit modern, i ngjason një zhvillimi të ndërvarur/të kushtëzuar deri në atë pikë sa pengon zhvillimin "organik" të politikës së brendshme dhe të debatit publik mbi alternativat e mundshme ndaj modelit rregullator të BE-së.

Këto presione u ndërthurën me zhvillimet e brendshme partiake për të mënjeluar sa më shumë të ishte e mundur alternativat ndaj politikave shtetërore. Menjëherë pas 1989, politika partiake në vendet e Europës Lindore dhe Qendrore u zhvillua brenda kuadrit parlamentar dhe jo nga organizatat-bazë të zonave elektorale. Kjo i dha një mundësi të pazakontë politikanëve për të dhënë formë vetë debatit politik. Gjithsesi, spektri i këtij debati është kushtëzuar nga konsensusi ndërkombëtar dhe i brendshëm për reforma neoliberales të tregut dhe anëtarësimit në BE. Me kaq pak zgjedhje për rezultate nga politikën publike, politikanët kishin pak mundësi për të treguar veten dhe aftësitë e tyre veç

angazhimimit për politika kur dallonin veten e tyre nga rivalët. Sistemet politike partiake në rajon ofruan në këtë mënyrë përgjegjshmëri elektorale por jo përgjegjshmëri për politikën përsa kohë që sistemi elektorale ia doli mbanë të hiqte qafe partitë, por me sa duket nuk arriti të formëzonte politikën në fushat kritike të qeverisjes.

Politika publike e Europës Lindore është tërësisht e dominuar nga çështje vlerash ose nga çështje për të cilat partitë kanë të njëjtat objektiva (psh tregje të hapur dhe konkurrenca, buxhete të ekuilibruar, pakësimi i shpenzimeve publike dhe anëtarësimi në Bashkimin Europian). Si rrjedhim, elitat kanë patur pak liri veprimi në rivalitetin e tyre përveç polemikave rreth aftësisë së secilit për arritjen e rezultateve të dëshiruara. Ato rivalizojnë me modus operandi të partive sesa me alternativat e programeve apo bindjeve/angazhimeve ideologjike. Në kushtet e presioneve ndërkombëtare dhe konsensusit për reforma, alternativat e tjera nuk kanë qenë të besueshme me kalimin e kohës. (Dhe në ato vende ku populistët provuan me shpenzimet e pamatura publike, rezultati precipitoi në kriza ekonomike të cilat përshpejtuan/theksuan më shumë nevojën për reforma dhe inkurajuan spekulimet te institucionet huadhënëse).

Në këto kushte, kokëçarja politike për parti kompetitive, u trajtëzua në atë se si të manaxhohej qeverisja dhe kjo axhendë, pa cënuar popullaritetin e vetë partive. Strategjitë e suksesshme konkurrense kanë qenë ato të teknokracisë, populizmit dhe nacionalizmit-madje me këto dy të fundit që prireshin të ndërthureshin me njëri-tjetrin. Këto predikime politike dominuan sepse ato iu ofrojnë politikanëve fleksibilitetin maksimal për t'u shfaqur si kompetitivë, pavarësisht se tërë qeveritë përballen me të njëjtin presion të fortë të politikës shtetërore. Në ato vende ku ekzistonte një konsensus paraprak/fillestar pro reformës, partitë filluan të rivalizonin me atë se cili ishte manaxheri më i mirë e administratori më efikas dhe jo mbi përmbajtjen e politikave publike. Një rivalitet i tillë doli më në pah në Hungari dhe Poloni ku partitë trashëgimtare komuniste të reformuara i përdorën pretendime të tilla për të vënë në pah avantazhin e tyre dallues ndaj rivalëve. Aty ku parakushtet ekonomike dhe politike për zhvillimin e reformave radikale ishin të pafavorshme që në nisje dhe të tilla mbetën në vazhdim, si p.sh. në Rumani dhe Bullgari, strategjia kryesore e rivalitetit politik u bazua te nacionalizmi dhe populzimi, të cilët thelluan më tej mundësitë për krijim monopolesh e përqëndrim të ardhurash në kurriz të të mirave publike.

Si rrjedhojë, ajo çka mbizotëroi në këtë periudhë ishin debatet dhe polemikat me emra konkretë e të përvecëm mbi korrupsionin, për aftësitë personale, për kthimin e pronave, polemikat pa vlerë brenda partive politike ose me shtetet fqinjë, dhe debati mbi qëndrimet e mbajtura gjatë periudhës komuniste, ndërkohë që çështjet në lidhje me politikën publike thelbësore, mbetën në hije. Kjo lloj politike pati pasoja të rënda në sjelljen

elektoratit. Ashtu si konfirmohet dhe nga sondazhet e opinionit publik, këto "përplasje" kanë bërë shumë pak për të frymëzuar ndjenjën e respektit për elitat politike, e për të mos folur pastaj për promovimin e një besnikërie partiake të qëndrueshme. Si për ironi, thuhej që zgjerimi i BE do ta stabilizonte rajonin njësoj si stabilizoi Spanjën dhe Portugalinë. Ja vlen të theksohet që paqëndrueshmëria në votime në Europën Lindore jo vetëm që është më e lartë se ajo në vendet e Mesdheut gjatë së njëjtës fazë (të anëtarësimit) por në shume raste është në rritje. Pra, në këtë mënyrë, presioni i anëtarësimit në BE jo vetëm që u bë pengesë për debatin e vërtetë mbi llojin e politikave publike por në mënyrë indirekte mund të ketë sjellë një paqëndrueshmëri elektorale më të madhe.

Ndoshta ironia më e madhe është se ekzistenca e zonave elektorale me peshë domethënëse përballë interesit vetjak të shteteve anëtare të BE-së që u shpreh gjatë negociatave, i vuri në një dilemë edhe politikanët më të zellshëm e të bindur për reforma në Europën Lindore. Ata politikanët të cilët donin të hynin në BE dhe gjithashtu të forconin përgjegjshmërinë dhe cilësinë e përfaqësimit të sistemit politik të brendshëm, panë se sa më shumë që t'i vinin veshin interesave kombëtare dhe atyre të elektoratit të tyre-një kusht pa të cilin nuk ka qeverisje përfaqësuese dhe legjitime-aq më shumë ata rrezikonin të etiketoheshin si jo bashkëpunues ose jo vullnet mirë në negociatat me BE-në.

Për më tepër, për shumë vende si Rumania, Bullgaria, Lituania dhe Letonia, për të mos thënë Serbia, Ukraina, Moldavia e kështu me rradhë, këmbëngulja për arritjen e standardeve që këto vende zor se mund t'i përballonin për t'i zbatuar, krijon rrezikun që BE të perceptohet si një organizatë që nuk mbështet reformat por që përkundrazi që i kërkon llogari qeverive për një srë reformash që ato nuk mund t'i realizojnë. E thënë ndryshe, BE mund të perceptohet gjithnjë e më shumë si një aktor që në mënyrë të qëllimëshme përpiqet të shtojë pengesat në një zonë që kishte trashëguar boll disavantazhe strukturale të sajat. Ja vlen të përmendet se në vendet ku situata ekonomike ka probleme me reformën, si psh Rumania, elita politike e gjen veten jo vetëm mes presionit të brendshëm dhe ndërkombëtare po edhe mes Fondit Monetar Nderkombetar dhe BE-së. Kostoja dhe kufijtë e Acquis Communautaire janë të përmasave të jashtëzakonshme, që kërkojnë ngritjen e administratës shtetërore të aftë për të bërë e zbatuar ligje të tilla, nga ana tjetër kushtet thelbësore të FMN-së për vazhdimësinë e huave bazë mbështeten te një rol i kufizuar i shtetit dhe në përgjithësi, kanë sjellë reduktimin e shpenzimeve publike.

#### SFIDA POPULISTE

Një nga pasojat e paqëllimëshme të zgjerimit të BE-së në rivalitetin e brendshëm politik ka qenë nxitja e populizmit. Në konsensusin fillestar në lidhje me reformën, mbështetja e publikut

për anëtarësimin në BE ishte shumë e lartë, më shumë se 80% në Poloni e Hungari dhe më shumë se 70% në ish-Çekosllovakia. Sa më evidente bëheshin kostot dhe sa më ta paqarta përfitimet, kjo mbështetje publike filloi të luhatej. Që nga koha kur vendet nisën procesin e negociatave të anëtarësimin në mesin e viteve '90, nivelet e mbështetjes janë bërë më të paqëndrueshëm, madje në disa vende mbështetja ka rënë në 40% .

Si pasojë e rivalitetit politik teknokratik, elitat të cilat në fillim u pozicionuan kundër reformave, ishin të pakta dhe u injoruan. Gjithsesi nga fundi i viteve '90, mungesa e debatit real dhe perceptimi i faktit që këto vende po i nënshtroheshin një BE-je shfrytëzuese, filloi të krijonte mundësinë për evidentimin dhe suksesin e liderëve populistë, madje dhe në ato vende ku më parë populzimi ishte mënjeluar apo nuk gëzonte reputacion. Kështu, në zhvendosjen e tij drejt së djathtës, Vaclav Orban's Fidesz në Hungari shfrytëzoi pakënaqësinë masive duke fajësuar BE-në. Në të njëjtën mënyrë ish kryeministri çek Vaclav Klaus, dikur i rrëzuar nga pushteti, i ktheu sytë nga Euroskepticizmi si një mënyrë për të rifituar popullaritet, duke folur kundër bashkimit të heshtur e të ngadaltë të Kontinentit nga BE. Së fundmi, në Poloni pas zgjedhjeve të vjeshtës së 2001, një e katërta e vendeve në Parlament i takoi partive kundër Bashkimit, të cilat varionin nga ato thjesht skeptike në ato tërësisht antagoniste. Për ironi, këto vende ishin ndër kandidatët e parë për anëtarësim në BE-dhe pikërisht pse u përpoqën në maksimum për t'iu përmbajtur vijës së BE-së dhe pranimit të standarteve të saj, ato ishin më pak të aftë për të debatuar mbi të ardhmen e vendit të tyre.

Kjo nuk do të thotë aspak që populistët nuk kanë fakte, meqë zgjerimi i BE duket që është një propozim gjithnjë e më i kushtueshëm. Kostot e menjëhershme të anëtarësimin në BE po bëhen sa vjen e më të qarta si: shpenzimet për rimëkëmbjen e industrive dhe sektorëve joeficientë të ekonomisë si agrikultura dhe kostot e paparashikuara nga asnjë nga palët. Për shembull, vendosja e sigurisë në kufij mbart në vetvete jo vetëm koston direkte të ndërtimit të infrastrukturës së re po edhe mundësinë e kostove të lëvizjes së tregëtisë dhe vendeve të punës . Për më tepër, atmosfera e negociatave të anëtarësimin nuk ka ndihmuar në krijimin e mbështetjes për projektin e BE-së. Kritikët vendas në Europën Qëndrore dhe Lindore, kanë nxjerrë në pah faktin se vendet e anëtarësuar në valën e parë të zgjerimit (si Spanja, Portugalia dhe Greqia) kanë përfituar më shumë nga ç'do të mund të fitojnë ndonjëherë fqinjët e tyre lindorë. Dhe janë pikërisht këto vende të cilat mbështesin më pak shtirjen më gjerë të këtyre përfitimeve që burojnë nga BE. Për shembull, Spanja, merr 63% të fondeve strukturore dhe të kohezionit të BE-së por nuk pranoi të sakrifikoje ndonjë nga këto dhurata bujarë në të mirë të vendeve candidate . Njëkohësisht, disa nga shtetet më të vjetra anëtare si Gjermania, kërkojnë të drejtën e blerjes së tokës në vendet e Europës Lindore dhe Qëndrore, por nuk pranojnë në shkëmbim

lejjimin e plotë të lëvizjes së lirë të punës e krahut të punës. Shkurt, sa më të qarta bëhen kostot e anëtarësimin në BE, përfitimet pakësohen dhe bëhen gjithnjë e më ta largëta e të pasigurta.

Gjithsesi, edhe nëse zemërimi i populistëve është i justifikuar, ata bëjnë shumë pak në drejtim të thellimit të debatit konstruktiv mbi politikat shtetërore, duke u marrë thjesht me sharje personale. Rezultati është një spirale vicioze ku elitat populiste shfrytëzojnë dhe nxisin dobësimin e mbështetjes së opinionit publik për BE-në, duke thelluar kështu pakënaqësinë dhe dyshimin masiv ndaj BE-së, cka prodhon kushte të favorëshme për një opozitë populiste (dhe shpesh instrumentale) ndaj antarësimin në BE . Nëse popullsisë në këtë rajon i jepej një shans për t'u shprehur drejtpërsëdrejti në lidhje me anëtarësimin, psh me anë të ratifikimit të traktatit në çdo shtet, atëherë, duke pasur parasysh kostot e parapërgatitjeve, ata edhemund të votonin kundër.

## BE DHE SHTETI KOMBËTAR

Politikat shtetërore janë njëra nga fushat kryesore në të cilat mund të shihet mjaft qartë se si debati publik është ndikuar nga presioni i dyfishtë i populizmit dhe konkurrencës teknokratike. Politika të tilla përbëhen nga ajo se çfarë shteti bën - rregullimet, privatizimet, shteti i së drejtës, rishpërndarja - dhe mënyra se si shteti e bën dicka të tillë - decentralizimi, reforma administrative, Kodi i shërbimit civil. Në Europën Lindore, BE i ka kufizuar shumë nocionet mbi atë që shteti mund të bëjë apo të bëhet.

Pavarësisht se Vendet candidate të Europës Lindore dhe Qëndrore me guxim kanë përpirë modelin e shtetit teknokratik të BE-së, është mëse e qartë se ky model nuk është aspak koherent. Për më tepër, është me baza të dobëta, me themele të lëkundshme në disa pjesë të tij. Ky model është një armim i madhe që rezultoi si pasojë e konsensusit të brendshëm për rolin që duhet të ketë shteti (që në Europën Perëndimore u pasoi nga rivaliteti partiak i pasluftës). Modeli apo më saktë mishmashi i shtetit i cili zë fill të *acquis communautaire*, është ai i një labirinti burokratik normash dhe standartesh që rregullojnë një treg të hapur e kompetitiv. Për më tepër, lobimi i pushtetit i sektorëve industrialë të shteteve anëtarë nënkuptonte se fuqia e standarteve dhe normave të BE-së varion nga njëri sektor ekonomik në tjetrin-pavarësisht strukturave sektoriale dhe interesave primare të shteteve të reja anëtare.

Ashtu si u përmend dhe më lart, mungesa e debatit është më e evidente në diskutimet mbi zbatuesin dhe imponuesin kryesor të rregullave të reja - mbi shtetin dhe strukturat e tij administrative. Vetë Komisionerët dhe shtetet e BE-së, këmbëngulin se ajo çka ata "eksportojnë" nuk është një "model shteti" (sepse kjo do të ishte një lloj forme imperializmi), përkundrazi janë thjesht praktiket më të mira teknike të cilat rastësisht mbulojnë tërë fushat e politikave publike. Gjithsesi, për Europën Lindore, një rajon në të cilin përqaqja në fillimet e viteve

'90 ishte ajo e tkurrjes së shtetit, "arna" e sofistikuara e *acquis communautaire* në pesë vitet e fundit ka qënë modeli përcaktues për prodhimin e legjislacionit që do i jepte formë edhe vetë shtetit. Fakti që *acquis-i* është inkoherent në nivel kombëtar - që kërkon struktura si p.sh. administratë eficiente dhe të decentralizuar për disbursimin e fondeve strukturale, pa përcaktuar se si do të krijohen këto struktura të tilla, nuk duhet të interpretohet si hapësirë në të cilën vendet e Europës Lindore mund të bëjnë manovra. Kështu që prej vitit 1999 deri në 2000, Polonia, Republika Çeke dhe Sllovakia kanë miratuar ligje të cilat rishikonin shërbimin civil, administratën lokale, masat kundër korrupsionit dhe sa më shumë që këto reforma vonoheshin, si në Sllovaki, aq më shumë presioni i BE-së ishte forca lëvizëse për legjislacionin e tyre.

Për më tepër, si mund të flasim për shtet të së drejtës-një pronësi organike e drejtësisë nga populli, që të lulëzojë në një rajon ku pjesa më e madhe e ligjeve të miratuara në vitet e fundit është importuar dhe çështjet kryesore të politikave publike janë ceduar në favor të një BE-je shpesh më të fuqishëm? Në verën e vitit 2002, BE-ja shpalli se do të bënte monitorimin dhe gjëritjen për moszbatim të *acquis communautaire* në vendet kandidatë madje para se të mbylleshin negociatat. Përputhshmëria me normat e standartet e BE-së në Europën Lindore duhet të realizohet (nga shumë vendet anëtare që nuk janë në harmoni me to) para se kandidatët të kenë pranuar formalisht anëtarësimin. Në këtë kuadër, vlen të thuash se Europa e re do të ketë skeptikët që meriton.

## PËRFUNDIMI

Së fundmi, kostot e brendshme të rivalitetit politik të anëtarësimin në BE mund të jenë më pak të dukshme sesa lëshimet e kushtueshme gjatë negociatave, por asesi më pak domethënëse. Duke ndikur në diskutimin publik në emër të zgjerimit efektiv dhe eficient, BE-ja ka stimuluar rivalitetin teknokratik dhe përgjigjen populiste ndaj tij. Nëndërkohë, në Europën Perëndimore, dimensionin gjithënjë e më teknokratik i debatit politik, përqaqimi i tregut nga e Majta, dhe transformimi i padepërtueshëm i BE-së thuhet se ka 'armiqësuar' votuesit duke shkaktuar apati dhe mospjesëmarrje në votime, vecanërisht mes të rinjve. Thuhet se politikat në Europën Perëndimore janë bërë kaq pragmatiste dhe teknike, e madje aq të mërzitshme, sa personazhët karizmatikë të së djathtës ekstreme mund t'ia dalin mbanë, ndërkohë ata që janë të fiksuara politikisht mund të gjejnë ndonjë mbështetje në militantizmin më konvencional. Mendoni, atëherë se sa më serioze dhe e vështirë do të jetë kjo gjendje në vendet kandidatë kur të bëhen anëtarë.

Në një BE të zgjeruar presionet do të vazhdojnë. Duke pasur parasysh kërkesat për politika dhe ankimet e anëtarësisë së dorës së dytë, si rivaliteti teknokratik ashtu dhe epërsia populiste mund të vazhdojnë të strukturojnë politikat e brendshme. Shteti, për pjesën e tij, do të vazhdojë të ndryshojë formën në mënyrë që të përputhet me direktivat e BE-së por aftësitë e tij, përgjegjshmëria e madje dhe legjitimiteti nga populli do mbeten larg, sidomos në kuadrin e rivalitetit politik që sjell zgjerimi.

## BURIMET

- 1- Për një argumentin më të detajuar lidhur me ndikimin e planeve dhe projekteve mbi modelet e rivalitetit partiak në rajon, shih Abby Innes "Party competition in Post Communist Europe: The great electoral Lottery", *Comparative Politics* 35, (Tetor 2002), faqe 85-104.
- 2- Shih Anna Gryzmala-Busse "Redeeming the Communist Past" (Cambridge, Cambridge University Press, 2002)
- 3- Të dhëna nga Eurobarometri. Shih gjithashtu raportet e agjencisë të mëposhtme të sondazheve të cilat konfirmojnë këtë fakt: IVVM, Focus, OBOP, CBOS, Szonda Ipsos
- 4- Për shembull, Polonia duhet të sigurojë kufijtë e saj lindorë, të cilat janë njëkohësisht dhe një zonë e madhe tregëtare, me më shumë se 4.4 milion kalime individuale kufiri. Polonia jo vetëm që duhet të ngrejë një kufi më të fortë, i kushtueshëm në ndërtim dhe mbajtje, por duhet të përballë gjithashtu me kostot e mundshme që rezultojnë nga tregëtaria e humbur.
- 5- Shih Milada Vachudova "The trump card of domestic politics: Bargaining over EU Enlargements" *East European Constitutional Review* numër: 10, (Pranverë/Verë 2001) faqe 93-97
- 6- Shih gjithashtu Jacques Rupnik "Eastern Europe: The international Context" *Journal of Democracy* 11:2 (2000) 115-29.

## DEMOKRACIA NGA POPULLI DHE ZGJERIMI I BE-SË

Peter MAIR

**N**ë Qershor të vitit 2001, për habinë e opinionit vendas dhe ndërkombëtar, votuesit irlandezë nuk e miratuan Traktatin e Nisës i cili formalizonte përshtatjen institucionale të zgjerimit. Si rrjedhojë, Traktati u ndal që në hapat e parë. Rregullat e Bashkimit parashikojnë ratifikimin e traktateve nga të gjitha shtetet anëtare, dhe sikur qoftë edhe njëri nga të pesëmbëdhjetët të thotë jo, procesi ngrin. Për t'u siguruar, irlandezëve iu kërkua ta ratifikonin përsëri Traktatin, në Tetor të vitit 2002, dhe kësaj rradhe, fushata në mbështetje të traktatit ishte më intensive dhe më e kushtueshme. Madje ishte dhe më bindëse, dhe më në fund votuesit irlandezë thanë po, duke i hapur rrugën për më tej Traktatit të Nicës.

Pavarësisht se Irlandezët ndryshuan mendje, ia vlen të kujtosh se si ia dolën mbanë ta bllokoni Traktatin e Nicës në fazën e parë. Vendimi erdhi si rezultat i një referendumi i cili u karakterizua nga një pjesëmarrje e ulët dhe nga një rezultat shumë i ngushtë kundër traktatit. Më pak se 1 milion njerëz votuan, ose më pak se 35% e elektoratit votues, dhe nga këta, më shumë se gjysëm milioni (529 478 votues për të qenë të saktë) votuan kundër. Shumica kundër Nicës ishte 76 017 vota. Kjo ishte më pak se 8% e totalit të votave dhe më pak se 3% e elektoratit irlandez që u shfaq shumë pasiv.

Në një vështrim të parë, kjo duket një mënyrë absurde për t'iu përqsarur gjërave. Sot në BE ka pothuajse 300 milion votues, dhe për më tepër vetëm 529 478 prej tyre, 0.2 përqind e gjithë elektoratit të BE-së, ia doli mbanë ta bllokonte këtë traktat të rëndësishëm dhe si rrjedhojë të bllokonte shumë nga elementët formalë të procesit të zgjerimit. Zgjerimi, me të paktën 10 demokraci të reja, i BE-së ekzistuese u kërcënua në këtë mënyrë nga ajo çka mund të ishte një kapriçio e më pak se gjysëm milioni e elektoratit të sotëm të BE-së.

Nëse ndalemi për një moment, kuptohet se nuk është ky absurditeti i situatës. Ajo çka është me të vërtetë goditëse në lidhje me të gjithë situatën në fjalë nuk është fakti se si aq pak votues arritën të bllokoni Nisën, sesa se si këta pak votues të BE-së në këtë rast vetëm Irlandezët, u pyetën në lidhje me Nisën.

Në një vështrim të parë, duket sikur në BE-në e sotme ka shumë pak vend për demokracinë nga populli. Pra, duket sikur nuk ka asnjë moment gjatë vazhdimësisë së proceseve të vendimmarrjes-dhe sidomos ato që kanë të bëjnë me Kushtetutën dhe politikën në lidhje me formën e Bashkimit, në të cilën votuesit gëzojnë një votë vendosëse. Traktati i rëndësishëm i Maanstricht-it dhe realizimi i tregut unik u arritën me një minimum këshillimesh

elektorale. Adoptimi i një monedhe të vetme dhe krijimi i një Banke Europiane Qëndrore të një pavarësie të një lloji të veçantë, kërkuan një përfshirje popullore edhe më të paktë. Nisa, ashtu siç dihet tashmë, kërkoi miratimin popullor vetëm në Irlandë.

Mes shteteve kandidatë për anëtarësim në BE, ka shumë pak vend për demokracinë nga populli. Sigurisht, secili nga këto vende që kandidon për anëtarësim në Bashkim, duhet që së pari ta shtrijë çështjen në referendum, ndoshta këshillues në formë por detyruar në përmbajtje, pikërisht në të njëjtën mënyrë sesi kanë vepruar shtetet e tjera në zgjerimet e mëparshme. Por ndoshta ia vlen të theksohet në këtë fazë të hershme se nëse negociatat për anëtarësim janë të suksesshme, dhe nëse vendimi miratohet me referendum, atëherë kjo mund të jetë mundësia e fundit për këto demokraci të reja për të grishur kontrollin demokratik nga populli në çështje që kanë të bëjnë me natyrën e Bashkimit European. Vendimi për t'u anëtarësuar mund të ketë ardhur si rrjedhojë demokratike, kështu që përgjegjësia i bie t'u mbetet elitave. Sigurisht, lajmet mbi demokracinë në BE nuk janë dhe aq të këqija. Demokracia nga populli mund të kufizohet, por ashtu siç theksojnë gjithmonë avokatët e Bashkimit, ka gjithsesi vend mjaftueshëm për një lloj demokracie "konstitucionale" apo "Medisoniane". Populli european (ose popujt) mund të mos e kenë aftësinë për të mbajtur nën kontroll institucionet europiane dhe mekanizmat vendimmarrese, po kjo kompensohet më së miri nga aftësia e vetë institucioneve për të ushtruar kontroll mbi njëri-tjetrin. Ambicjes në Europë i përgjigjet gjithmonë ambicja, dhe vendimmarrjes bashkëvendimmarrja përsa kohë që Parlamenti ushtron kontroll mbi Këshillin, Këshilli ushtron kontroll mbi Komisionin dhe Gjykata i kontrollon të tërë, përfshirë dhe shtetet anëtare. Dhe nëse një proces i tillë do të dështonte, janë gjithmonë aktet reciproke balancuese dhe mekanizmat konsensualë që gjenden në sistemin krejtësisht të dallueshëm e të veçantë european të "qeverisjes me shumë nivele pushteti". Ekzistenca e tërë këtyre institucioneve konkurruese dhe bashkëpunuese i jep mundësi Europës që të ketë një lloj Qeverisjeje për popullin. Qeverisja nga populli, ashtu si thekson dhe Fritz Scharpf, ishte e pamundur të bëhej një mundësi reale në kontekstin european dhe tashmë duket edhe më e pamundur që të jetë një mundësi pas zgjerimit.

Mos ndoshta kjo është një pamje shumë pesimiste e ndërtesës europiane sot dhe në të ardhmen? Tek e mbramja, ashtu si thuhet shpesh, liderët politikë dhe partitë e tyre janë të përfshirë në dy arena elektorale në Europë, dhe në të dyja demokracia nga populli mund të jetë vendimtare. Të dyja arenat do të mbeten gjithaq të rëndësishme edhe pas zgjerimit. Kështu, në njërin anë, liderët politikë konkurrojnë për vota në nivel kombëtar për fitimin e një mandati në qeverisjen kombëtare për realizimin e programeve të tyre. Në këtë mënyrë ata mund të influencojnë drejtimin dhe përmbajtjen e politikave të BE duke punuar në Këshilla të ndryshëm, duke emëruar anëtarë në Komisionin European ashtu si dhe në organizma të tjerë ndërshtetërorë. Nga ana tjetër, ata garojnë në zgjedhjet për Parlamentin European (PE) dhe nëpërmjet punës këmbëngulëse në komitete, apo influencimit në



shumicën parlamentare, ata mund të bëhen një zë i rëndësishëm bashkëvendosës në procesin e politikëbërjes Europiane. Këtu kemi dy përfaqje me të njëjtin qëllim për kontroll demokratik nga populli.

Në praktikë gjithsesi, qëllimi shpesh anashkalohej. Për më tepër, anashkalohej me paramendim. Në zgjedhjet aktuale për PE-në, për shembull, zgjedhësve iu ofrohet të zgjedhin mes vizioneve të ndryshme për projektin europian, mes forcave shumë pro-europiane dhe shumë anti-europiane të cilat kërkojnë votën e popullit. Rasti i Danimarkës është një shembull shumë i mirë, ku partitë tradicionale dhe kryesisht pro europiane janë të detyruara të konkurrojnë në zgjedhjet për PE-në kundër JuniBevaegelsen (Lëvizja e Qeshorit) dhe Folkebevaegelsen mod EU (Lëvizja Popullore kundër BE). Të dyja këto grupe janë shumë miqësore ndaj thellimit të integritit europian dhe në zgjedhjet e vitit 1999 për PE në Danimarkë, ato arritën të merrnin së bashku pothuajse 25% të votave. E njëjta gjë ndodhi dhe në zgjedhjet në Francë për Parlamentin Europian, ku partitë pro europiane u detyruan në 1999 të konkurronin kundër një aleance ad hoc thellësisht euroskeptike, "Rassemblement pour la France".

Duket sikur këtu zgjedhësit, mund të shprehen për rrugën drejt së cilës po shkon Europa. Por thjesht shprehja nuk është vendimtare, përsa kohë që pavarësisht problemeve rreth zgjedhjes së PE-së, vetë PE nuk ka virtualisht asnjë rol në procesin konstitucional të BE.

PE është patjetër i rëndësishëm përsa i përket politikëbërjes së përditshme brenda kuadrit të BE-së. Por ai nuk ka peshë në diskutimet rreth BE-së përsa kohë që kjo çështje është kompetencë e politikanëve të shteteve dhe qeverive të shteteve dhe, po nëpërmjet tyre, kompetencë e Komisionit dhe e Këshillit. Kështu, ndonëse partitë pro dhe kundër integritit mund të ndeshen për një mandat në zgjedhjet për PE-në, të dy palët e dinë shumë mirë se një mandat i tillë nuk luan ndonjë rol të vecantë.

Përkundrazi, në garën në nivel kombëtar, ku një mandat që lidhet me thellimin e integritit europian mund të bëjë në punë, votuesit rrallë, për të mos thënë thujse kurrë, iu jepet një mundësi për të zgjedhur mes pozicioneve. Me përjashtim të rastit të rëndësishëm të Mbretërisë së Bashkuar, ku ndarja mes avokatëve të integritit dhe Euroskeptikëve është gjithashtu një ndarje partizane rrymash, votuesit në Europë, përballen me heshtjen ose konsensusin. Pra, ka pak dallim mes partive kryesore në lidhje me Europën, dhe në rastet kur ka qëndrime të kundërta, ato rrallë, thujse kurrë, dalin në pah. Mandatet jepen për zgjedhjet në nivel kombëtar por jo për Europën.

Ajo çka shohim këtu, të paktën sot, është veç një truk politik. Votuesit mund të pozicionohen pro ose kundër Europës në zgjedhjet për PE, atëherë kur çështja është dukshëm pavend në

lidhje me kompetencat institucionale në fjalë. Por votuesit nuk kanë shans që të mbajnë një qëndrim pro ose kundër Europës në zgjedhjet kombëtare, pikërisht atje ku mund të merret një vendim. Në këtë aspekt, është impresionuese të vihet re se asnjë nga dy partitë euroskeptike Daneze dhe as euroskeptikja Franceze nuk përfaqësohen në nivel kombëtar. Pra, të tria partitë i mohojnë votuesve një shans për t'i mbështetur ato pikërisht në atë arenë ku një lloj mandati i tillë mund të rezultojë vendimtar, duke preferuar të garojnë në një arenë ku nuk mund të kenë asnjë autoritet.

Mospërfshirja e qytetarëve të zakonshëm në vendimmarrje në Europë, njihet zakonisht si "konsensusi tolerant". Europa është shumë komplekse, ose shumë teknike, ose ndoshta shumë e mërzitshme që të jetë një shqetësim për votuesit e zakonshëm, kështu që ajo po kthehet, me një pëlqim reciprok, në një çështje për elitat. Gjithsesi, ndonëse Europa mund t'u përkasë elitave në praktikë, kjo nuk vjen për shkak të një konsensusi tolerant dashamirës. Përkundrazi, kjo ndodh sepse votuesve thjesht iu mohohet një mundësi për t'u shprehur. Dhe sa më shumë ata të jenë kundër, ashtu si ish-in irlandezët në Qershor 2001, aq më tepër një mundësi e tillë do të vazhdojë t'u mohohet.

Në fakt, kjo është mënyra në të cilën është vepruar në BE prej vitesh. Duke përfituar nga konsensusi tolerant, ose ashtu si gjatë viteve të fundit duke iu druajtur një refuzimi të planeve të tyre nga elektoratet gjithnjë e më mosbesues, liderët politikë e partiakë janë përpjekur që të trajtojnë krijimin dhe zgjerimin e BE-së si pjesë të politikave të prapaskenave. Kjo përfaqje është përkrahur dhe nga vëzhguesit e studiuesit të cilët këmbëngulin se politikat europiane janë disi ndryshe dhe sui generis dhe si të tilla, nuk është e nevojshme të ndiqen modelet tradicionale të përgjegjesisë dhe transparencës. Pati dhe nga ata si Giandomenico Majone, i cili argumentonte se përderisa Europa është në vetvete një tërësi rregullash, duhet të veprohet me të ashtuquajturat institucione jo maxhoritare-pra me anë të ekspertëve, gjykatësve ose burokratëve, sesa me anë të demokracisë nga populli.

Për më tepër, sa më e zgjeruar dhe më e larmishme është bërë BE, aq më i theksuar është bërë refuzimi i demokracisë nga populli. E thënë ndryshe, sa më shumë ka ecur integrimi europian në ditët e sotme, aq më tepër qytetarët e zakonshëm kanë janë përballur me një politikë e cila nuk mbart përgjegjësinë demokratike. Kjo përbën padyshim një problem në BE-në e sotme. Arsyet përse kjo çështje dhe rëndësia e saj e veçantë theksohen në këtë shkrim, është fakti që problemi ka gjasa që të bëhet edhe më shqetësues në BE-në e zgjeruar. Kjo do të thotë që në një BE më të madhe e më të larmishme, ky proces do të theksohet. Sigurisht, që me 25 shtete anëtarë që negociojnë politikat, asnjë lider politik nuk do të dojë t'i ketë duart e lidhura nga këmbëngulja për këshillime elektorale.

Tashmë është bërë më se e zakonshme ironia që mbartin



standartet e vendosura të BE-së mbi demokracinë për anëtarët e saj të rinj ndërkohë që në të njëjten kohë shtetet anëtarë nuk arrijnë t'i përmbushin vetë këto standarte. Ashtu si shkruan Ralph Dahrendorf, "Bashkimi ka përcaktuar kritere shumë të ashpra të virtutit demokratik për të ashtuquajturat vendet që do të anëtarësohen. Nëse, këto kritere do të zbatoheshin për vetë Bashkimin, përfundimi do të ishte dëshpërues." Gjithsesi, ka edhe një ironi akoma më therëse që bëhet gjithnjë e më e evidente. Pas më pak se 10 vjetësh që nga rënia e komunizmit dhe kthimit ose zbulimit të demokracisë, politikat e anëtarësimit po izolohehen në një sistem në të cilin demokracia nga populli ka pak ose aspak rol. Brenda BE-së së sotme, kjo gjendje mund të shihet si produkt i viteve të përthithjes dhe akumulimit të pushteteve në Bruksel në mënyrë të ngadaltë e

hap pas hapi. Votuesit e Europës Perëndimore kanë humbur zërin e tyre në Europë, por humbja ishte aq e ngadaltë dhe e paperceptueshme, sa dukej e parëndësishme. Të paktën deri tani.

Votuesit për politikat e anëtarësimit ndodhen në një pozitë tjetër. Jo vetëm kanë mundësi të shprehen për herë të parë, por po rrezikojnë që ta humbasin këtë mundësi në të njëjtin cast. Kjo nuk duhet lejuar. Demokracia është shumë e rëndësishme për tu merrë si e mirëqenë dhe si e tillë të lihet pas dore. Bashkë me zgjerimin duhet të bëhet dhe reforma institucionale. Bashkimi mund të jetë i kënaqur me mekanizmat aktuale të demokracisë konstitucionale. Me zgjerimin është e rëndësishme që këto mekanizma më në fund t'iu bashkangjiten mekanizmave të reja të demokracisë nga populli.

#### **BURIMET**

1 Fritz W.Scharpf *Governing in Europe: Effective and Democratic?* (Oxford, Oxford university Press, 1999) Kapitulli I parë

2-Për më tepër shih Peter Mair: "The limited impact of Europe on National Party Systems" *West European Politics* 23:4(2000) 41-47 ku argumenti në fjalë trajtohet më gjërë.

3-Shih për shembull Giandomenico Majone *Regulating Europe* (London, Routledge, 1996)



## RECENSË E ENIS SULSTAROVA, ARRATISJE NGA LINDJA: Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja

M.A Besnik PULA

Departamenti i Sociologjisë  
Universiteti i Miçiganit

Libri i Enis Sulstarovës është një nga përpjekjet e para dhe më sistematike për të përdorur kuadrin teorik të veprës Orientalism (Orientalizmi) të E.W.Said, për të analizuar nacionalizmin shqiptar, ashtu siç shfaqet në letërsi, historiografi dhe ligjërimin politik bashkëkohor. Ndërkaq, qëllimi i librit është arritur me shumë sukses. Sulstarova analizon shfaqjen e dikotomive orientaliste të autorët kryesorë shqiptarë të shek. XIX dhe evoluimin (ose ngulmimin) e tyre gjatë epokave kyçe të historisë shqiptare, në rolin e mekanizmave ligjërimore të përdorura për përcaktimin e identitetit modern shqiptar. Studimi zgjerohet tek përfshin shkrimet e intelektualëve bashkëkohorë shqiptarë, ku Sulstarova zbulon një rishfaqje në rritje të dikotomive të fuqishme orientaliste ndërsa intelektualët përpiqen të shpjegojnë problemet, vështirësitë dhe patologjitë e gjendjes postsocialiste të Shqipërisë, si edhe t'u japin përmasë historike marrëdhënieve të sapo vendosura të këtij vendi me kompleksin politiko-kulturor të quajtur "Evropë". Analiza e orientalizmit bashkëkohor shqiptar nuk merr si objekt të vetin veprat e autorëve nacionalistë që punojnë në skajet e prodhimit kulturor, të cilët mund të kishin qenë një qitje e lehtë e kritikës ndaj orientalizmit, por veprat e autorëve dhe shkrimtarëve kryesorë, popullore dhe që për sa u përket prirjeve kulturore dhe politike, zakonisht quhen "liberalë" dhe "proevropianë". Sulstarova tregon bindshëm se orientalizmi - e ndonjëherë edhe racizmi dhe islamofobia e hapur - ka strukturuar thellësisht mendimin e këtyre autorëve, duke bërë atë që ai e ka emërtuar me vend "orientalizmi shqiptar", të jetë shumë më tepër se sa një çështje e një mënyre mendimi që i ka kaluar koha.

Duke përcaktuar metodën e tij, Sulstarova ndjek Said, duke e kthyer "orientalizmin" nga një traditë shkencore (sot në pjesën më të madhe të varrosur) të Perëndimit të bazuar mbi studimin e "Orientit", në një koncept analitik që ka për qëllim të zbulojë dhe shqyrtojë ngulmimin e dikotomive fundamentale epistemike që organizojnë traditën orientaliste të diturisë. Kjo lëvizje teorike synon të vendosë rolin historik që Orientalizmi ka luajtur si një mjet për ndërtimin e vetë-imazhit të Perëndimit dhe të modernitetit të tij, të pozicionuar kundër një "Orienti" të pandryshueshëm dhe jashtë historisë, që përfaqëson një konglomerat gjeo-historik dhe kulturor të

paanë, por në dukje homogjen. Sigurisht që Sulstarova nuk harron të përmendë se disiplina e orientalizmit mori trajtë gjatë epokës kulmore të kolonializmit perëndimor dhe se ajo ka qenë e lidhur ngushtë me strukturat koloniale të pushtetit dhe sundimit. Por, duke qenë se Shqipëria nuk ka qenë një fuqi kolonialiste dhe studimet orientale asnjëherë nuk morën trajtë si një traditë shkencore në Shqipëri, Sulstarova orientalizmin e koncepton si "mënyrën e mendimit që merr si premisë ndarjen midis Perëndimit dhe Lindjes", në të cilën Perëndimi shfaqet si një formacion social dhe kulturor i vetëm, i unifikuar dhe relativisht i qëndrueshëm, me një sërë veçorish superiore, kurse Orienti si e kundërta e tij (f. 25). Kështu për Sulstarovën kategoria analitike e orientalizmit përdoret për të kuptuar vetëndërtimin prej autorëve nacionalistë të identitetit kombëtar, bazuar mbi supozimet dhe themelet e traditës perëndimore të orientalizmit, dhe se si ligjërimet nacionaliste e përdorën orientalizmit në rrëfimet e identitetit historik të kombeve përkatëse, duke e pozicionuar veten dhe të tjerët brenda ontologjisë së orientalizmit.

Përveç hyrjes, libri i Sulstarovës përmban shtatë kapituj, i pari i të cilëve ofron kuadrin analitik dhe të tjerët i kushtohen analizës së orientalizmit ashtu siç shfaqet në periudha të veçanta të historisë së Shqipërisë. Kjo histori përfshin prej fillesave të nacionalizmit shqiptar në shek. XIX deri në vazhdimësinë orientaliste gjatë regjimeve politike shqiptare para dhe pas Luftës së Dytë Botërore, e deri në debatet e tanishme mbi identitetin shqiptar dhe marrëdhëniet e Shqipërisë me Perëndimin.

Analiza historike e librit përqendrohet rreth poetit dhe shkrimtarit me famë të shek. XIX, Naim Frashërit. Sulstarova tregon se si Frashëri dhe bashkëkohësit e tij mbështeteshin fuqishëm te dikotomitë orientaliste në përpjekjet e tyre për të larguar identitetin historik shqiptar prej Orientit, që në atë kohë mishërohej nga armiku kryesor i nacionalistëve shqiptarë, Perandoria Osmane. Vepra e Frashërit është fokusi kryesor i kapitullit, duke marrë parasysh ndikimin e jashtëzakonshëm të tij në nacionalizmin shqiptar dhe statusin e tij si poet i mirënjohur i periudhës së Rilindjes Kombëtare. Për shembull, Sulstarova vëzhgon se rëndësia që Frashëri dhe bashkëkohësit e tij i japin prejardhjes së lashtë pellazge dhe ilire të shqiptarëve është përdorur jo vetëm për të identifikuar rrënjët etnike, por edhe për të theksuar prejardhjen e veçantë evropiane të shqiptarëve, për t'i diferencuar plotësisht ata prej turqve "aziatikë". Megjithatë, Sulstarova tregon se orientalizmi nuk përdorej vetëm për të ndërtuar ndryshimin prej tjetrit. Si një ligjërimit kulturor, orientalizmi shkonte më thellë në strukturimin e narrativës historike të identitetit shqiptar, duke vepruar si një element kyç në disa drejtime. Sundimi osman mbi shqiptarët kështu

përfaqëson jo vetëm mohimin e vetëqeverisjes, por edhe një përpjekje skandaloze pesëshekullore për të këputur lidhjet historike të Shqipërisë me Perëndimin. Me anë të analizës së njëres prej poemave më popullore të Frashërit, Istori' e Skënderbeut, Sulstarova shqyrton përdorimin prej Frashërit të figurës mesjetare të Skënderbeut për të dhënë imazhin e një epoke në të cilën shqiptarët janë, pjesërisht edhe prej krishtërimit, pjesë e Perëndimit.

Sulstarova tregon se si përfytyrimet historike të Frashërit për Skënderbeun dhe epokën e tij janë ndikuar fuqishëm prej biografisë së studiuesit kishtar Marin Barleti në shek. XVI, i cili e portretizon "Turkun" si barbar të racës më të ulët, që synon të pushtojë dhe shkatërrojë gjithë Evropën e krishterë - një temë standarde kjo në narrativat historike orientaliste mbi ekspansionin osman në Evropë. Ky imazh rishfaqet në poemën e Frashërit, ku turku figuron si një shkatërrues i pamëshirshëm, një barbar i papërmbajtur dhe lakmitar, që kërkon të zhdukë qytetërimin perëndimor. Kështu, Skënderbeu del si mbrojtës i Evropës dhe Shqipëria si porta hyrëse për në Evropë. Për Frashërin, çasti i tanishëm është shansi historik për shqiptarët që të shkëputen prej Orientit dhe të kërkojnë vendin që u përket në qytetërim (perëndimor). Megjithatë, Perëndimi në poemën e Frashërit përfaqëson diçka të ndryshme prej atij të kohës së Skënderbeut. Për Frashërin, një mysliman bektashi, Perëndimi i kohës së tij është mishërimi i modernitetit dhe përparimit shekullar, për të cilat aspiron edhe Shqipëria.

Ndërsa analiza e teksteve kryesore të Naimit, ndikimet mbi veprën e tij dhe konteksti kulturor kur shkruante, janë përdorur si mjete për të shqyrtuar hyrjen e mendimit orientalist në ligjërimin nacionalist shqiptar qysh në fillimet e këtij të fundit, një numër më i madh autorësh është përdorur për të analizuar orientalizmin në polemikat e politikanëve dhe intelektualëve të drejtuar kah reformimi dhe modernizimi i Shqipërisë pas pavarësisë. Kapitulli i librit mbi orientalizmin shqiptar midis dy luftërave botërore titullohet saktë "Oksidentalizimi i Shqipërisë". Sulstarova ilustron se si "oksidantizimi" pjesërisht kishte kuptimin e "çorientalizimit", që do të thoshte spastrimi i të gjitha mbetjeve kulturore dhe shoqërore të trashëguara prej kohës osmane - padyshim një çështje e ndërlikuar në një vend ku popullsia është në shumicë myslimane dhe ku pronarët e kohës osmane, bejlerët, vazhdonin të dominonin shoqërinë dhe politikën. Gjatë kësaj kohe, orientalizmi ofronte jo vetëm fushën e vizionit që përcaktonte se çfarë ishte "orientale" në Shqipëri dhe çfarë nuk ishte, por gjithashtu u kthye në një mjet që modernizuesit e rinj, të arsimuar me idetë perëndimore përdornin për të denoncuar armiqtë e tyre politikë. Për këtë grup modernizuesish, siç ishin ata të mbledhur rreth shkollës së

neoshqiptarizmit të Branko Merxhanit, orientalizmi shërbente jo vetëm si një mjet polemik, por edhe për ta përcaktuar projektin historik të Shqipërisë pas pavarësisë si një "oksidantizim" politik dhe kulturor.

Në një tjetër kapitull, Sulstarova ofron një shpjegim të shkëlqyeshëm të ndërtimit letrar që atyre që i quan "personazhe orientaliste". Këta janë portrete fiktive të figurave (zakonisht të fuqishme), që sipas autorëve të tyre ilustrojnë tiparet e personalitetit të personave që përfaqësojnë shpirtin oriental (të trashë, epshorë dhe irracionalë). Orienti në këtë mënyrë gjendet jo vetëm si një formacion kulturor i ardhur prej së kaluarës, por si një shpirt që ndodhet thellë në trupin e karakterit oriental, një qenie që ka hyrë si një sëmundje në shoqërinë shqiptare. Veçoritë morale të këtij karakteri janë vërtet të neveritshme. Duke shqyrtuar personazhin fiktiv të Xheladiun Beut ashtu siç del në një tregim me shumë ndikim të botuar në vitin 1937, me të cilin autori synonte të përfaqësonte stereotipin e beut shqiptar, Sulstarova na thotë se personaliteti oriental portretizohet si esencialisht i pandryshueshëm, mizor, dinak, gjenetikisht i shturur dhe lakmitar për perversione seksuale, si homoseksualiteti dhe pedofilia dhe në të njëjtën kohë me një dëshirë të pafrenuar për gra. Sulstarova ka gjetur një mënyrë të thjeshtë për të shqyrtuar figurën letrare të Xheladin Beut, me anë të krahasimit të diskutimit kritik e historik të K. E. Fleming (1999) mbi përshkrimet orientaliste të shek. XIX për sundimtarin osman Ali Pashën. Në këtë analizë krahasuese, Xheladin Beu, më shumë se sa një personazh origjinal i shpikur nga një autor shqiptar, del si riprodhim i një portretizimi historik të "orientalëve" të pushtetshëm, siç jepen nga ligjërimi orientalist.

Ndoshta zbulimi më interesant i librit është lokalizimi i mendimit orientalist në qendër të veprave historike dhe letrare të epokës socialiste të Shqipërisë. Shqipëria socialiste kishte pushuar së kërkuari të bashkohej me Perëndimin ose të bëhej perëndimore - përkundrazi, Perëndimi kapitalist ishte për udhëheqjen komuniste shqiptare, armiku më i madh i Shqipërisë, dhe vlerat dominuese perëndimore, antinom i atyre të komunizmit. Por, paradoksisht, pozicionimi politik i Shqipërisë si një armik i Perëndimit nuk detyronte një braktisje të orientalizmit në prodhimin kulturor apo ligjërimin politik, sikurse dëshmon Sulstarova. Ai tregon se si ligjërimi i epokës socialiste i zhvendosi koordinatat gjeo-historike të orientalizmit, meqenëse nuk ishte më Perëndimi që përfaqësonte subjektin e tij qendror historik përkundër Orientit ai tjetri i tij, por Shqipëria socialiste si fener i socializmit të vërtetë. Sikurse thotë Sulstarova, "Orientalizmi në socializmin socialist përdorej për përfaqësimin në vepra artistike të Turkut, të Perandorisë Osmane, të bejkerëve, agallarëve, kulakëve,

hoxhallarëve, dervishëve, besimtarëve myslimanëve - d.m.th. të gjithë ata që shoqëroheshin me sundimin osman në Shqipëri, por edhe ata që përfaqësonin "klasat shfrytëzuese dhe bashkëpunëtorët e armikut" edhe pas periudhës osmane" (129-130). Në ligjërimin historik, orientalizmi gjen, sidomos në veprat letrare të autorit të mirënjohur Ismail Kadare, zbatimin e tij tradicional si një metodë për të formuar identitetin kombëtar vis-a-vis Perandorisë Osmane të prapambetur, të dhunshme, barbare dhe joevropiane. Duke marrë parasysh se disa prej romaneve të tij janë të vendosura në kontekstin historik osman, Kadareja në mënyrë të qëndrueshme mbështetet mbi dikotomitë orientaliste për të përkufizuar "turqit" islamikë dhe barbarë si kundërshti e shqiptarëve të krishterë "perëndimorë". Për të, pushtimi osman sinjalizon jo vetëm fundin e pavarësisë politike të principatave mesjetare shqiptare, por edhe nxjerrjen e dhunshme të Shqipërisë prej Evropës dhe vendosjen e saj në Azi. Edhe më interesant është fakti që sipas Sulstarovës, temat e veprave të Kadaresë pasqyrojnë ndryshimet e mëdha politike në Shqipëri, ndërsa edhe subjekti i Orientit në veprat e Kadaresë ndryshon sipas tyre. Kjo duket pas prishjes së marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik në vitet 1960. Është interesante se superfuqia e mëparshme në veprën e Kadaresë kthehet në subjekt që përfaqëson Orientin. Për shembull, në poemën e Kadaresë të botuar në këtë periudhë, "vitet gjashtëdhjetë" hasim vargjet: "Mbi flamurin sovjetik kosorja e draprit/ Befas si gjysmëhënë na ua duk", pra duke hequr një paralele midis perandorive sovjetike dhe osmane. Sulstarova tregon me një sërë shembujsh, se si pas ndarjes të Shqipërisë me Kinën kjo e fundit bëhet "orientale" në veprën e Kadaresë. Në një rën prej romaneve të tij, udhëheqja komuniste kineze tregohet se kishte për qëllim ta përdorte Shqipërinë si një gur shahu për ta zbatuar një plan sekret për të dominuar gjithë Evropën. Shqipëria e vogël por heroike edhe një herë qëndron e vetme si ledh që e mbron Evropën prej sulmit të Orientit, me sovjetikët dhe kinezët që përfaqësojnë çfarë dikur ishin osmanët.

Pas paraqitjes së orientalizmit në prodhimin artistik të epokës së komunizmit, duket më pak i habitshëm, megjithëse më shqetësues, orientalizmi i hapur e zhurmëmadh, deri edhe te racizmi dhe islamofobia që Kadareja dhe bashkëkohësit e tij shfaqin në epokën pas-socialiste. Në këtë periudhë, nevoja e intelektualëve shqiptarë për ta pozicionuar identitetin politik dhe kulturor të Shqipërisë si esencialisht evropian, duket se ka arritur pikën e paranojës historike. Një nga çështjet qendrore që nxit këto debate intelektuale është islami dhe marrëdhëniet e tij me identitetin modern shqiptar. Në fillimet e viteve 1990 Kadareja propozoi që shqiptarët në mënyrë kolektive të braktisin islamit dhe të përqafojnë katolicizmin, për t'u

rikthyer te feja e paraardhësve të tyre. Islami vazhdimisht fajësohet prej këtyre intelektualëve, të cilët duket se janë të prirur për ta gjykuar atë me anë të stereotipeve dhe përshtypjeve sipërfaqësore, siç e provon Sulstarova në rastin e figurave publike me ndikim si Aurel Plasari, Piro Misha, dhe Mustafa Nano. Efikasiteti i këtyre "kritikave" të islamit bëhet i mundur me anë të ankorimit të tyre në orientalizmin historik, që lejon për t'i bërë thirrje stereotipeve dhe imazheve të shoqëruara me "Orientin", ky i fundit duke u shfaqur si një njësi e veçantë dhe joproblematike. Kështu, argumentojnë këta autorë, një perëndimorizim i vërtetë i Shqipërisë bashkëkohore kërkon, nëse jo braktisjen me gjithsej të islamit, të paktën vendosjen e një distance prej kësaj feje. Meqë këta debate janë të ndikuara shumë prej politikës së ditës, çështja e islamit dhe rolit të tij në shoqërinë shqiptare ka ardhur duke u bërë urgjente pas sulmeve të 11 shtatorit 2001 kundër Amerikës dhe fillimit të "luftës kundër terrorit" të udhëhequr nga Amerika. Sulstarova ka vënë re, për shembull, një përqaftim të intelektualëve më të shquar shqiptarë të nocionit të Samuel Huntington (1996) bazuar mbi "përplasjen e qytetërimeve", ku 11 shtatori sinjalizon fillimin e një konflikti të tillë. Aurel Plasari, për shembull, në 2002 shkruan se si 11 shtatori vërtetoi vizionin hantingtonian duke e "nxjerrë botën lakuriq", domethënë së qytetërimet e përkufizuara të tilla në bazë të feve, janë njësitë e vetme reale që kërkojnë përkushtim në botën e ditëve të sotme. Ky vizion ideologjik, i rrënjësuar thellë në ndarjet orientaliste të botës, mund të jetë shpjegimi i pjesshëm i fjalimit shumë të diskutueshëm prej presidentit shqiptar në 2005, i cili citohet prej autorit të librit. Në fjalimin e tij presidenti përpiket ta distancojë Shqipërinë prej islamit duke thënë se është "një islam me fytyrë evropiane", d.m.th. se është një "islam i cekët" (260). Orientalizmi gjithashtu thirret në ndihmë prej intelektualëve të ndryshëm për të shpjeguar një sërë çështjesh politike dhe shoqërore të Shqipërisë pas-socialiste, ndonjëherë edhe për të shpjeguar për brutalitetin e diktatorit komunist Enver Hoxha, si simptomatike për paaftësinë e Shqipërisë për të kapërcyer trashëgiminë e saj orientale. Rastet që Sulstarova dokumenton dhe diskuton mbi orientalizmin bashkëkohor shqiptar janë të shumta, dëshmi e faktit se orientalizmi nuk është vetëm një trajtë historike me anë të të cilit komunizmi shqiptar ndërton Tjetrin e tij, por një dukuri me pasoja të thella në ligjërimin politik pas-socialist dhe identitetin kulturor.

Libri i Sulstarovës është një arkeologji e shkëlqyer e dikotomive orientaliste në ligjërimin politik dhe kulturor shqiptar dhe është një lexim i domosdoshëm për të gjithë ata që janë të interesuar për politikën, historinë dhe kulturën shqiptare. Libri dokumenton sistematikisht dhe tregon për formimin dhe

qëndrueshmërinë e orientalizmit shqiptar, prej shfaqjes së tij në nacionalizmin e shek. XIX deri në debatet e ditëve të sotme mbi identitetin shqiptar. Libri përbën një kritikë shkatërruese të orientalizmit në trajtën e tij të tanishme, i cili shfaqet jo vetëm si një mënyrë stigmatizimi e pjesës joperëndimore të botës, por edhe si një ligjërimit gjithmonë e më shumë racist e islamofobik, që përshkon mendimin politik e kulturor në Shqipëri. Sulstarova përdor në mënyrë efikase analiza historike për të treguar dikotomitë e varrosura thellë - dhe ndoshta pjesërisht të pandërgjegjshme - që janë përdorur për të ndërtuar identitetin modern shqiptar, duke ekspozuar pjesë të bazës së tij në kategori mendimi që sipas kriterëve të sotme do të dilnin diskriminuese dhe raciste. Pikërisht në këtë pikë Sulstarova identifikon paradoksin më të madh të orientalizmit shqiptar, në atë që ai përdor një mënyrë të menduarit që kritikohet në Perëndim, për të ndërtuar identitetin e Shqipërisë perëndimore.

Në këtë kuptim, përpjekjet e Sulstarovës ndalin në nivelin e një kritike liberale, duke sugjeruar që orientalizmi të braktiset në emër të bashkimit me "Evropën" (dhe specifikisht me Bashkimin Evropian). Megjithatë, kritika e tij mund të radikalizohet më tutje. Duke qenë se frymëzimi kryesor për studimin e tij është vepra e Michel Foucault (1977; 1980), thellimi i metodës gjenealogjike të Foucault mund të tregojë vërtet se disa prej kategorive kyçe që përkufizojnë ligjërimitin nacionalist shqiptar (dhe ligjërimitin e nacionalizmit më në përgjithësi) mund të jenë të lidhura me traditat perëndimore të racizmit, darvinizmit social dhe diturisë kolonialiste, sikurse ato që historikisht kanë pjellë orientalizmin. Si një ligjërimit vërtet (në kuptimin që i jep Foucault këtij termi), pse historia e mendimit nacionalist të jetë e ndryshme prej asaj të ligjërimeve të tjera të pushtetit që Foucault analizon në studimet e tij tashmë të mirënjohura? Me fjalë të tjera, nacionalizmi është një ligjërimit mbi pushtetin në kuptimin më të thellë, por gjithashtu edhe një ligjërimit që është historikisht i qëndrueshëm, por edhe i pamundur të ndahet prej rrënjëve të tij epistemike. Kjo sugjeron që orientalizmi shqiptar nuk është thjesht një patologji vendore e kulturës politike dhe intelektuale, por që ai mund të vështrohet nga një pikëvështrim vërtet paskolonial, pasi që orientalizmi shpesh ka vendosur bazën esenciale për shfaqjen e shumë, nëse jo të gjitha, ligjërimeve nacionaliste. Por këtu, supozoj, qëndron vlera më e madhe e analizës së Sulstarovës, sepse potencialisht të çon te diçka përtej vetes. Me anë të shumë pyetjeve që ngre libri i tij, mund të hapë rrugën drejt një mënyre që na mundëson jo vetëm ta "provincializojmë Evropën", siç ka propozuar Chakrabarty (2000), por edhe të çprovincializojmë në

mënyrë kritike mendimin nacionalist shqiptar, i cili, sikurse shumica e nacionalizmave, ka tendencën të trajtohet si një dukuri e izoluar që zhvillohet sipas një logjike imanente që është krejtësisht autonome. Përkundrazi, zbulimi se orientalizmi është një parim organizues i rëndësishëm - nëse jo qendror - i ligjërimit dominues të nacionalizmit shqiptar dhe se orientalizmi vazhdon të funksionojë si një supozim i heshtur i debateve intelektuale mbi identitetin shqiptar, sugjeron një panoramë krejt të ndryshme. Ai që dikur ishte vendi më i izoluar i Evropës nuk duket më të ketë qenë aq i larguar prej traditave historikisht evropiane të mendimit - qofshin ato edhe disa nga traditat më të këqija të historisë evropiane.

Ndoshta u takon të tjerëve të ndriçojnë më fuqishëm lidhjet e thella historike midis orientalizmit dhe ligjërimit nacionalist shqiptar, dhe të qëndrueshmërisë së epistemologjive orientaliste (e prej kësaj, edhe atyre kolonialiste) brenda tij, që do t'u japë mundësinë studiuesve të nacionalizmit të hapin fusha të reja teorike. Sjellja më pranë dritës e lidhjeve historike dhe epistemike midis orientalizmit dhe nacionalizmit do të na lejojë të ndërtojmë një rreth dialektik, në të cilin orientalizmi jo vetëm që shërben për të kritikuar nacionalizmin shqiptar (për të argumentuar se intelektualët shqiptarë mbështeten në trajta mendimi që tashmë nuk janë të favorizuara në shumicën e institucioneve akademike perëndimore dhe në ligjërimit politik të qendrës, në këtë mënyrë kërkojnë një rishikim nga ana e tyre), por që kritika orientaliste e nacionalizmit shqiptar mund të shërbejë edhe për të ekspozuar po ato cektina perëndimore dhe moderne të diturisë që vazhdojnë të përshkojnë dhe strukturojnë vetë nacionalizmin. Në një kuptim, çfarë mund të përfaqësojë nacionalizmi, dhe nacionalizmi ballkanik në veçanti, përveç se një mbrojtje ndaj orientalizmit, duke përdorur armët teorike të vetë orientalizmit? Paradoksalisht, duket sikur nacionalizmi e arrin subjektivitetin e tij autonom me koston e përvetësimit në mënyrë aktive të mënyrës historike të diturisë që nuk e ka krijuar vetë. Prej kësaj perspektive, larg prej të përfaqësuarit një ligjërimit "derivativ", ligjërimit historik i nacionalizmit mund të shihet si një mishërim i një mënyre perëndimore të njohurisë par excellence. Cila, atëherë, do të ishte baza e vërtetë e përpjekjeve të vazhdueshme ideologjike e intelektualëve shqiptarë për ta "çuar Shqipërinë në Evropë", kur përpjekjet e intelektualëve bashkëkohorë shqiptarë për ndërtimin e një identiteti dhe kulture kombëtar të esencializuar dhe të purifikuar, duke racializuar, stigmatizuar dhe përgojuar Tjetrin - një Tjetër që është bërë plotësisht transparent ndaj diturisë - janë strategji ligjërimore tepër moderne dhe tepër evropiane? Për qëllime që shkojnë

përtej përfshirjes në debatet vendore intelektuale dhe politike në Shqipëri, shpresojmë se së shpejti do të kemi në duar një përkthim në anglisht të Arratisjes nga lindja.

#### BURIMET

**Canefe, Nergis. 2004.** "Foundational Paradoxes of Balkan Nationalisms - Authenticity, Modernity and Nationhood." <http://www.obiv.org.tr/2004/Balkanlar/005-NERGIS%20CANEFE.pdf> (Last accessed: July 5, 2006).

**Chakrabarty, Dipesh. 2000.** Provincializing Europe: Postcolonial Thought and Historical Difference. Princeton, NJ: Princeton University Press.

**Chatterjee, Partha. 1986.** Nationalist Thought and the Colonial World: A Derivative Discourse. Minneapolis: University of Minnesota Press.

**Fleming, K.E. 1999.** The Muslim Bonaparte: Diplomacy and Orientalism in Ali Pasha's Greece. Princeton, NJ:

Princeton University Press.

**Fleming, K.E. 2000.** "Orientalism, the Balkans, and Balkan Historiography." *American Historical Review*, Vol. 105, No. 4.

**Foucault, Michel. 1977.** Discipline and Punish: The Birth of the Prison. Trans. by Alan Sheridan. New York: Pantheon.

**Foucault, Michel. 1980.** The History of Sexuality, Vol. I. Trans. by Robert Hurley. New York: Vintage.

**Huntington, Samuel. 1996.** The Clash of Civilizations. New York: Simon & Schuster.

**Kadare, Ismail. 2006.** Identiteti evropian i shqiptarëve. Tirana: Onufri.

**Said, Edward W. 1978.** Orientalism. New York: Pantheon.

<sup>1</sup>Pak pas botimit të librit të Sulstarovës, Ismail Kadare botoi një ese të titulluar "Identiteti evropian i shqiptarëve" (Kadare 2006). Eseja udhërsa risillte qëndrimet standarde të Kadare së mbi lidhjet e thella historike të Shqipërisë me Perëndimin, gjithashtu i siguronte shqiptarët për "evropianitetin" e tyre duke theksuar ngjyrën e lëkurës së tyre.

<sup>2</sup>Partha Chatterjee, për shembull for instance, tregon se orientalizmi vepronte te nacionalizmi indian para pavarësisë (Chatterjee 1986). Të tjerë studiues kanë vërejtur se përdorimin e orientalizmit në Ballkanin bashkëkohor (për një përmbledhje shih Fleming, 2000).

<sup>3</sup>Lidhur me këtë Nergis Canefe shënon se një çorientalizim i ngjashëm u pa i nevojshëm në nacionalizmin turk. Ai shkruan se "premisat themelore [të nacionalizmit turk] rrekeshin të provonin se turqit nuk ishin një "ngastër orientale" dhe se ata kishin një shoqëri me tipare të brendshme të përparimit politik dhe revolucionit kulturor. Në këtë aspekt, mohimi i trashëgimisë osmane u bë domosdoshmëri" (2004: 108).

